

M.sc. Ismet Potera, Mr.sc. Hajrije Devetaku-Gojani,
M.sc. Selim Mehmeti, M.sc. Luljeta Bajrami- Shala

DHUNA VERBALE NDAJ NXËNËSVE

(Hulumtim mbi fyerjet e
nxënësve në shkollë)

tr

M.sc. Ismet Potera Mr.sc. Hajrije Devetaku
M.Sc. Selim Mehmeti M.sc. Luljeta Shala

DHUNA VERBALE NDAJ NXËNËSVE

(Hulumtim mbi fyerjet e nxënësve në shkollë)

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Kryeredaktor

Nezir Çoçaj

Korrektore gjuhësor

Mr. sc. Hajrije Devetaku-Gojani

Përgatitja teknike

Ismet Potera

Përmbytja

Parathënia

Trajtimi dhe hulumtimi i temave me interes për nxënësin dhe për arsimin në përgjithësi është një përpjekje e vazhdueshme e hulumtuesve të Institutit Pedagogjik.

Në vazhden e hulumtimeve po bëjmë përpjekje për të trajtuar çështje me interes, të cilat do të ndihmojnë përmirësimin e arsimit tonë.

Botimi që po i ofrojmë lexuesit dhe studiuesit të interesuar paraqet një përpjekje për të ndriçuar disa aspekte të klimës ekzistuese në shkollë dhe ndikimi i saj në raportin mësimdhënës -nxënës.

Çështja e dhunës ndaj nxënësve, si një ndër të drejtat elementare të njeriut dhe të nxënësve në veçanti janë preokupim i përgjithshëm i shoqërisë. Mirëpo deri më tani është trajtuar vetëm aspekti i dhunës fizike ndaj nxënësve, por jo edhe aspektet e tjera të dhunës. Ky hulumtim mëton që të vë në pah njërin ndër këto aspekte të dhunës, siç është dhuna verbale, fyerja apo fjalët e rënda me të cilat shpesh mësimdhënësit iu drejtojnë nxënësve.

Në teorinë dhe në praktikën pedagogjike është trajtuar shumë çështja e ndërtimit dhe e kultivimit të raportit të shëndoshë midis dy akterëve kryesor në shkollë, siç janë nxënësi dhe mësimdhënësi. Në të gjithë letërsinë pedagogjike dhe psikologjike është theksuar si mjaftë e rëndësishme, ose si një kusht pa të cilin nuk mund të funksionoj shkolla si tërësi.

Sistemi i arsimit te ne ka kaluar nëpër faza dhe sfida të shumta, të cilat edhe kanë lënë gjurmët e veta në aspekte apo në fusha të veçanta të mjedisit pedagogjik. Pothuaj të gjitha nivelet e sistemit kanë qenë të ndikuar nga këto “trauma” nëpër të cilat ka kaluar vet shoqëria. Nëse i shtojmë kësaj edhe vet procesin e kalimit nga një sistem totalitar në një sistem demokratik, patjetër që sfidat dhe problemet janë plotësuese të vet reformimit të sistemit të arsimit, në akëcilin do vend qoftë.

Rëndësia e këtij hulumtimi që po prezantojmë nuk është vetëm identifikimi se problemi ekziston, por edhe hapja e një perspektive për përmirësimin dhe avancimin e njëres nga hallkat më të rëndësishme të sistemit të arsimit, siç është raporti nxënës-mësues.

Aspekt i veçantë i këtij hulumtimi është vënia në spikamë e ndjeshmërisë, tejet të lartë, të nxënësve ndaj fyerjes dhe fjalëve të rënda të cilat mësuesit, me vetëdije ose edhe pa të, iu drejtohen nxënësve.

Të dhënat nga hulumtimi dëshmojnë jo vetëm ndjeshmërinë e lartë të nxënësve ndaj kësaj dukurie, por edhe alarmojnë se duhet bërë ndryshime rrënjësore sidomos në parapërgatitjen e mësuesve të cilat kanë përzgjedhur

profesionit e mësuesisë. Gjithashtu, të dhënat e hulumtimit tregojnë se nuk është e mjaftueshme që në mësimdhënës të ketë vetëm përgatitjen e mirë profesionale pa përgatitje të nevojshme (domosdoshme) psiko-pedagogjike. Vet fakti se përqindje e konsiderueshme e nxënësve deklarojnë se tani më jemi mësuar me fjalë të këtilla, flet për përgatitjen e pamjaftueshme e stafit mësimdhënës në fushat e psikologjisë dhe të pedagogjisë.

Qasja metodologjike dhe përzgjedhja e mostrës për hulumtim, nxënës të klasës së tetë dhe mësimdhënës, si dhe shtrirja gjeografike e hulumtimit, përfshirja e rajoneve dhe zonave fshat-qytet, mundësojnë përgjithësimin e të gjeturave nga hulumtimi.

Njëkohësisht ky botim, përmbajtja dhe rezultatet e tij mund të shërbejnë jo vetëm zgjerimin e hulumtimeve në këtë fushë, por edhe në marrjen e vendimeve për përmirësimin e politikave dhe të programeve të studimit në fakultete si dhe në hartimin e programeve për aftësim profesional të mësimdhënësve. Gjithashtu, nga rezultatet e këtij hulumtimi mund të marrim dhe hapa të tjerë për fuqizimin e pjesëmarrësve të tjerë në arsim me qëllim të rritjes së vlerës shoqërore të shkollës.

Për ndihmën që dhanë shkollat, nxënësit dhe mësimdhënësit në realizimin e këtij hulumtimi i falënderojmë përzemërsisht. Pa ndihmën e tyre nuk do të mund të bëhej hulumtimi dhe të dalte ky libër që po i ofrojmë lexuesit.

Çdo ndihmë, sugjerim, kritikë dhe ndihmës tjetër në këtë fushë IPK e pret me kënaqësi dhe si një formë të bashkëpunimit për realizimin e vizionit tonë-përmirësimi dhe avancimi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm e arsimit kosovar.

Hyrja

Një çështje mjaftë e rëndësishme, por edhe kusht për mbizotërimin e klimës pozitive në shkollë, është mënyra e komunikimit mësimdhënës-nxënës. Mënyrën e komunikimit, apo edhe taktin e komunikimit midis këtyre dy subjektëve në shkollë mund ta quajmë si urë kryesore e bashkëpunimit për arritjen e synimit/qëllimit për të cilin ekziston shkolla si institucion e organizuar me plan dhe program.

Duke parë rëndësinë e raportit nxënës – mësimdhënës për arritjen e synimit për të cilin edhe ekziston shkolla: formimin e brezit të shëndoshë të shoqërisë, u përpoqëm që këtë ta trajtojmë nëpërmjet të këtij hulumtimi. Lidhur me këtë, kur përmendet brezi i ri, na ka rënë të dëgjojmë ‘ata janë brezi i së ardhmes’ duke harruar se ata janë edhe brez i së sotmes. Nëse pajtohemi se ‘ata janë brezi i së ardhmes’ sikur i porosisim ‘sot nuk keni çfarë kërkoni, jemi ne që vendosim për gjithçka që ju duhet dhe që ju intereson juve’. Në njëfarë mënyre po ua mohojmë subjektivitetin e tyre në vendosjen dhe vendimmarrjen edhe për çështjet vitale të perspektivës së tyre.

Nëse ne ‘brezi i së sotmes’ duhet të vendosim për çdo gjë që ka të bëjë me të ardhmen e tyre, sepse e kemi borxh përgatitjen e tyre për jetë, profesion, krijim karriere, krijimin e familjes etj., atëherë e kemi edhe të “drejtën” që të ushtrojmë dhunë ndaj tyre sepse ajo “ju bënë mirë”. Gjatë kohë ka dominuar mendimi, ndoshta nën ndikimin e herbartianizmit, se “shkopi ka dal prej xhenetit” dhe se “fëmijë/nxënës i mirë është ai që dëgjon mësuesin” dhe flet/përgjigjet vetëm kur e pyesin. Tjetër, ka dominuar mendimi se mësuesi gjithmonë ka të drejtë në raport me nxënësin. Kjo ka ndikuar që ata të ndihen superior ndaj nxënësve.

Një tjetër çështje ende prezent në mjedisin shkollor te ne është mangësia në parapërgatitjen e mësuesve për aspektet të rëndësishme të komunikimit me fëmijët e moshave të ndryshme, edhe më të ndjeshme. Pastaj, mungesa e një orientimi të drejtë të të rinjve për profesion. Në shumë raste përcaktimi i të rinjve për profesionin e mësuesit bëhet rastësisht ose sa për të studiuar diçka e jo për shkak të dashurisë dhe vullnetit që një i ri e ka për ta ushtruar profesionin e mësimdhënësit.

E dhënë me shumë rëndësi për përgatitjen e mësuesve është mungesa, në programet e studimit për mësimdhënës, e fushave shkencore të cilat janë të domosdoshme për aftësimin e të rinjve për mësimdhënës të ardhshëm. E para, përkushtim i pamjaftueshëm i fakulteteve për zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencës së komunikimit me nxënës. E dyta, përkushtimi i pamjaftueshëm për zhvillimin e shkathtësive metodike për

mësimdhënie dhe e treta shmangia nga programet e studimeve për mësimdhënës të lëndës psikologji pedagogjike dhe zhvillimore. Pa plotësimin e këtyre tri mangësive në fakultetet të cilat përgatisin kuadro për mësimdhënës vështirë se do të përmirësohet gjendja edhe në fushën e cilësisë së komunikimit dhe të raporteve mësimdhënës- nxënës.

Po t'ia shtojmë kësaj që u cek më lartë faktin se ende nuk bëhet vlerësimi i performancës së mësimdhënësve, rritja e shkallës së përgjegjësisë ndaj punës me nxënës, për sukses por edhe për dështime, fuqizimi i faktorëve të tjerë në shkollë, si komuniteti i prindërve, i nxënësve dhe i mekanizmave tjerë në shkollë, vështirë se do të mund të bëjmë ndryshime dhe përmirësime në shkollë dhe përmirësimin e klimës së saj.

Këto që cekëm më lartë ishin shtytësit vendimtar për ta hulumtuar dukurinë e dhunës verbale apo të fyerjes që iu bëhet nxënësve nga ana e mësimdhënësve.

Ekipi që organizoi hulumtimin, pas miratimit të projektit nga ana e Këshillit Shkencor të Institutit, duke u bazuar në përvojën qoftë si mësimdhënës dhe njohës të praktikave të shkollës të ne, fillimisht trajtoi çështjet teorike dhe të hulumtimeve të bëra për çështjet e dhunës, të drejtave të njeriut dhe të nxënësve në Kosovë dhe në vendet tjera.

Ekipi hulumtues konstaton se janë bërë disa hulumtime për dhunën në shkollë, nga donacione kryesisht nga UNICEF, por të realizuara kryesisht nga OJQ dhe jo nga institucione shkencore të mirëfillta. Të gjitha hulumtimet e analizuar nga ekipi hulumtues objekt qendror kanë pasur dhunën fizike mësimdhënës-nxënës, nxënës-nxënës. Ndërsa dhuna verbale është përmendur vetëm në kuadër të llojeve të dhunës.

Qëllimi ynë ishte konstatimi i dhe verifikimi i mendimit se në shkollë ndaj nxënësve mësimdhënësit përdorin një varg fjalësh fyese dhe të rënda. Për ta realizuar këtë hartuam dy pyetësor, një për nxënës dhe një për mësimdhënës. Përcaktuam popullacionin dhe mostrën. Për popullacion zgjodhëm nxënësit e klasës së tetë. Në bazë të kësaj caktuam mostrën prej 13 shkollave të klasës së tetë. Nga të njëjta shkollë përzgjedhëm mësuesit të cilët punojnë në të njëjta shkollë.

Me qëllim të përfaqësimit më të mirë të problemit zgjodhëm shkollë nga fshati dhe nga qyteti. Hulumtimi u realizua nga ekipi dhe plotësimi i pyetësorëve nga ana e nxënësve u bë në prani të një ose dy hulumtuesve por pa prezencën e mësimdhënësve ose të dikujt tjetër nga shkollë.

Lexuesi do të gjejë të dhëna interesante jo vetëm për prezencën e fyerjeve në shkollë, por edhe mendimet dhe reagimet e nxënësve ndaj tyre. Nëpërmjet tyre "lexojmë" edhe ndjenjat dhe ndjeshmërinë e nxënësve ndaj mësimdhënësve që iu drejtohen atyre me fjalë e fyerje të ndryshme. Janë

disa nga fjalët dhe shprehjet të cilat thuaja janë bërë rutinë në fjalorin e përditshëm të mësimeve dhe për të cilat ata nuk janë të vetëdijshëm se ndikojnë në prishjen e raportit me nxënës ose se i dërgojnë mesazh të tërthortë atij. Hulumtimi paraqet një bazë të mirë për ndërmarrjen e hapave të tjerë me qëllim të përmirësimit të praktikave mësimore dhe të klimës në shkollat tona.

Kapitulli I

1.1. Ideja për hulumtim

Ideja për hulumtim doli nga analiza dhe njohja e praktikës së shkollës sonë. Gjatë bisedave me nxënës, të niveleve të ndryshme dalin informata të cilat nuk mund të shihen nga jashtë shkollës. Në Kosovë, por edhe jashtë, janë bërë hulumtime e trajtime të ndryshme lidhur me dhunën në shkollë, atë fizike sidomos. Ndërsa sa i përket aspekteve të dhunës verbale nuk është bërë ndonjë hulumtim i mirëfilltë deri më tani. Janë disa vështrime kur bëhet fjalë raporti për të drejtat e fëmijëve.

Kjo ishte ideja fillestare për t'iu qasur një teme të këtillë, sa interesante aq edhe e rëndësishme për mbarëvajtjen e procesit mësimor në shkollë. Sidomos krijimit të klimës pozitive në klasë.

1.2. Objekti dhe qëllimi i hulumtimit

Hulumtimi është fokusuar në dy faktorët kryesor në shkollës: nxënësi dhe mësuesi. Cilësia e raportit midis këtyre dy faktorëve është me rëndësi si për mësuesin e nxënësin ashtu edhe për krijimin e klimës së mirë në klasë dhe në shkollë në përgjithësi.

Objekt hulumtimi është shprehjet jo të përshtatshme që përdorin mësuesin ndaj nxënësve. Këto shprehje/fjalë janë të shumta dhe të ndryshme. Në hulumtim kemi trajtuar çështjen e prezencës/dendurisë së tyre, por edhe qëndrimet dhe reagimet e nxënësve ndaj këtyre.

Identifikimi i fjalëve dhe shprehjeve prezent, jo të përshtatshme ndaj nxënësve, ndikon apo jo në qëndrimin e tyre ndaj mësuesit dhe ndaj shkollës në përgjithësi. Përdorimi i tyre ndaj nxënësve a përbën një aspekt të mohimit të të drejtave të nxënësve dhe ndaj lirisë së të shprehurit.

Vetëm identifikimi i gjendjes lidhur me këtë çështje nuk është qëllim më vete, por gjetja e rrugëdaljes dhe propozimi i hapave konkrete është një ndër qëllimet kryesore të këtij hulumtimi.

Reagimi i nxënësve në hulumtim, por edhe në jetën e përditshme, është një sinjal alarmues për institucionet dhe për shoqërinë që të ndërmerren hapa konkret për përmirësimin e cilësisë së raporteve mësues-nxënës. Është bërë njëfarë praktike që për çfarëdo që ndodhë në shkollë, fajtor kujdestar të gjendet vetëm nxënësi, por jo edhe pjesëmarrësit tjerë në këtë proces. Por, sipas mendimit tonë, përgjegjës i parë për krijimin e klimës cilësore në shkollë është mësuesi. Nga mënyra e sjelljes dhe e reagimit të

tij, taktit pedagogjik, varet shumë atmosfera dhe raporti me nxënësit në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies në shkollë. Pra mësuesi duhet të jetë agjenti kryesor i ndërtimit të raporteve pozitive me nxënësit. Për krijimin e këtij raporti nuk mjafton vetëm përgatitja profesionale e mësuesit, p.sh., matematikan i mirë, gjeograf i mirë etj., pa një parapërgatitje të mirë në fushën e pedagogjisë dhe të psikologjisë. Nuk thuhet kot: “ishte mësues i lindur”, ose “i lindur për mësues”.

1.3. Realizimi i hulumtimit

Realizimi i hulumtimit është bërë në periudhën 2011/12. Pas aprovimit të projektit nga ana e KSH kemi bërë pilotimin e Pyetësorëve në një shkollë. Pastaj kemi bërë ndryshimet dhe plotësimet nevojshme në pyetësor dhe kemi nisur zbatimin e pyetësorit në terren/shkolla.

Hulumtimi është realizuar me dy pyetësor, njëri për mësimdhënës dhe tjetri për nxënës.

Hulumtimi në terren u realizua kryesisht gjatë ditëve të mësimin për shkak të mostrës së zgjedhur. Plotësimi i pyetësorëve është bërë në prezencë dhe ka zgjatur: për nxënës deri 20 minuta dhe për mësimdhënës deri në 10 minuta.

Krahas grumbullimit të të dhënave nga terreni kemi bërë kodimin e pyetësorëve dhe vendosjen e të dhënave në sistemin e përgatitur në Excel. Përgjigjet e dhëna janë shënuar me shifra ndërsa pyetjet /kërkesat pa përgjigje i kemi shënuar me -1.

1.3.1. Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi është realizuar bazuar në metodologjinë kuantitative dhe kualitative. I ka parapri qasja kabinetike gjatë së cilës kemi shqyrtuar hulumtimet dhe dokumentet tjera lidhur me temën që kemi për hulumtim. Të gjitha politikat e aprovuara ndalojnë çfarëdo dhune ndaj nxënësve. Kemi konstatuar se çështja e dhunës ndaj nxënësve në Kosovë kryesisht është trajtuar ajo fizike ndërsa pjesa e dhunës verbale, me anë të fyerjeve, fjalëve nënçmuese e përjashtuese nuk është trajtuar sa e si duhet. Një trajtim që është bërë nga ana e KEC ka mbetur vetëm në nivelin e regjistrimit të fjalëve fyese e përçmuese ndaj nxënësve, por jo edhe reagimet dhe qëndrimet e nxënësve ndaj tyre. Hulumtimi është realizuar me anën e dy pyetësorëve.

1.3.2. Objektivat kryesor të hulumtimit

1. Të hulumtohen aspektet të dhunës verbale nga ana e mësimitdhënësve ndaj nxënësve në shkollën e mesme të ulët në Kosovë,
2. Të vlerësohet/matet denduria e përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve verbale jo të këndshme për nxënësit,
3. Të shihet/vlerësohet se si pranohen/konsiderohen këto nga ana e nxënësve, si dhunë verbale, apo vetëm fyerje, nënçmim...
4. Të pasqyrohen dallimet midis qëndrimeve të nxënësve dhe mësimitdhënësve për praninë e dhunës verbale në shkollë,
5. Të vlerësohet se çfarë është ndikimi i këtyre shprehjeve në sjelljet e nxënësve dhe në qëndrimin e tyre ndaj shkollës dhe mësimitdhënësve, dhe
6. Të nxirren rekomandime dhe orientime për përmirësimin e kësaj çështjeje.

1.3.3. Popullacioni dhe mostra

Popullacioni ndahet në dy shtresa: 1. e përbëjnë nxënësit e klasës së tetë të shkollës së mesme të ulët. Dhe 2. mësimdhënësit a tyre. Për ta balancuar gjendjen e mostrës në aspektin gjeografik kemi përzgjedhur shkolla nga qyteti dhe nga fshati. Shpërndarja është bërë sipas rajoneve.

Tabela 1. Përbërja e mostrës së hulumtimit

Nr.	Komuna	Nxënës		Mësimdhënës	
		F	Q	F	Q
1	Prishtinë		39		9
2	Podujevë	14		5	
3	Vushtrri	28		6	
4	Prishtinë	17		6	
5	Gjilan		30		9
6	Gjakovë		28		8
7	Prizren	24		6	
8	Prizren		43		8
9	Gjilan	21		6	
10	Kamenicë	19		6	
11	Rahovec		28		8
12	Viti	30		6	
13	Viti		46		9
Krejt		153	214	41	52

Siç shihet nga tabela Mostrën e përzgjedhur për hulumtim e përbëjnë gjithsej 367 nxënës dhe 93 mësimdhënës. Prej tyre nga shkollat e fshatit janë 153 nxënës dhe 41 mësimdhënës ndërsa nga shkollat e qytetit janë 214 nxënës dhe 52 mësimdhënës.

Mendojmë se struktura e mostrës, shpërndarja gjeografike e saj, është e mjaftueshme për të nxjerr përfundime të qëndrueshme lidhur me dukurinë e caktuar në fokus të hulumtimit.

1.3.4. Metodatat e hulumtimit

Natyra e hulumtimit na ka kushtëzuar zbatimin e një metodologjie të kombinuar për grumbullimin, analizën dhe përpunimin e të dhënave. Fillimisht kemi bërë trajtimin teorik të problemit të përzgjedhur nëpërmjet metodës së analizës teorike, analizës së dokumentacionit, metodën përshkruese dhe metodën statistikore.

1.3.4.1. Teknikat e hulumtimit

Marrjen e mendimeve dhe qëndrimeve të subjektëve të përfshirë në mostër e kemi realizuar me anë të Anketës. Ndërsa për instrument kemi shfrytëzuar Pyetësorët e anketës. Secili pyetësor përbëhet nga tetë çështje kryesore në të cilat subjektet e mostrës janë përgjigjur sipas alternativeve të dhëna për pyetje/kërkesa të caktuara. Të dy pyetësorët kanë informatat e përgjithshme, si vendi, mosha gjinia, kualifikimi, përvoja etj. (shih pyetësorët në fund). Nga tetë pyetjet dy prej tyre janë të hapura në të cilat edhe nxënësit edhe mësuesit është dashur të japin mendimin e vet. Ndërsa një pyetje ka një alternativë për të dhënë përgjigje plotëse, të cilën nuk ka qenë e detyrueshme që ta plotësojnë.

Pyetësori (P/nx/1) për nxënës çështja e parë kërkohet mendimi i nxënësve për Raportin arsimtar-nxënës, ku për secilën kërkesë nxënësit kanë pesë mundësi për të shprehur shkallën e pajtueshmërisë ose të papajtueshmërisë me konstatimet e dhëna (12) në pyetësor. Në pyetjen e dytë janë listuar 15 shprehje më reprezentative për të cilat nxënësit kanë dhënë shpeshësinë e përdorimit të tyre ndaj nxënësve nga ana e mësuesit. Pyetja e 3, ka ngjashmëri me të dytën ku janë përfshirë gjithsej 14 fjalë e shprehje për të cilat nxënësit kanë zgjedhur alternativat se cilat i përdorin të gjithë arsimtarët dhe cilat disa, por edhe se sa i pengon përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve të caktuar ndaj tyre. Ndërsa pyetja 4 ofron mundësinë e përcaktimit të nxënësve lidhur me shkallën e pajtimit/mospajtimit me fjalët dhe shprehjet me të cilat arsimtarët iu drejtohen atyre.

Pyetja 5 ka të bëjë me qëndrimet e nxënësve lidhur e atë se sa ndikon përdorimi i këtyre fjalëve dhe shprehjeve ndaj tyre në raportin nxënës-arsimtar. Nxënësit kanë pasur mundësi të zgjedhin disa nga 4 alternativat dhe një të shtojnë mendimin e lirë.

Pyetjet 6 dhe 7 janë të hapura në të cilat nxënësit kanë pasur mundësi të shprehin qëndrimet e veta për arsimtarin/en.

Në pyetjen e 8 nxënësit kanë shprehur qëndrimin e tyre për shkallën e ndjeshmërisë që kanë nëse ndaj tyre është përdorur ndonjëherë ndonjë fjalë a shprehje e tillë fyese.

Pyetëtori Pm2, për mësimdhënës gjithashtu përbëhet nga tetë fusha dhe informatat e përgjithshme për mësimdhënës, lënda mësimore, moshë, gjinia, kualifikimi dhe përvoja në arsim. Çështja e parë ka të bëjë me klimën, apo raportin mësues-nxënës. Janë gjithsej 12 mundësi në të cilat ata mund të shprehin pesë shkallë të pajtimit/mospajtimit. Disa nga konstatimet janë të përbashkëta me të njëjtën çështje të kërkuar nga nxënësit. Shkalla e pajtimit/mospajtimit është e njëjtë. Me këtë kemi dashur të krahasojmë qëndrimet dhe pajtimet a mospajtimet me gjendjen e raporteve ekzistuese në shkollë.

Në pyetjen e dytë kërkohet të shprehet raporti personal i mësuesit me nxënësit. A ka momente kur mësuesi humb durimin ndaj nxënësve duke përdorur fjalë e shprehje të rënda ndaj tyre.

1.3.5. Organizimi i hulumtimit

Hulumtimi është bërë në bazë të projektit të hartuar, si pjesë e planit të punës së sektorit për vitin 2011. I njëjti projekt është dërguar në Këshillin Shkencor nga i cili është dhënë vlerësimi se mund të vazhdojë zbatimi i hulumtimit.

Shkollat e përzgjedhura për hulumtim janë informuar paraprakisht për ditën dhe qëllimin e hulumtimit. Ekipi hulumtues, zakonisht nga dy vetë, kanë shkuar në shkollë dhe kanë zbatuar pyetësin për hulumtim. Realizimi i pyetësorit me nxënës është bërë pa prezencën e arsimtarëve ose të drejtorit të shkollës. Vetëm hulumtuesit kanë qenë prezent në klasë. Gjatë përpunimit të dhënave/pyetësorëve kemi bërë pastrimin e pyetjeve në të cilat nuk kemi marrë përgjigje të sakta, të palexueshme ose të cilat i kemi konsideruar të panevojshme për hulumtimin.

1.4. Përkufizimi i nocionit fyerje, përqeshje, dhunë verbale

Fyerje, përqeshje apo dhunë verbale?

Nga trajtimi i burimeve të ndryshme nuk kemi hasur në shumë trajtime të këtij koncepti. Titulli i punimit/hulumtimit doli nga përgjigjet e liria të nxënësve, në të cilat ata paraqesin ndjeshmërinë e tyre, por edhe gjendjen shpirtërore pas përdorimit të këtyre fjalëve dhe shprehjeve aspak të

këndshme, qoftë ndaj tyre ose ndaj shokut të tyre. Prandaj edhe vendosëm që ta përforcojmë këtë koncept, i cili besojmë se do të bëhet pjesë e fjalorit të të drejtave të fëmijëve.

Ushtrimi i dhunës ndaj të tjerëve nuk nënkupton vetëm atë fizike. Shpesh më rëndë ndihemi kur dikush na drejtohet me një fjalë të rëndë e fyese se sa kur marrim ndonjë shpullë, tërheqje veshi etj. “Fjala vret më shumë se plumbi” thonë në popull.

Por një gjë është e ditur: natyra e njeriut, nuk i duron asnjëherë, as dhunën a ndëshkimin fizik, por as atë verbal. Që të dyja shkaktojnë dhimbje, sidomos kur ato janë publike, në prezencën e të tjerëve. Fjalët dhe shprehjet fyese zakonisht thuhet në prezencë të tjerëve, në klasë-shkollë.

Nëse “fjala vret” atëherë emërtimi “dhunë verbale” na duket se është i drejtë.

Fyerje: Fjalë a qëndrim që të cenon në nder a të prek në sedër; ndjenja që provojmë kur na fyen dikush.¹ FGJSSH. Vers. Elektronik

Ndërsa në vendet tjera, thuaja është e palogjikshme fyerja/ofendimet e nxënësve nga ana e mësuesve. Por edhe për ta fjalët e këtilla quhen ngacmime verbale të cilat “...si është thirrja me emër tjetër dhe të tërthortë, të tilla si ato përjashtuese, mund të jenë po aq të dëmshme sa ngacmimet fizike”².

Fyerje apo ofendim? Në fjalorët e gjuhës shqipe janë sinonime. Sipas P. Nushit, “Ofendim, ~i m. Fyerja që i bëhet tjetrit me fjalë a me sjellje të veçanta, me të cilën cenon dinjitetin, nderin, sedrën, etj. e individit tjetër. Ofendimi është formë e shprehjes së agresivitetit të individit ndaj tjetrit.”³

Autori përmend edhe fjalët por edhe sjelljet e veçanta që përdoren ndaj tjetrit. Në disa raste trajtohet edhe si formë e agresivitetit verbal ndaj tjetrit. Sa i përket fjalës përqeshje në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe përkufizohet si “Fjalë ose lëvizje që bëhen për të përqeshur dikë; qëndrim tallës e mospërfillës ndaj dikujt a diçkaje.”⁴ Që të dyja shprehjet/fjalët fyerje dhe përqeshje hyjnë në domenin e fjalëve të cilat prekin dinjitetin e njeriut. Fëmijët janë shumë të ndjeshëm ndaj tyre.

Edhe sa i përket fjalës Dhunë, në FGJSSH, në kuptimin nën 2 thuhet: “Shndërrim, poshtërim a turp i madh që i bëhet dikujt, cenim i rëndë i nderit të dikujt me vepra *a me fjalë*; fyerje e rëndë që i bëhet dikujt.”⁵ Fjala e nënvizuar/theksuar në *italik* specifikon përveç tjerash edhe fjalën si pjesë

¹ FGJSSH, Vers. Elektronik,

² Bullying among youngchildren: A guide for teachers and carers, fq. 5....

³ Dr. Pajazit Nushi, Fjalori i psikologjisë, IAB, Prishtinë, 1987, fq. 189.

⁴ FGJSSH, Vers. Elektronik

⁵ Po aty.

të mjeteve të dhunës që mund të ushtrohet ndaj tjetrit. Vetë ajo popullit “fjala vret...” tregon për shkallën e ndjeshmërisë së njeriut ndaj cilësimeve negative që i bëhen.

A thua, si ndihen nxënësit e moshës 15/16 vjeçare kur iu drejtohem me fjalët “gomar”, “idiot”, “kryemadh”, “rrugaç” etj.? Sidomos pesha e këtyre fyerjeve rritet kur ato thuhet në prezencën e të tjerëve, shokëve e shoqeve, simpative e antipative. Shkallën e ndjeshmërisë ndaj këtyre epiteteve e kanë treguar nxënësit e përfshirë në hulumtim në pyetjet e hapura.

Kapitulli II

2. Hulumtimi kabinetik

Paraprakisht kemi shfletuar dokumente dhe botime të bëra në Kosovë lidhur me dhunën ndaj nxënësve. Me të gjitha politikat, dhe dokumentet tjera të hartuar, është e ndaluar çfarëdo dhune ndaj nxënësve. Por sa i përket hulumtimeve nuk kemi hasur në ndonjë hulumtim, i cili për objekt ka pasur dhunën verbale. Në një botim të KEC*, në kuadër të të drejtave të fëmijëve është dhënë edhe një listë e fyerjeve të cilat mësimdhënësit u drejtojnë nxënësve.* është me rëndësi të ceket këtu se sa i përket etnive në Kosovë pothuaj është e njëjta gjendje dhe praktikë e përdorimit të fjalëve fyese ndaj nxënësve nga ana e mësimdhënësve. Në të njëjtin hulumtim të bërë nga KEC shkruan: “Përqindja e nxënësve në gjuhën turke dhe serbe që janë deklaruar se ndonjëherë janë ofenduar rëndë nga mësimdhënësit është e përafërt dhe mjaft e lartë (30.08% në gjuhën serbe dhe 30.99% në gjuhën turke, ndaj 23.53% në gjuhën shqipe.”⁶ Po në të njëjtin burim përqindja e nxënësve të cilët nuk janë deklaruar fare është më e madhe te nxënësit shqiptar. Nuk kemi hasur në ndonjë hulumtim të ngjashëm në vendet përreth. Kryesisht hulumtimet janë përqendruar në dhunën fizike ndaj nxënësve, ose në raportin mësues-nxënës, nxënës-nxënës ose prindër-fëmijë.

Sa i përket letërsisë, dokumenteve dhe hulumtimeve të bëra në vendet tjera, çështja e ngacmimeve, ofendimeve trajtohet vetëm në relacionin nxënës-nxënës, por jo edhe në relacionin mësimdhënës-nxënës. Në një bisedë me një ekspert të jashtëm lidhur me gjendjen e kësaj dukurie në vendet tjera ai shprehet se kjo është e ndaluar me ligj sikurse dhuna fizike. (Alexi).

Edhe te ne kjo çështje është e sanksionuar me ligj. Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Neni 4, Alinea 2 thotë: “Ndalohet ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet arsimore dhe aftësuese...”⁷ Fjalët e nënvizuar përfaqësojnë pjesën e fyerjeve a përqeshjeve me të cilat nënçmohet individi, këtu nxënësi. Por nëse analizojmë fjalën ndëshkim, sipas FGJSSH, del se ndëshkimi nënçmues është masë për një faj që do ta ketë bërë nxënësi. “**Ndëshkim.** Masë dënimi që merret kundër dikujt për një faj,

* KEC, Kosovo Education Center, Qendra Arsimore e Kosovës.

* shih Të drejtat e fëmijëve në sytë e nxënësve kosovarë, KEC, Prishtinë 2004, fq.82-85.

⁶ Halim Hyseni, Të drejtat e fëmijëve në sytë e nxënësve kosovarë, Refleksione nga një studim, KEC, 2004, fq. 81.

⁷ Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Prishtinë 2011, fq.7.

dënim”.⁸ E njëjta gjë mund të thuhet edhe për pjesën tjetër të fjalës të përdorur në këtë ligj: nënçmues. Po sipas FGJSSH, pika 2 sqaron: “Nuk i jap rëndësinë e duhur dikujt a diçkaje, nuk e vlerësoj si duhet dhe kjo sjell pasojë të dëmshme.”⁹ Mendojmë se përdorimi i fjalës poshtëroj, poshtërim i përgjigjet më së miri fushës së ndëshkimeve verbale, fyerjes. Pos sipas FGJSSH, kjo fjalë ka këtë domethënie: “POSHTËROJ kal. 1. E ul dikë në sy të të tjerëve, i marr nderin *duke e sharë e duke e fyer rëndë*, duke e trajtuar keq etj., e bëj me turp; ul nderin, personalitetin, figurën e dikujt, nxij.”¹⁰ Është e vërtetë se fyerja në prezencë të tjerëve, sidomos, është ndjenjë shumë e rëndë e secilit individ. Këtë e kemi vërejtur edhe me hulumtimin tonë. Këtë e ka shprehur edhe populli me shprehjet e shumta të cilat janë dhënë për peshën e fjalës.

2.1. Të dhënat për Dhunën ndaj nxënësve në Kosovë

Pas vitit 2000 janë disa trajtesa për dhunën ndaj fëmijëve në Kosovë. Hulumtimet dhe trajtesat e tilla kryesisht kanë të bëjnë me dhunën fizike ndaj fëmijëve, në shkollë apo jashtë saj, për abuzimet e ndryshme, puna e rëndë, etj. Një hulumtim i këtillë është financuar nga UNICEF (2009) në kuadër të të drejtave të fëmijëve, pastaj MASHT&UNICEF(2005) Hulumtimi mbi dhunën në shkollat e Kosovës, si dhe një varg shkrimesh gazetareske për aspekte të ndryshme të dhunës dhe të shkeljes së të drejtave të fëmijëve. Në vitin 2011 UNICEF mbështeti hulumtimin e KEC për botimin e doracakut “*Parandalimi i dhunës në shkollë*”, i cili i kushtohet krijimit të mjedisoreve të sigurta në shkollë. Në të trajtohen edhe aspekte të ndryshme të dhunës që ushtrohet në shkollë ndaj nxënësve. ... Janë hartuar dokumente dhe politika të ndryshme me të cilat mëtohet të parandalohet çfarëdo dhune ndaj nxënësve në shkollë në kuadër të të drejtave të njeriut...

⁸ Shih në: FGJSSH. Versioni elektronik.

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty.

Kapitulli III

3. Përpunimi i të dhënave

Në hulumtim kemi përfshirë mësimdhënës dhe nxënës të klasës së tetë. Gjithashtu nxënësit dhe mësimdhënësit janë nga shkollat qytet-fshat në mënyrë që të shohim shkallën e prezencës së objektit që po hulumtojmë në të dy shtrirjet gjeografike-social.

Me pyetësor kemi kërkuar këto të dhëna nga mësimdhënësit dhe nxënësit. Vendi ku gjendet shkolla, gjini, sukcesi i nxënësve në vitin paraprak, moshë e mësuesve, përvoja në arsim, kualifikimi dhe lloji, shkollimi i prindërve të nxënësve.

Sa i përket të dhënave të përgjithshme për mësuesit janë: gjithsej të përfshirë 93.

Tabela 2. Struktura e mësimdhënësve

Gjinia		Gjeografia		Kualifikimi						Moshë					
F	M	Fsh.	Qyt.	shl p	%	Fk.	%	M A	%	22-35	%	36-50	%	51-64	%
47	46	41	52	38	40	51	57	4	3	31	34.8	34	38	24	27
51%	49%	44%	46%												

Struktura gjinore e mësuesve është shumë e balancuar, 47 me 46, ose 51 me 49%. Ndërsa sa i përket shtrirjes së shkollave të përfshira në hulumtim dominojnë mësuesit nga qyteti 52 me 41. kjo është normale sepse në qytete janë të përqendruar numër më i madh i nxënësve. Sa i përket kualifikimit të mësuesve të përfshirë në hulumtim dominojnë ata ma fakultet 51 me 38 dhe vetëm 4 kanë qenë me përgatitje master. Ndarjen sipas moshës e kemi bërë në tre nivele, sipas asaj që ata vet kanë deklaruar në pyetësor. Moshë më e ulët 22-35 ishin 34.8%, moshës 36-50, 38.2% që për një nuancë dominon dhe asaj 51-64 ishin 27% e pjesëmarrësve në hulumtim. Nuk

kanë deklaruar moshën 4 ose 4.30% e mësimdhënësve të përfshirë në mostër.

Sa i përket strukturës së nxënësve sipas gjinisë 171 janë vajza dhe 189 djem. Shtatë nuk kanë deklaruar gjininë. Ndërsa sa i përket shtrirjes së shkollave 212 janë nxënës të shkollave në qytet dhe 155 në fshat ose gjithsej 367.

3.1. Mësimdhënësit dhe nxënësit për klimën në shkollë

Meqenëse hulumtimi është bërë në të njëjtën ditë dhe në të njëjtat shkolla, mësues dhe nxënës, atëherë paraqitjen e të dhënave/rezultateve do ta bëjmë edhe për mësues edhe për nxënës. Disa pyetje, të cilat ndërlidhen me qëllimin e hulumtimit do t'i paraqesim duke i krahasuar ato midis dy subjekteve të përfshirë në mostër.

Fillimisht do t'i prezantojmë rezultatet dhe mendimet e mësuesve. Prezantimin e rezultateve do ta edhe duke ndërlidhur dhe krahasuar çështjet me rëndësi për të cilat është bërë hulumtimi. Në tabela do të prezantohen rezultatet, paraqiten grafike si dhe krahasimet midis tyre.

3.2. Shkalla e pajtimit të mësimdhënësve me klimën n shkollë

Çështja e parë, kërkesa në pyetësor, kemi kërkuar që të marrim qëndrimin e mësuesve lidhur me raportet e tyre me nxënësit. Në kërkesën për shkallën e pajtimit me klimën në shkollën tyre ata janë përgjigjur si në tabelën në vijim.

Tabela 3. Mendimet e mësimeve për klimën në shkollë

Klima në shkollë sipas mendimit të mësimeve	Shkalla e pajtimit				
	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajt.	Nuk pajt. fare
1. Në shkollë mbretëron klimë e këndshme pune e mësimi	53	28	12	x	x
2. Raportet MËSIMDHËNËS-NXËNËS janë të shkëlqyeshme.	43	30	18	1	x
3. Ka raste kur nxënësit nuk i kuptojnë hallet e arsimitarëve.	12	39	18	14	5
4. Ka raste kur mësimeve nuk i kuptojnë hallet e nxënësve.	9	25	21	27	6
5. Shpesh më qesin prej takti dhe më humbë durimi me ta	2	4	15	35	34
6. Disa nxënës vetëm “dajaku” i qetëson	4	5	12	33	39
7. Ka raste kur përdori ndonjë fjalë të rëndë ndaj tyre	x	2	5	33	50
8. Njoh kolegë që shpesh përdorin fjalë fyese ndaj nxënësve.	3	10	12	29	36
9. Më ka ndodhur të kërkojë ndihmë nga drejtori etj., për të dalë nga situata e palakmueshme me nxënës	3	3	7	30	48
10. Më shko mendja ta ndërrojë këtë shkollë. Nuk ia dal dot me ta.	x	2	x	18	69
11. Kemi prindër që na ndihmojnë shumë në punën me nxënës	22	41	18	3	8
12. Kemi prindër që kurrë nuk interesohen për fëmijët e tyre	28	22	18	19	5

Plotësisht pajtohen se në shkollën e tyre mbretëron klimë e mirë 53 mësues ose afro 57% e tyre. Ndërsa pjesërisht pajtohen 28 ose afro 30%, ndërsa pjesërisht pajtohen 12 ose rreth 13%, derisa asnjë nuk ka shprehur mospajtim me klimën që mbretëron në shkollën ku ata punojnë. Por te nxënësit për pyetjen e ngjashme kemi pak ndryshime. Edhe nxënësit pajtohen, shumica, me këtë konstatim, për dallim që rreth 6% e tyre nuk pajtohen se ekziston klimë e mirë për punë dhe mësim. Te mësuesit kishim zero për qind të cilët nuk pajtoheshin. Këtu mund të ndodhë që shumë prej të anketuarve, nxënës dhe mësimeve, ndoshta nuk e kanë pasur të qartë

shprehjen “klimë pune e mësimi”. Klimën e mirë, të këndshme e kushtëzojnë edhe raportet mësime-dhënëse-nxënëse.

Sa i përket raportit me nxënësit, se ato janë të shkëlqyeshme, 43 ose 46% pajtohen plotësisht se raportet janë të shkëlqyeshme, 30 ose afro 32% pajtohen ndërsa vetëm 18 ose 19% vetëm pjesërisht pajtohen me këtë. Vetëm një është deklaruar se nuk pajtohet dhe asnjë se nuk pajtohet fare me atë se në shkollë ekzistojnë raporte të shkëlqyeshme me nxënësit. Edhe te kjo çështje kemi një dallim të nxënësit. Rreth 10% nuk pajtohen ose fare nuk pajtohet me këtë konstatim.


Në konstatimin nën 3 *“Ka raste kur nxënësit nuk i kuptojnë hallet e arsimitarëve”*, kemi laramani në përgjigjet e tyre. Pajtohen plotësisht 12 arsimitarë ose 13%, pajtohen 39 ose 42%, pjesërisht me këtë pajtohen 18 ose rreth 19%, nuk pajtohen 14 ose 15% derisa fare nuk pajtohen vetëm 5 ose 0,54%. Sa u përket mendimeve të nxënësve kemi dallime të mëdha në krahasim me mësuesit, ku afro 28% plotësisht pajtohen se nganjëherë arsimitarët nuk i kuptojnë hallet/problemet e tyre, rreth 38% pajtohen dhe rreth 17% pjesërisht pajtohen me këtë, kundër 13% që nuk pajtohen dhe 3% të cilët fare nuk pajtohen se arsimitarët nuk i kuptojnë hallet e tyre.

Se sa të ndjeshëm janë nxënësit ndaj fyerjeve që ju bëhen nga mësuesit e tyre tregon edhe shkalla e lartë e pajtimit me kërkesat 5,6,7,8 tek Raporti arsimitar nxënëse në pyetësor: rreth 70% e nxënësve “Hidhërohen kur arsimitari nuk e kupton problemin e tij”, rreth 72% e nxënësve pajtohen se “Nervozohen shumë kur arsimitari nuk i dëgjon arsyetimet e tij”, rreth 42% pajtohen se kanë qarë nëse ndonjë arsimitar ka përdorur fjalë të rënda ndaj tij dhe rreth 77% pajtohen se “Nuk u pëlqejnë arsimitarët që përdorin fjalë fyese ndaj nxënësve”. Për këto më gjerësisht në pjesën kur trajtojmë rezultatet për nxënësit.

Është interesant përgjigjet nën 4 që për dallim nga ajo nën 3 tani kërkohet se sa mësuesit nuk i kuptojnë hallet e nxënësve, ku 9 pajtohen plotësisht, ose rreth 9.7%, pajtohen 25 ose afro 27% derisa pjesërisht pajtohen 21 ose afro 23%, ndërsa nuk pajtohen 27 ose 29% dhe fare nuk pajtohen janë deklaruar 6 ose rreth 6.5%. Nga kjo del se, nga 88 mësues që kanë dhënë përgjigje në njërin nga të mundshmet 55 ose rreth 63% prej tyre pajtohen me konstatimin se ka raste kur ata nuk i kuptojnë hallet që kanë nxënësit, për ç’shkak edhe mund të vije deri te ndëshkimi ose përdorimi i fjalëve të rënda dhe fyerjeve. Me çështjen e humbjes së durimit me nxënësit pjesërisht janë pajtuar 15 prej tyre ose 16%, ndërsa nuk pajtohen 35 ose 38% dhe fare nuk pajtohen 34 ose afro 37%. Afërsisht të njëjtat përgjigje i kemi marrë edhe në kërkesën në 6, me të cilën kërkohet pajtimi/mospajtimi i tyre lidhur me dhunën fizike ose dajakun. Me këtë, pjesërisht pajtohen 12 ose

rreth 13% ndërsa 33 gjegjësisht 39 nuk pajtohen ose fare nuk pajtohen me këtë, ose mbi 77% e mësimdhënësve. Por vetëm 4 dhe 5 pajtohen plotësisht ose pajtohen se dajaku i qetëson, që i bie afro 9.7%, por po ti shtohet kësaj edhe 13% të cilët pjesërisht pajtohen na del përqindje e lartë e atyre që mendojnë për dajakun ose edhe e përdorin dhunës fizike ndaj nxënësve. Kërkesa nën 7 ka të bëjë drejtpërdrejtë me çështjen për të cilën edhe është bërë hulumtimi. Dhe kemi marrë këtë shkallë pajtimi/mospajtimi. Asnjë nuk pajtohet plotësisht se ndonjëherë përdorë fjalë të rënda ndaj nxënësve, gjë e cila është në kundërshtim të plotë me deklaratat e nxënësve. Ndërsa vetëm 2 dhe 5, ose 7.5% prej tyre, pajtohen ose pjesërisht pajtohen se ndonjëherë përdorin fjalë fyese ndaj nxënësve. Por 33 gjegjësisht 50 prej tyre, ose 89%, nuk pajtohen se këtë e bëjnë ndonjëherë ndaj nxënësve të tyre. Derisa në kërkesën se “Njoh kolegë që shpesh përdorin fjalë fyese ndaj nxënësve” kemi një pasqyrë tjetër nga ajo paraprake. Prej tyre 3 dhe 10, ose afro 14% deklarojnë se ndonjëri nga kolegët e tij/saj përdor kësi fjalë/shprehje ndaj nxënësve. Por nëse kësaj i shtojmë edhe 12 ose rreth 13% që pjesërisht pajtohen me këtë, atëherë na del se afro 27% prej tyre kanë ndonjë koleg/e i cili/e cila përdor kësi fjalë e shprehje të rënda ndaj nxënësve. Kjo tregon, tërthorazi se sa të sinqertë ishin në përgjigjet e tyre paraprake. Vetëm 13 (3+3+7) ose 14% prej tyre, pajtohen në një shkallë se ju ka ndodhur që të kërkojnë ndihmën e drejtorit sepse nuk mund t’ia dalin me disa nxënës. Por 78 ose mbi 84% këtë nuk e kanë kërkuar. Shumë kontradiktore dalin edhe përgjigjet në kërkesën për të paraqitur shkallën e pajtimit me bashkëpunimin me prindër. Në “*Kemi prindër që na ndihmojnë shumë në punën me nxënës*” 81 prej tyre ose 87% shprehin shkallë pajtimi me këtë. Por në kërkesën pas saj “*Kemi prindër që kurrë nuk interesohen për fëmijët e tyre*” 24 ose rreth 26% nuk pajtohen me këtë konstatim. Por 67 prej tyre ose 72% pajtohen në shkallë të ndryshme se vërtetë ka prindër të tillë. Kjo tregon për shkallë shumë të ulët të bashkëpunimit të mësimdhënësve me prindër ose të prindërve me shkollën. Në njëfarë shkalle kjo demanton shkallën e lartë të pajtimit të mësuesve se ekziston klimë e shkëlqyeshme në shkollë. Këtë e shohim edhe në grafikun në vijim.

Grafiku 1. Mendimi i mësimitdhënësve për klimën në shkollë



3.2.1. Qëndrimet e mësueseve lidhur me klimën në shkollë

Për të parë nëse ka dallime midis mostrës në përgjithësi dhe sipas gjinisë kemi përpunuar të dhënat për mësueset e anketuara dhe kemi marrë përgjigjet në vijim.

Në përbërjen e mostrës mësueset janë përfaqësuar me 46 ose 49%. Jo të gjitha kanë dhënë përgjigje në të gjitha kërkesat e pyetësorit. Në kërkesën e parë, me të cilën synonim të shohim mendimet e tyre lidhur me klimën që mbretëron në shkollën ku punojnë kemi këto rezultate. Të gjitha janë përgjigjur në pohimin në pyetësor “Në shkollën tonë mbretëron klimë e këndshme pune e mësimi” dhe atë 30 ose 61% pajtohen plotësisht me këtë, 12 ose 26% pajtohen dhe 4 ose rreth 7% pjesërisht pajtohen me këtë. Ndërsa nëse shohim mostrën e përgjithshme me këtë pajtohen afro 57% e mësimitdhënësve dhe pajtohen rreth 30% derisa pjesërisht pajtohen rreth 13% prej tyre.

Sa i përket elementit tjetër me rëndësi për klimën në shkollë “Raportet MËSIMDHËNËS-NXËNËS janë të shkëlqyeshme” krahasuar me mostrën mësueset shprehen këtë shkallë pajtueshmërie. Nga 45 sa janë përgjigjur në këtë 20 prej tyre ose rreth 44% pajtohen plotësisht, 17 ose 38% pajtohen dhe 8 ose 18% pjesërisht pajtohen se raportet me nxënës janë të shkëlqyeshme. Përqindjet këtu, në krahasim me mostrën, janë shumë të përafërta, me një luhatje të parëndësishme.

Tabela. 3.1. Qëndrimi i mësueseve lidhur me klimën në shkollë

	Pajtohem plotësisht	%	Pajtohem	%	Pajtohem pjesërisht	%	Nuk pajtohem	%	Nuk pajtohem fare	%
1. Në shkollë mbretëron klimë e këndshme pune e mësimi	30	61	12	26	4	7	0	0	0	0
2. Raportet MËSIMDHËNËS-NXËNËS janë të shkëlqyeshme.	20	44	17	38	8	18	0	0	0	0
3. Ka raste kur nxënësit nuk i kuptojnë hallet e arsimtarëve.	5	12	15	35	11	26	9	21	3	7
4. Ka raste kur mësimitdhënësit nuk i kuptojnë hallet e nxënësve.	1	2	11	26	8	19	18	42	4	9
5. Shpesh më qesin prej takti dhe më humbë durimi me ta	0	0	1	2	5	11	17	39	21	48
6. Disa nxënës vetëm “dajaku” i qetëson	1	2	1	2	5	11	18	39	21	46
7. Ka raste kur përdori ndonjë fjalë të rëndë ndaj tyre	0	0	0	0	2	4	12	27	31	69
8. Njoh kolegë që shpesh përdorin fjalë fyese ndaj nxënësve.	1		5		5		12		21	
9. Më ka ndodhur të kërkojë ndihmë nga drejtori etj., për të dalë nga situata e palakmueshme me nxënës	0	0	1	2	3	7	13	30	27	61
10. Më shko mendja ta ndërrojë këtë shkollë. Nuk ia dal dot me ta.	2	4	1	2	0	0	8	18	34	72
11. Kemi prindër që na ndihmojnë shumë në punën me nxënës	9	20	16	36	12	27	2	4	6	13
12. Kemi prindër që kurrë nuk interesohen për fëmijët e tyre	10	22	12	27	11	22	9	20	3	7

Kërkesat me rëndësi për hulumtimin janë nën 3,4,5 dhe 6 me anën e të cilave shihen raportet të cilat fshihen nga mësuesit/et. Pas këtyre edhe mund të fshihet problemi, a shkasi, për përdorimin e fjalëve të rënda/fyese ndaj nxënësve. Te mësueset kemi këto qëndrime në raport me mostrën e përgjithshme. Për pohimin se “Ka raste kur nxënësit nuk i kuptojnë hallet e arsimtarëve” vetëm 5 ose rreth 12% pajtohen plotësisht, por 15 ose rreth 35% e tyre pajtohen dhe 11 ose 26% pjesërisht pajtohen. Prej tyre 9 dhe 3

nuk pajtohen ose fare nuk pajtohen me atë se ka raste kur nxënësit nuk i kuptojnë hallet e mësuesve. Krahasuar me mostrën këtë më shumë e shprehin mësuesit se sa mësueset, sepse nga mostra janë 12 ose rreth 13% e atyre që pajtohen plotësisht me këtë, që i bie se 7 prej tyre janë mësues. Për sa i përket mospajtimit më këtë pohim kemi një dallim të theksuar në krahasim me mostrën. Rreth 24% e femrave (9+3) nuk pajtohen ose fare nuk pajtohen në krahasim me mostrën ku vetëm rreth 16% nuk pajtohen me pohimin se ka raste kur nxënësit nuk i kuptojnë hallet e mësuesve. Kjo përbindje te nxënësit për të njëjtën kërkesë shkalla e pajtimit është shumë më e lartë. Por sa i përket raportit tjetër se “*Ka raste kur mësuesit nuk i kuptojnë hallet e nxënësve*), kemi një proporcion të kundërt të shkallës së pajtueshmërisë/papajtueshmërisë. Tani mbi 50% e mësuesve nuk pajtohen me faktin se ka raste kur ato nuk i kuptojnë hallet e nxënësve. Këtu gati kemi një balancim të raporteve pajtueshmëri-papajtueshmëri ku vetëm pak mbi 50% shprehin se nuk pajtohen se ato nuk i kuptojnë hallet e nxënësve. Edhe lidhur me humbjen e durimit kemi përgjigje të përafërta me mostrën. Vetëm 6, rreth 12% ka shprehur një shkallë pajtueshmërie me këtë derisa pjesa më e madhe nuk pajtohet ose fare nuk pajtohet se ka raste kur humbin durimin.

3.3. Raporti i mësuesit me sjelljet e nxënësve në klasë

Me pyetjen e dytë me të cilin kemi kërkuar që mësuesit të shprehin raportin e tyre me nxënësit kemi parashtruar kërkesën “*Të ka ndodhur që ta humbësh durimin ndaj nxënësve...*” dhe kemi paraqitur 15 situata në të cilat ata kanë pasur mundësi të shprehin shkallën e pajtimit/mospajtimin me ato situata të mundshme ose edhe të cilat ndodhin në jetën e përditshme në shkollë.

Nga analiza e përgjigjeve të dhëna kemi marrë rezultate shumë interesante për situatat në të cilat ata deklarojnë se humbin durimin. Kur humb durimi edhe mund të vjen deri te përdorimi i fjalëve të rënda, por edhe i ndonjë forme të dhunës ndaj nxënësve. Përgjigjet e mësuesve për këtë aspekt i kemi paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 4. Humbja e durimit nga mësuesit

Rastet KUR mësues mund të humb durimin	Pajtohem plotësisht		Pajtohem		Pajtohem pjesërisht		Nuk pajtohem		Nuk pajtohem fare	
		%		%		%		%		%
1. Ndonjë nxënës hynë pas meje në klasë	6	7	34	37	19	20	21	23	13	14*
2. Ndonjë nxënës nuk i ka kryer detyrat e shtëpisë	8	9	25	27	30	32	17	18	11	12
3. Vjen pa libër a fletore në klasë/mësim.	4	4	20	22	20	22	34	37	12	13
4. Nuk janë të përqendruar dhe nuk kuptojnë përmbajtjen që u ligjëroj.	4	4	10	11	23	25	34	37	18	19
5. Bëjnë lëvizje dhe zhurmë derisa unë flasë	5	5	7	8	19	20	31	33	29	31
6. Përdorin fjalë fyese ndaj njëritjetrit.	4	4	5	5	21	23	31	33	28	30
7. Nuk pajtohen me vlerësimin (notën) tim	10	11	15	16	12	13	30	32	25	27
8. Njëri nxënës ka ngacmuar tjetrin	1	1	17	18	41	44	15	16	17	18
9. Hedhin mbeturina në klasë	3	3	11	12	26	28	27	29	25	27
10. Përtpin çamçakëz ose ushqime	3	3	12	13	25	27	28	30	22	24
11. Përdorin telefonin gjatë orës së mësimit	3	3	2	2	12	13	28	30	47	51
12. Vazhdimisht kërkojnë leje për tualet	4	4	10	11	35	38	26	28	16	17
13. Bëjnë pyetje edhe për tema shumë të lehta	9	10	23	25	31	33	18	19	11	12
14. Kërkojnë leje për të dalë nga ora mësimore	3	3	9	10	15	16	28	30	36	39
15. Bëjnë pyetje jashtë temës mësimore të ditës	4	4	16	17	17	18	25	27	28	30

* Në këtë përqindje nuk janë përfshirë mësuesit që nuk kanë janë përgjigjur. Për këtë disa % nuk janë 100%.

Në raste se nxënësit hyjnë pas mësuesit në klasë/orë mësimore kjo shkakton çrregullime dhe ndikon që mësuesit ta humbin durimin. Kështu shumica e mësuesve të anketuar kanë shprehur pajtimin e tyre, ose 64% nga 92 sa kanë dhënë përgjigje për këtë rast. Ndërsa pjesa tjetër, ose rreth 36% nuk janë pajtuar se kjo ndikon në humbjen e durimit të tyre nëse nxënësit hyjnë në orë pas fillimit të orës, pasi që ai të ketë hyrë në klasë. Edhe në rastet kur ndonjëri nga nxënësit nuk i kryen detyrat e shtëpisë shkakton humbjen e durimit të mësuesve. Kështu nga 91 sa kanë dhënë përgjigje në këtë 63 mësues, ose 69% janë pajtuar në shkallë të ndryshme se kjo ndikon në humbjen e durimit të tyre. Ndërsa 28 nga 91 sa janë përgjigjur në këtë janë shprehur se kjo nuk ndikon në humbjen e durimit, ose nuk pajtohen me një situatë të tillë se mund të ndikojë tek ata që të humbin durimin gjatë punës me nxënës. Por në situatën kur ndonjë nxënës vjen në klasë pa libër apo pa fletore, më shumë se gjysma nuk pajtohen se humbin durimin. Kështu nga 90 mësues sa kanë dhënë përgjigje në këtë 46 ose rreth 52% nuk janë pajtuar se kjo mund të ndikojë në ta që ta humbin durimin ndaj nxënësve. Por edhe përqindja e atyre që në një mënyrë humbin durimin në situatat të tilla është shumë i lartë, rreth 48%.

Në situatat kur nxënësit nuk janë të përqendruar në mësim dhe nuk kuptojnë mësimdhënien janë përgjigjur 89 nga 93 mësues, ndërsa shkalla e pajtueshmërisë me këtë është: 37 ose 41.6% shprehin shkallë pajtimi me këtë kundrejt 52 ose 58.4%, të cilët nuk pajtohen se kjo situatë ndikon për humbjen e durimit ndaj nxënësve. Sipas përgjigjeve të mësuesve shumicës, 60 nga 91 sa janë përgjigjur në këtë kërkesë, ose rreth 66%, nuk i pengon (nuk e humbin durimin) shumë zhurma dhe lëvizjet që bëjnë nxënësit në klasë derisa ai flet ose mbanë mësimin. Vetëm 31, ose rreth 34% pajtohen se lëvizja dhe zhurma e nxënësve i pengon gjatë kohës kur ai/ajo është duke folur. Edhe më interesantë duket përgjigja në atë kur nxënësit “Përdorin fjalë fyese ndaj njëri-tjetrit”. Kjo bënë që ta humbin durimin, në një formë pajtohen me këtë, vetëm 30 ose 34% nga 89 sa kanë dhënë përgjigje në këtë kërkesë. Ndërsa 59 prej tyre ose 66% nuk pajtohen se rastet e këtilla, fyerjet, mund të ndikojnë në humbjen e durimit të tyre. (Nuk na duket shumë normale kjo kur dëgjojmë nxënësit duke përdor fjalë fyese ndaj tjetrit dhe ne të mos reagojmë ndaj tyre). Por, nëse nxënësit nuk pajtohen me **vlerësimin (notën)**, atëherë kemi përqindje të lartë të mësuesve të humbin durimin. Kështu nga 92 sa kanë dhënë përgjigje në këtë **37 prej tyre ose rreth 40%** në një mënyrë pajtohen **se humbin durimin në këto** raste, derisa 55 prej tyre, ose 60% nuk pajtohen se humbin durimin në raste se nxënësit nuk pajtohen me vlerësimin apo notën e tij. Sjellja tjetër e nxënësve kur “nxënësi ngacmon nxënësin” kemi përqindje më të lartë të

mësuesve që humbin durimin. Nga 91 sa janë përgjigjur në këtë 59 prej tyre ose 65% janë pajtuar se humbin durimin dhe se kjo nuk ndikon te ta janë deklaruar 32 ose 35%. Hedhja e mbeturinave në klasë nga ana e nxënësve ka një ndikim bukur të lartë që mësuesit e tyre të humbin durimin. Kështu nga 91 përgjigje 40 prej tyre, ose 44% pajtohen se ky gjest ua humb durimin. Por 51 të tjerëve ose 56% nuk pajtohen se kjo ndikon në ta që ta humbin durimin. Edhe kur nxënësit përtypin çamçakëz ose ushqim gjatë orës së mësimit ndikon te mësuesit që ta humbin durimin. Prandaj, 40 nga 90 sa janë përgjigjur, ose 44% humbin durimin nëse ndonjëri nga nxënësit bënë këtë veprim në orë të mësimit. Ndërsa 50 nga 90 ose 56% nuk pajtohen se kjo mund ndikoj te ata që ta humbin durimin. Është interesant, ose nuk kanë dhënë përgjigje të sinqertë për situatën nr 11 që ka të bëjë me përdorimin e telefonit nga ana e nxënësve. Vetëm 17 nga 92 pajtohen se kjo ndikon që ata ta humbin durimin (rreth 18%) derisa 75 ose 82% e tyre kjo nuk ju bënë shumë përshtypje. Për mendimin tonë më shumë ndikon ky gjest se sa përtypja e çamçakëzitet. Gjithashtu kërkesat e nxënësve për të shkuar në tualet pajtohen se ndikon në humbjen e durimit. Nga 81 përgjigje 39 ose 48% janë pajtuar se kjo ndikon në durimin e tyre derisa tek 42 ose 52% kjo nuk ndikon.

Shumë interesant është përgjigja dhe pajtimi i 63 nga 92 (68%) mësime të mësimdhënësve se kur nxënësit “bëjnë pyetje edhe për tema të lehta” tek ata ndikon që ta humbin durimin. Ndërsa pjesa tjetër 29 nga 92 ose 32% deklarojnë se nuk pajtohen që kjo të ndikoj të humbin durimin. Por më pak ndikon kërkesa e nxënësve për të dal nga ora mësimore se sa kur bëjnë pyetje për tema të lehta. Në këtë kemi këto përgjigje, ku nga 90 sa janë përgjigjur 27 ose 30% pajtohen se kjo ndikon në humbjen e durimit derisa për 63 të tjerë ose 70% nuk pajtohen se kjo ndikon te ta. Gjithashtu te një përqindje e madhe e mësuesve bërja e pyetjeve jashtë temës mësimore nga ana e nxënësve ndikon në humbjen e durimit. Nga 90 përgjigje 37 pajtohen se kjo ndikon që ta humbin durimin, ose 41%. Ndërsa 63 ose 59% nuk pajtohen se kjo mund të ndikojë në humbjen e durimit ndaj nxënësve.

3.3.1. Qëndrimet e mësuesve lidhur me humbjen e durimit

Humbja e durimit të mësuesve në raport me reagimet/sjelljet e ndryshme të nxënësve është një tregues i mirë për të vlerësuar shkallën e përgatitjes psikologjike të mësime të mësimdhënësve për punë me nxënësit e kësaj moshe, sidomos adoleshentët.

Më sipër pamë se si janë reagimet e mësime të mësimdhënësve të mostrës. I ndamë ata në baza gjinore për të parë se a ka dallime domethënëse midis gjinive sa

i përket qëndrueshmërisë/stabilitetit të tyre në raport me sjelljet dhe reagimet e ndryshme të nxënësve.

Tabela 4.1. Qëndrimi i mësueseve ndaj sjelljeve të nxënësve

Të ka ndodhur që ta humbësh durimin ndaj nxënësve, në rastet si në tabelë KUR:	Raportem plotësisht		Pajtohem		Pajtohem pjesërisht		Nuk pajtohem	
		%		%		%		%
1. Ndonjë nxënës hynë pas meje në klasë/orë.	4	9		24	11	24	10	22
2. Ndonjë nxënës nuk i ka kryer detyrat e shtëpisë	3	7		27	15	33	8	18
3. Vjen pa libër a fletore në klasë/mësim.	1	2	8	18	11	25	18	41
4. Nuk janë të përqendruar dhe nuk kuptojnë përmbajtjen që iu ligjëroj.	2	4		9	10	23	18	41
5. Bëjnë lëvizje dhe zhurmë në klasë derisa unë flasë/shpjegoj.	2	4.5	2	4.5	7	16	15	34
6. Përdorin fjalë fyese/nënçmuese ndaj njëri-tjetrit.	2	4.5	2	4.5	10	23	14	32
7. Nuk pajtohen me vlerësimin (notën) tim	5	11	5	11	5	11	14	31
8. Njëri nxënës ka ngacmuar tjetrin	0	0	6	13	10	23	23	51
9. Hedhin mbeturina në klasë	1	2	7	16	10	22	16	36
10. Përtypin çamçakëz ose ushqime	0	0	4	9	10	23	17	40
11. Përdorin telefonin gjatë orës së mësimit	0	0	1	2	4	9	12	27
12. Vazhdimisht kërkojnë leje për tualet	1	2	4	9	16	36	15	33
13. Bëjnë pyetje edhe për tema shumë të lehta	4	9	8	18	17	38	8	18
14. Kërkojnë leje për të dalë nga ora mësimore	0	0	1	2	9	20	14	32
15. Bëjnë pyetje jashtë temës/njesisë mësimore të ditës	1	2	5	11	8	18	13	29
							18	40

Hyrja në klasë pas mësueses te 26 mësuese ndikon në humbjen e durimit në krahasimi me mostrën, 64 nga 93 janë deklaruar për këtë. Moskryerja e detyrave të shtëpisë, gjithashtu ndikon në humbjen e durimit të 63 nga 93 të mostrës derisa te femrat kjo është 30 nga 46 femra sa ishin në mostër. Sa i përket proporcionit gjinor kemi një balancim të reagimit ndaj nxënësve të cilët nuk i kryejnë detyrat e shtëpisë. Nga kjo edhe mund të rrjedh shprehja e zakonshme “*a ke harruar me hangër bukë*”, e cila nuk iu pëlqen shumë nxënësve, sidomos kur kjo iu thuhet në prezencë të tjerëve.

Është interesant përgjigja, pajtueshmëria/mospajtimi me lëvizjet dhe zhurmën që shkaktojnë nxënësit derisa mësuesja flet. Pra këtu kemi përgjigje pajtimi më të ulët se sa kur nxënësi harron detyrat e shtëpisë ose kur hynë pas mësueses në klasë. Por kjo nuk është befasuese sa reagimi në rastet kur nxënësit përdorin fjalë fyese/nënçmuese ndaj njëri tjetrit. Vetëm rreth ¼ e mësueseve kjo e pengon, apo ndikon në humbjen e durimit ndaj nxënësve. Tek 1/3 e mësueseve në humbjen e durimit ndaj nxënësve ndikon mospajtimi i nxënësve me vlerësimin apo me notën që ua vejnë. Derisa, për mendimin tonë, edhe më befasues është fakti se tek mësueset ndikon shumë në humbjen e durimit nëse bëjnë pyetje për tema shumë të lehta. Nëse krahasojmë përgjigjet nga mostra e përgjithshme dhe sipas gjinisë, këtu kemi afro 50% që në një shkallë pajtohen me pohimin e dhënë në pyetësor. As përgjigjet nga mostra e përgjithshme në këtë rast nuk janë shumë të favorshme sa i përket humbjes së durimit të mësuesve ndaj nxënësve nëse ata “*bëjnë pyetje edhe për temat shumë të lehta*”. Nëse me këtë rast me frazën “humbja e durimit” nënkuptojmë edhe një shkallë të humbjes së kontrollit, atëherë del se edhe përdorimi i fjalëve fyese/nënçmuese ndaj nxënësve është në shkallë brengosëse.

3.4. Reagimet e çastit ndaj nxënësve

Në jetën e përditshme njeriu zakonisht bënë reagime të çastit. Në kuadër të këtij reagimi mund të ketë edhe fyerje, fjalë të rënda apo edhe ndonjë reagim fizik. Por në 14 rastet e dhëna në pyetësor fare pak janë deklaruar se kësi raste dhe reagime të këtilla ju ndodhin sipas shpeshësisë së dhënë, çdo ditë, ndonjëherë apo kjo nuk më ndodhë. Të dhënat i kemi paraqitur në tabelë.



Sipas rezultateve të paraqitur në tabelë në alternativën e parë ka raste kur ndaj ndonjë sjelljeje të nxënësve ju thuhet *asgjë nuk po kuptoni...*, nga 92 sa kanë dhënë përgjigje 17 ose 18% deklarojnë se kjo iu ndodhë ndonjëherë, 31 ose 34% rrallë ju ndodhë dhe 44 ose 48% kjo nduk iu ndodhë. Në reagimin e mundshëm *“Je shumë i prapambetur në krahasim me*

shokët tu” 80 nga 98 ose 87% thonë se kjo nuk iu ndodhë. Pjesa tjetër janë shumë të shkapërderdhur. Një reagim i shpeshhtë, i cili nuk paraqet ndonjë ofendim për as kë, *“Pa sëpatë nuk shkohet në pyll”* nga 91 sa janë përgjigjur vetëm dy kanë thënë se këtë ua thonë çdo ditë nxënësve të tyre, 9 ose 10% ua thonë ndonjëherë ndërsa rrallë më ndodhë kanë deklaruar 19 ose 21% ndërsa 59 ose 64% kjo nuk iu ndodhë. Përqindja e përgjigjeve të tjera nuk është relevante.

Gjithashtu një reagim i shpeshhtë që bëhet ndaj nxënësve nga ana e mësuesve kur ata harrojnë detyrat ose mjetet e punë *“Mos ke harruar të hash bukë”* ka këtë shpërndarje në hulumtim: 16 nga 91 ose rreth 18% deklarojnë se kjo iu ndodhë ndonjëherë, 18 ose rreth 20% thonë se kjo rrallë iu ndodhë derisa 55 ose 60 deklarojnë se kjo nuk iu ndodhë.

Tabela 5. Reagimet e çastit ndaj nxënësve

Ju ka ndodhur që ndaj sjelljes jo të mirë të ndonjë nxënësi gjatë mësimdhënies të përdorni shprehjet, si më poshtë:	Çdo ditë		Ndonjëherë		Më ndodhë shpesh		Rrallë më ndodhë		Kjo nuk më ndodhë	
	x	%		%		%		%		%
1. Asgjë nuk po kupton për kundër shpjegimit/mundimit tim	x	0	17	18	x	0	31	34	44	48
2. Je shumë i prapambetur në krahasim me shokët tu.	1		4	4	2	2	5	5	80	87
3. Pa sëpatë nuk shkohet në pyll.	2	2	9	10	2	2	19	21	59	64
4. Mos ke harruar të hash bukë (kur harron detyrat, librin, lapsin.)	x	0	16	18	2	2	18	20	55	60
5. Je debil, si po sillesh ashtu	x	0	1	1	2	2	2	2	8	9
6. Idiot, nuk je në kinema/rrugë	x	0	1	1	1	1	1	1	89	97
7. Rrugaç, a e di ku gjendesh	x	0	1	1	1	1	3	3	87	95
8. O viç, a e di çfarë prindi ke	x	0	1	1	1	1	x	0	90	98
9. Gomar, nuk je në fushë po në klasë	x	0	1	1	1	1	1	1	89	97
10. Kryemadh, me ty po flas	x	0	2	2	1	1	4	4	85	92
11. Nuk je në dasmë/kanaxheç	x	0	4	4	1	1	17	18	70	76
12. Ti nuk je normal	x	0	x	0	2	2	3	3	87	95
13. Trupeshk	x	0	2	2	x	0	x	0	90	98
14. Hajde bukurosh/bukuroshe-hajde, mos ishe në pazar (kur vonohet)	X	0	2	2	1	1	11	12	78	85

Fyerjet ose përçmimet e dhëna në pyetësor, 5-14, sipas kërkesës për reagimet e çastit, dhe kemi marrë kësi përgjigjesh. Nga 93 mësimdhënës/e

sa janë përgjigjur në këtë 88% kanë thënë se nuk iu ndodhë që ndonjë nxënës ta quajnë “*Je debil*”. Gjithashtu 97% prej tyre deklarojnë se nuk iu ndodhë që në ndonjë reagim të çastit ti thotë ndonjë nxënësi idiot. Por 95% e tyre deklarojnë se nuk iu ndodhë as rrugaç t’iu thonë ndonjëherë nxënësve. Gjithashtu 97% thonë se gomar nuk ndodhë ta quajnë dikë as në rastet kur humbin durimin nga ndonjë sjellje e nxënësve. “*Nuk je në dasmë*” ndodhë që t’iu thonë nxënësve. Kështu nga 92 sa janë përgjigjur në këtë 4 prej tyre deklarojnë se këtë e përdorin nganjëherë dhe 17 ose 18% rrallë iu ndodhë që ta përdorin këtë shprehje të cilën nxënësit nuk e pëlqejnë. Ndërsa 70 ose 76% e mësimdhënësve të anketuar deklarojnë që kjo nuk iu ndodhë. Interesantë, vetëm 5 deklarojnë ndonjëherë iu ka ndodhë që nxënësve t’iu thotë “ti nuk je normal”, derisa 95% deklarojnë se këtë nuk e thonë. Kjo është shumë e jo e sinqertë sepse një gjë e tillë iu ndodhë gati çdo ditë.

Mendojmë se përgjigjet e dhëna në këtë janë pasqyra më e mirë e sinqeritetit të mësimdhënësve. Mohimi i një situatë, të çastit, në të cilën shumëkush mund të përdor fjalë e shprehje të këtilla është jo normale. Do të ishte shumë në rregull sikur gjendja vërtetë të ishte e tillë, ku një numër simbolik i mësimdhënësve deklarojnë se kjo iu ndodhë ndonjëherë. Ndoshta këtu fshihet pjesa më e sinqertë e përgjigjedhënësve. Se një gjë e tillë ekziston e vërtetojnë përgjigjet e nxënësve.

Në pyetjet në vijim pothuajse demantojnë vetveten dhe përgjigjet e dhëna paraprake.

3.4. 1. Reagimet e çastit e mësuesve ndaj nxënësve

Në krahasimi me mostrën e përgjithshme të femrat kemi një dallim në reagimin në nën 1, *Asgjë nuk po kupton...*, ku vetëm 6 ose rreth 14% ju ndodhë që Ndonjëherë t’iu drejtohen kështu nxënësve, derisa në mostër kjo ishte 14 ose rreth 18%, por Rrallë më ndodhë janë deklaruar 34% njëjtë sikurse në mostrën e përgjithshme.

Tabela 4.1.1. Qëndrimi i mësueseve lidhur me reagimet e çastit ndaj nxënësve

	Çdo ditë	%	Ndonjëherë	%	Më ndodh shpesh	%	Rralle më ndodhë	%	Kjo nuk më ndodhë	%
1. Asgjë nuk po kupton për kundër shpjegimit/mundimit tim	0	0	6	14	0	0	15	34	23	52
2. Je shumë i prapambetur në krahasim me shokët tu.	1	2	0	0	0	0	3	7	41	91
3. Pa sëpatë nuk shkohet në pyll.	1	2	2	4	0	0	10	22	32	71
4. Mos ke harruar të hash bukë (kur harron detyrat, librin, lapsin)	0	0	3	6	1	2	10	22	32	71
5. Je debil, si po sillesh ashtu	0	0	0	0	0	0	0	0	45	100
6. Idiot, nuk je në kinema/rrugë	0	0	0	0	0	0	0	0	45	100
7. Rrugaç, a e di ku gjendesh	0	0	0	0	0	0	0	0	45	100
8. O viç, a e di çfarë prindi ke	0	0	0	0	0	0	0	0	45	100
9. Gomar, nuk je në fushë po në klasë	0	0	0	0	0	0	0	0	45	100
10. Kryemadh, me ty po flas	0	0	0	0	0	0	2	4	43	96
11. Nuk je në dasmë/kanaxheç	0	0	0	0	1	2	7	16	37	82
12. Ti sje normal	0	0	0	0	0	0	0	0	45	100
13. Trupeshk	0	0	0	0	0	0	0	0	45	100
14. Hajde bukurosh/bukuroshe-hajde, mos ishe në pazar (kur vonohet)	0	0	0	0	0	0	5	11	40	89

Siç shihet në tabelë 4.1., kur është fjala për fjalët e rënda fyese ndaj nxënësve kemi përqindje shumë të ultë të atyre që deklarojnë se kjo iu

ndodhë. Edhe te mostra treguesit janë shumë të përafërt. Kjo tregon se nuk ka dallime domethënëse midis meshkujve dhe femrave mësimdhënës sa i përket shpeshësisë së përdorimit të shprehjeve fyese/nënçmuese ndaj nxënësve. Këtë e hedhin poshtë treguesit e rezultateve të fituara nga deklaratimet e nxënësve.

3.5. Qëndrimi i mësimdhënësve lidhur me reagimet e çastit ndaj nxënësve

Shkalla e besueshmërisë së deklaratave të mësimdhënësve lidhur me reagimet e rastit i kemi ndërlidhur me qëndrimet e tyre lidhur me ato deklarata. Nëpërmjet këtyre qëndrimeve në një mënyrë demantojnë deklaratimet e veta të dhëna në pyetjet paraprake. Në kërkesën se “*Kjo është normale, njerëz jemi, nervozohemi ndonjëherë*” nga 89 mësimdhënës sa janë përgjigjur në këtë, afro 60% prej tyre në formë pajtohen me këtë konstatim kundrejt 40% që nuk pajtohen. Po të krahasojmë tabelat 5 dhe 6 do të shohim dallime të mëdha midis tyre.

Nga 80 mësimdhënës 38% shprehin ankesën sikur ju të ishit në vendin tim, me të cilën sikur konfirmojnë se edhe këta nuk mund të veprojnë ndryshe në situata të tilla. Kjo përqindje e lartë në një mënyrë demanton pohimet e bëra në tabela 5 lidhur me përdorimin/mospërdorimin e fyerjeve ndaj nxënësve. Por në të njëjtën kohë mbi 60% sikur nuk ankohen “po të ishit në vendin tim” që donë të thotë se nuk ka raste të tilla në të cilat ata mund të kenë probleme me nxënësit.


Sa i përket pajtueshmërisë së mësuesve të anketuar me atë se “Atyre ju mungon edukata elementare familjare, vetëm rreth 27% shprehin një shkallë të pajtueshmërisë me këtë, derisa 68% nuk pajtohen me këtë pohim. Vetëm 17% e arsimtarëve/eve pajtohen në një formë se përdorimi i këtyre fjalëve ndaj nxënësve është bërë një formë e shprehisë së tyre, çka do të thotë se nganjëherë janë edhe krejt shprehje spontane, apo se është bërë një përditshmëri në përdorimin e tyre. Pjesa tjetër prej 83% nuk pajtohen me këtë se kjo është bërë shprehi e shumë mësimdhënësve. Me pohimin në pyetësor “*nuk di si ti quaj ndryshe*” shumica absolute nuk shpreh ndonjë formë/shkallë të pajtimit. Ndërsa me pohimin në pyetësor “*Nuk është mirë, por as e dëmshme nuk është për punën me nxënës*” shkallë pajtueshmërie shprehin vetëm rreth 10% e mësimdhënësve të anketuar. Mbi 97% e të anketuarve mbajnë qëndrim se nxënësit nuk i meritojnë shprehjet e këtilla. Prandaj sa i përket qëndrimeve të arsimtarëve ndaj fjalëve dhe shprehjeve të rënda e fyese që përdoren në shkollë ndaj nxënësve tregon sa ata janë të

vetëdijshëm se një dukuri e tillë nuk është e mirë. Se sa janë të sinqerta mendimet dhe qëndrimet e tyre ndaj kësaj dukurie, nëse analizohen përgjigjet pararendëse dhe ato në vazhdim lë vend për analizë më të thellë të tyre.

Tabela 6. Mendimet për reagimet e çastit

Cili është mendimi yt lidhur me reagimet e çastit/spontane ndaj nxënësve?	Pajtohem plotësisht		Pajtohem		Pajtohem pjesërisht		Nuk Pajtohem		Fara nuk	
		%		%		%		%		%
1. Kjo është normale sepse, njerëz jemi, nervozohemi ndonjëherë	6	7	31	35	16	18	20	22	16	18
2. Sikur të ishit në vendin tim do ta shihnit sa vështirë e kemi me ta (nxënës)	5	6	4	4	25	28	28	31	28	31
3. Atyre ju mungon edukata elementare familjare	2	2	1	1	24	27	28	32	32	36
4. Më duket se e kemi bërë shprehi të përdorim shprehje të këtilla.	1	1	5	6	9	10	29	33	45	50
5. Këto shprehje nuk janë fyese, nuk shoh ndonjë problem këtu.	0	0	2	2	12	14	31	35	43	49
6. Vërtetë, disa nxënës i meritojnë këto shprehje	0	0	4	5	8	9	22	25	54	61
7. Nuk di si ti quaj ndryshe	1	1	2	2	0	0	18	21	64	75
8. Nuk është mirë, por as e dëmshme nuk është për punën me nxënës	1	1	7	9	0	0	32	39	42	51
9. Nxënësit e këtillë nuk meritojnë shprehje më të mira	0	0	2	2	0	0	20	23	64	74

Grafiku 3. Qëndrimet e mësimehënësve për reagimet e çastit ndaj nxënësve



3.5. 1. Qëndrimi i mësueseve lidhur me reagimet e çastit ndaj nxënësve

Sikurse te mostra edhe këtu kemi analizuar qëndrimet e mësuesve për reagimet e çastit ndaj nxënësve në mënyrë që të shohim nëse ka dallime të rëndësishme midis tyre.

Në këtë përgjigje “Kjo është normale sepse, njerëz jemi, nervozohemi ndonjëherë” kemi në përputhje 50x50% sa i përket pajtueshmërisë sipas gjinisë së mësimeve. Kjo tregon se në pohimet në pyetjet pararendëse lidhur me reagimet e çastit të dy shtresat e mostrës nuk janë treguar të sinqertë në deklaratimet e tyre. Siç shihet në të dy tabelat, kemi një përqindje të lartë për përgjigjen se “Kjo nuk më ndodhë” krahasuar me qëndrimin “Fare nuk pajtohem” lidhur me fjalët dhe shprehjet fyese ndaj nxënësve. Ndërsa sa i përket qëndrimit të mësuesve lidhur me pohimin “Sikur të ishit në vendin tim do ta shihnit sa vështirë e kemi me ta (nxënës)”, kemi përafërsisht qëndrim të njëjtë midis gjinive. Këtë e kanë pohuar pak më shumë se 2% e mostrës në krahasim me femrat.

Është me interes interpretimi i pohimit 4 “Më duket se e kemi bërë shprehi të përdorim shprehje të këitilla” me të cilin në shprehin shkallë pajtimi rreth 17% e mostrës derisa te femrat janë pajtuar rreth 12%, ose nëse shohim proporcioni meshkuj-femra është 10x5 në favor të meshkujve. Për

mendimin tonë ky pohim dhe pajtueshmëri e mësimdhënësve, edhe pse përqindje jo e lartë, tregon realitetin e kësaj dukurie në shkollat tona. Edhe një detaj interesant lidhur me pohimin “Nuk është mirë, por as e dëmshme nuk është për punën me nxënës”, nga 8 sa janë pajtuar me këtë, 6 prej tyre janë femra. Përgjigjet ose pajtueshmëria me pohimet tjera nuk ka ndonjë dallim për ta veçuar., sa i përket dallimit meshkuj-femra.

Tabela 6.1. Mendimet mësueseve për reagimet e çastit

	Pajtohem plotësisht	%	Pajtohem	%	Pajtohem pjesërisht	%	Nuk Pajtohem	%	Nuk pajtohem fare	%
1. Kjo është normale sepse, njerëz jemi, nervozohemi ndonjëherë	2	4	15	33	10	22	9	20	9	20
2. Sikur të ishit në vendin tim do ta shihnit sa vështirë e kemi me ta (nxënës)	1	2	2	5	13	30	16	36	12	27
3. Atyre ju mungon edukata elementare familjare	1	2	1	2	14	32	15	34	13	30
4. Më duket se e kemi bërë shprehi të përdorim shprehje të këtilla.	0	0	1	2	4	9	17	40	21	49
5. Këto shprehje nuk janë fyese, nuk shoh ndonjë problem këtu.	0	0	2	5	3	7	15	36	22	52
6. Vërtetë, Disa nxënës i meritojnë këto shprehje	0	0	2	5	3	7	10	23	28	65
7. Nuk di si ti quaj ndryshe	0	0	1	2	0	0	7	16	35	81
8. Nuk është mirë, por as e dëmshme nuk është për punën me nxënës	0	0	3	7	3	7	11	28	23	58
9. Nxënësit e këtyllë nuk meritojnë shprehje më të mira	0	0	0	0	0	0	6	14	38	86

3.6. Mendimi i mësimdhënësve për ndikimin e fjalëve fyese në raportin me nxënës

Në kërkesën në pyetësor se “Përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve të këtilla ndaj disa nxënësve ndihmon krijimin e raporteve pozitive mësime-dhënës”, mësime-dhënësit kanë pasur mundësi që të përgjigjen në më shumë se një nga alternativat/pohimet e dhëna. Me konstatimin se përdorimi i fjalëve fyese vështirëson punën në klasë janë përgjigjur 53 ose 57% nga numri i përgjithshëm prej 93 arsime-dhënësve. Ndërsa vetëm 9 ose rreth 7% pohojnë se ka raste kur shprehjet e këtilla janë të domosdoshme.

Gjithashtu është interesant pohimi i 13 arsime-dhënësve rreth 14% e tyre pohojnë se më mirë është të fyhen nxënësit se sa të përdoret dhunë fizike ndaj tyre. Dhe e fundit 34 nga 93 ose 37% e tyre pohojnë se asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë vërejtje kur ata kanë përdorur kësi fjalësh e shprehjesh ndaj nxënësve.

Përgjigjet e tyre janë dhënë në tabelën në vijim.

Tabela 7. Vlerësimi për ndikimin në raportin me nxënës

Pohimet	Përgjigj.	%
a. Kjo vetëm e vështirëson punën mësimore në klasë	53	57
b. Ka raste kur shprehjet e këtilla ndaj nxënësve janë të domosdoshme	9	7
c. Më mirë të përdorim këso shprehjesh se sa dhunën fizike ndaj nxënësve	13	14
d. Asnjëherë nuk kam pasur vërejtje për përdorimin e këtyre fjalëve/shprehjeve	34	37

3.6.1. Mendimi i mësueseve lidhur me ndikimin e fyerjeve në raportin me nxënës

Sa i përket vlerësimin të mësueseve se a ndikon përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve fyese e të rënda në ruajtjen apo prishjen e raportit mësues-nxënës kemi një dallim me vlerësimet e Mostrës. Derisa 57% e mostrës vlerësojnë se përdorimi i këtyre fjalëve/shprehjeve “Kjo vetëm e vështirëson punën mësimore në klasë” te mësueset kjo është 63%. Ndërsa në pohimin në pyetësor “Ka raste kur shprehjet e këtilla ndaj nxënësve janë të domosdoshme”, kanë pohuar rreth 7% e mostrës, tek femrat e kemi rreth

9%, por “Më mirë të përdorim këso shprehjesh se sa dhunën fizike ndaj nxënësve” janë 14% me 11% të femrave.

Tabela 7.1. Mësueset për ndikimin e fjalëve fyese në raportin me nxënës

Pohimet	Përgjigj.	%
a. Kjo vetëm e vështirëson punën mësimore në klasë	29	63%
b. Ka raste kur shprehjet e këtilla ndaj nxënësve janë të domosdoshme	4	9%
c. Më mirë të përdorim këso shprehjesh se sa dhunën fizike ndaj nxënësve	5	11%
d. Asnjëherë nuk kam pasur vërejtje për përdorimin e këtyre fjalëve/shprehjeve	20	43%

Edhe sa i përket pohimit nën d) “Asnjëherë nuk kam pasur vërejtje për përdorimin e këtyre fjalëve/shprehjeve” kemi një dallim midis mostrës dhe gjinisë. Në mostër kemi 37% a atyre që kanë pohuar për këtë, ndërsa te femrat kemi pak më shumë, pra 43% e tyre ndër të tjera kanë pohuar se nuk është ankuar dikush për përdorimin e këtyre fjalëve ndaj nxënësve.

3.7. Mendimi i mësimit lidhur me qëndrimet e nxënësve në rast të fyerjes

Nga 93 të anketuar vetëm 82 prej tyre kanë dhënë mendimin e tyre për atë se nëse përdoren kësi fjalë ndaj nxënësve çfarë do të jetë qëndrimi apo raporti i tyre ndaj mësimit lidhur me nxënësve të tillë. Kështu shumica prej tyre, 64 ose 78% pohojnë se qëndrimi i nxënësve do të jetë shumë negativ nëse ndaj tyre përdoren fjalë e shprehje jo të këndshme dhe fyese. Se qëndrimi i nxënësve ndaj tyre do të jetë armiqësor dhe hakmarrës kanë pohuar 11 ose rreth 13% ndërsa 3 ose 4% thonë se jo ndikon fare në prishjen e raportit me ta dhe vetëm 4 ose afro 5% thonë se ata tani më janë mësuar me këto shprehje. Nga numri i përgjithshëm 11 arsimtarë/e ose rreth 12% nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

Është me rëndësi këtu të shihet se çfarë është qëndrimi i nxënësve në të njëjtën pyetje. Derisa nga mësimit lidhur me nxënësve kemi kërkuar që të japin mendimin e tyre për atë se a mund të ndikojë një dukuri e tillë në raportet

me nxënësit, nga nxënësit kemi kërkuar që të shprehin ndjeshmërinë apo gjendjen emocionale dhe reagimin e shokut/shoqes ndaj mësimit/ndaj mësuesit i cili/a ka përdorur ndonjë nga fjalët a shprehjet fyese nënçmuese ndaj tij.

Më poshtë do të paraqesim të dhënat për mostrën e mësimit/ndaj mësuesve, pastaj edhe të mësuesve si dhe të dhënat për mendimet e nxënësve lidhur me qëndrimet e tyre ndaj

mësuesve. Sa i përket përgjigjes nën e) Mendoj se..., nga mësimit/ndaj mësuesit kemi kërkuar që nëse duan mund të japin edhe ndonjë mendim shtesë për këtë. Kemi disa mendime të cilat do të paraqesim të veçuara. Për krahasim po japim tabelën nr. 8, për ta parë dallimin midis pohimeve të mësimit/ndaj mësuesve dhe të nxënësve.

Grafiku 4. Qëndrimet e mësimit/ndaj mësuesve




Tabela 8. Qëndrimet e mësimit/ndaj mësuesve

Pohimet e mësimeve	Nr.	%
a. Shumë negativ	64	78
b. Nuk ndikon fare	3	4
c. Armiqësor dhe hakmarrës	11	13
d. Ata janë mësuar me këto shprehje	4	5
e. Mendoj se.....	22	27


3.7.1. Mendimi i mësuesve lidhur me qëndrimet e nxënësve në rast të fyerjes

Për të pa nëse ka dallime midis mësimeve dhe mësimeve në qëndrimet e tyre sa i përket qëndrimit lidhur me ndikimin e fyerjeve në raportin me nxënës. Shih tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 8.1. Qëndrimet e mësuesve për raportin me nxënës në rast fyerje

Pohimet e mësuesve	Nr.	%
a. Shumë negativ	29	81%
b. Nuk ndikon fare	1	2.5%
c. Armiqësor dhe hakmarrës	5	14%
d. Ata janë mësuar me këto shprehje	1	2.5%
e. Mendoj se.....	12	26

Grafiku 4.1. Qëndrimet e mësimeve



Me kërkesën nën 8 në pyetësor kemi dashur të dimë se çka mendojnë mësuesit se çfarë do të ishte qëndrimi i nxënësve ndaj tyre kur ata përdorin fjalët/shprehjet jo të këndshme për ta. Në përgjigjet e mësuesve kemi ca dallime ndaj atyre të mostrës. Kështu, mësueset pohojnë se nëse përdorim fjalë/shprehje të tilla atëherë qëndrimi i nxënësve do të jetë “Shumë negativ” thonë 81% e mësuesve në krahasimi me 78% e mostrës, “Nuk ndikon fare” në prishjen e raportit me nxënës pohojnë 2.5% e mësuesve krahas rreth 4% e mostrës, se qëndrimi i nxënësve do të jetë “Armiqësor dhe hakmarrës” hakmarrës mendojnë rreth 14% e mësuesve në krahasimi me rreth 13% e mostrës. Vetëm rreth 2.5% e mësuesve pohojnë se “Ata janë mësuar me këto shprehje” krahas rreth 5% e mostrës të cilët kanë dhënë përgjigje në këtë kërkesë të pyetësorit.

3.7.2. Mendimet/plotësueset të dhëna me shkrim nga mësueset

Në kërkesën për shprehjen e mendimit të mësimdhënësve kemi ofruar edhe mundësinë nën e) që ata vet të japin ndonjë mendim lidhur me ndikimin e fjalëve/shprehjeve fyese ndaj nxënësve. Nga 93 sa kishte mostra vetëm 22 kanë dhënë mendim shtesë me shkrim lidhur me ndikimin e tyre në nxënësit. Nga këta 22 mësimdhënës 12 ose rreth 56% janë femra. Mendimet e tyre po i japim në tabelën në vazhdim. Është me rëndësi të ceket se shumica e mendimeve të dhëna pajtohen me atë se përdorimi i fjalëve të tilla nuk ndikon mirë në raportin e tyre me nxënësit. Vlen për t'i veçuar vetëm dy mendime të shprehura nga dy mësimdhënës, njëra se “*mendoj se do ta harrojnë shumë shpejt*” dhe i dyti “*Mendoj se ndikon por jo dhe aq për tu armiqësuar*”. Sidomos është brengosës mendimi i parë. Ndërsa i njëjti arsimtar i TIK nga qytet në pyetjen e 6 “Çka do ti thoshe arsimtarit tënd, i cili përdorte këso shprehjesh kur ti ishe nxënësi?”, përgjigjet “*Do ta shikoj me ironi*” dhe në pyetje 7 “*A mendoni se nxënësit në këto situata ndihen të fyer...*” përgjigjet “*nuk duhet të përdoren fare ato fjalë*”. Ka edhe rastet të tjera ku vërtetë në përgjigjet e mësimdhënësve hetohet një konfuzion apo ndoshta përpjekje për t'i ikur përgjigjes reale.

Në bazë të analizës së rezultateve ky nuk është mendim i izoluar, por të tjerë kanë hezituuar ta thonë. Ose mendimi nën dy (mësuese) “*.... do të më urrejnë*” është në pajtueshmëri me shumë mendime të nxënësve lidhur me këtë që thotë arsimtarja.

Mendimet e këtilla sikur demantojnë shumicën e mësimdhënësve të anketuar lidhur me shkallën e pajtimit/mospajtimit për humbjen e durimit gjatë situatave dhe sjelljeve të nxënësve të dhëna në pyetësor.

Edhe pse ekziston një përqindje e lartë e pajtimit se përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve fyese ndaj nxënësve ka ndikim negativ është e rëndësishme që shumica e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim mendojnë kështu. Mendojmë se kur të mësojnë se si janë mendimet e nxënësve lidhur me këtë atëherë kjo përqindje do të rritej edhe më shumë.

Tabela 8.1.1. Mendimet plotësuese me shkrime të mësimdhënësve Meshkuj-Femra

	Mendimet e shkruara lidhur me pyetjen 8. nën e) Mendoj se.....	F	M
1	Mendoj se nuk ndikon mirë	*	
2	Mendoj se nuk do të më duan fare, do të më urrejnë	*	
3	Nuk do të ketë efekt pozitiv.	*	
4	Nuk duhet përdor fjalë ofenduese sepse janë të dëmshme	*	
5	Mendoj nuk do ishte i mirë, dhe mua si arsimtare do me humbte vlera	*	
6	Mendoj se nuk duhet të përdoren.		*
7	Nuk ndihen mirë.	*	
8	Nuk janë te mirëseardhura	*	
9	Nxënësit kanë autoritetin e tyre prandaj ne si arsimtarë duhet ti edukojmë pozitivisht.		*
10	mendoj se do ta harrojnë shumë shpejt.		*
11	Mendoj se nuk do te vjen puna ti përdorë këto shprehje edhe nëse i përdorin nuk do te hakmerreshin te nxënësit	*	
12	Krijon një hendek më të madh nëse ekziston.		*
13	Mendoj se ndikon por jo dhe aq për tu armiqësuar		*
14	Duhet të sillemi sa më mirë me ta.	*	
15	mendoj se fjala e mire ngroh dhe gurin		*
16	Mendoj se qëndrimi i tyre do të ishte negativ dhe do të reflektohej në psikikën e tyre, si në aspektin edukativ dhe moral.		*
17	Mendoj se po.		*
18	Mendoj se ndikon keq.		*
19	Mendoj se do të ndihej keq.	*	
20	Nxënësi nuk do ta pëlqej atë lëndë mësimore.	*	
21	Nuk është mirë të fyesh, po unë nuk kam pas raste të tilla.	*	
22	Në shpirt kanë një fije rezerve ndaj arsimtarit		*
Gjithsej F+M		12	10


Treguesit më poshtë, i prezantuar këtu për qëllime krahasimi tregojnë ndjeshmërinë e lartë të nxënësve ndaj dukurisë së fyerjes nga ana e mësimitdhënësve.

Tabela 9. Qëndrimi i nxënësve ndaj mësimitdhënësve që fyejnë

Nëse ndonjë arsimitar përdor fjalë a shprehje fyese ndaj teje, çfarë është qëndrimi yt ndaj tij?	PO	%	JO	%	Pa përgjigje	%	Totali
a) Shumë negativ	179	48.77	169	46.05	19	5.177	367
b) Nuk reagoj fare	96	26.16	252	68.66	19	5.177	367
c) Armiqësor dhe hakmarrës	57	15.53	291	79.29	19	5.177	367
d) Tani jam mësuar me këto shprehje	88	23.98	260	70.84	19	5.177	367
e) Nuk mund ta merrni me mend se si ndihem, pëlças nga inati.	151	41.14	197	53.68	19	5.177	367

PO=numri i nxënësve të cilët kanë dhënë përgjigje në alternativën e dhënë, JO= numri i nxënësve të cilët nuk kanë dhënë përgjigje.

Grafiku 5. Qëndrimet e nxënësve ndaj mësimdhënësve që fyejnë/nënçmojnë



Nga 367 nxënës të përfshirë në hulumtimi vetëm 19 ose rreth 5% nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Në këtë pyetje nxënësit, sikurse edhe mësimdhënësit kanë pasur mundësi të përgjigjen 1-2 përgjigje/ pohime të dhëna. Në pyetjen nën a) *Nëse ndonjë arsimitar përdor fjalë a shprehje*

fyese ndaj teje, çfarë është qëndrimi yt ndaj tij?, shumë negativ kanë pohuar 179 nxënës ose rreth 48%. Por nuk reagojnë fare janë deklaruar 96 ose rreth 26% prej tyre sepse 88 ose rreth 24% pohojnë se tani më jemi mësuar me këto shprehje. Shih për këtë kanë pohuar vetëm 5% e mësimitdhënësve. Mendoj se është alarmante qëndrimi tejet armiqësor i nxënësve ndaj mësimitdhënësve të tillë, kur 57 ose 16% deklarojnë këtë. Mendojmë se nuk është një shifër e vogël kjo.

Ndërsa gjendjen e tyre emocionale, dhe psikologjike, e shprehin në pohimin nën e) ku 151 nxënës ose 41% e tyre pohojnë se nuk mund ta merrni me mend se si ndihen, se pëlçet nga inati.

Nëse krahasojmë pohimin e mësimitdhënësve në d) “*Ata janë mësuar me këto shprehje*” me pohimin e nxënësve “*Tani jam mësuar me këto shprehje*” shohim dallim të madh midis dy qëndrimeve. Derisa vetëm 5% e mësimitdhënësve e pohojnë këtë në raport me 24% e nxënësve e pohojnë këtë të vërtetë.

3.3.3. Qëndrimet e mësimitdhënësve të shkollave të qytetit

Për të hetuar dallimet midis qëndrimeve të mësimitdhënësve bëme analizën sipas shpërndarjes së mostrës qytet-fshat. Të shohim në vazhdim përgjigjet e mësimitdhënësve të qytetit. Nga gjithsej 93 mësimitdhënës të përfshirë në mostër 52 kanë qenë nga shkollat e qytetit.

Tabela 10. Mësimitdhënësit e shkollave të qytetit

Raporti me nxënësit ose klima në shkollë, sipas mësimdhënësve të shkollave të qytetit	Pajtohem plotësisht	%	Pajtohem	%	Pajtohem pjesërisht	%	Nuk pajtohem	%	Nuk pajtohem fare	%
1. Në shkollë mbretëron klimë e këndshme pune e mësimi	25	48	17	33	9	17	0	0	0	0*
2. Raportet MËSIMDHËNËS-NXËNËS janë të shkëlqyeshme.	23	44	13	25	13	25	1	2	0	0
3. Ka raste kur nxënësit nuk i kuptojnë hallet e arsimtarëve.	5	10	20	38	9	17	9	17	4	8
4. Ka raste kur mësimdhënësit nuk i kuptojnë hallet e nxënësve.	5	10	16	31	11	21	12	23	3	8
5. Shpesh më qesin prej takti dhe më humbë durimi me ta	0	0	3	6	10	19	19	37	17	33
6. Disa nxënës vetëm “dajaku” i qetëson	2	4	4	8	8	15	15	29	22	42
7. Ka raste kur përdori ndonjë fjalë të rëndë ndaj tyre	0	0	2	4	4	8	16	31	27	52
8. Njoh kolegë që shpesh përdorin fjalë fyese ndaj nxënësve.	1	2	7	13	7	13	13	25	21	40
9. Më ka ndodhur të kërkojë ndihmë nga drejtori etj., për të dalë nga situata e palakmueshme me nxënës	1	2	1	2	3	6	20	38	25	48
10. Më shko mendja ta ndërrojë këtë shkollë. Nuk ia dal dot me ta.	2	4	2	4	0	0	9	17	37	71
11. Kemi prindër që na ndihmojnë shumë në punën me nxënës	13	25	23	44	10	19	2	4	2	4
12. Kemi prindër që kurrë nuk interesohen për fëmijët e tyre	17	33	10	19	9	17	14	27	0	0

Nëse i krahasojmë mostrën e përgjithshme me mësimdhënësit e qytetit shohim se ka një dallim të vogël në shkallën e pajtueshmërisë me pohimet e dhëna në pyetësor. Kështu derisa në pohimin për klimën e këndshme në shkollë gjithë mostra plotësisht pajtohen rreth 57% në qytet kjo është 48%. Atje pajtohen afro 30% vetëm të qytetit rreth 33% dhe pjesërisht pajtohen 13% derisa këtu 25%.

* Nuk kemi përfshirë edhe ata që nuk janë përgjigjur në ndonjërinë kërkesë. Për këtë nuk kemi 100% përgjigjeve.

Edhe në kërkesën për pajtueshmërinë lidhur me raportin mësimdhënës-nxënës kemi dallime midis grupit dhe nëngrupit, mësimdhënësit e qytetit. Me pohimin se ekzistojnë raporte të shkëlqyeshme me nxënës, 46% e grupit pajtohen plotësisht, derisa nëngrupi plotësisht pajtohen 23 ose 44% që përbën rreth 25% të mostrës. Është me interes të analizohet pohimi 3 dhe 4 i kësaj pyetje e cila ka të bëjë me kuptueshmërinë/moskuptueshmërinë e halleve mësimdhënës nxënës dhe anasjelltas. Sipas tyre 10% pajtohen plotësisht se ka raste kur nxënësit nuk i kuptojnë hallet e mësimdhënësve, 38% pajtohen me këtë dhe 17% pjesërisht pajtohen. Por 10% pohojnë se edhe mësimdhënësit ka raste kur nuk i kuptojnë hallet e nxënësve, 31% pajtohen me këtë dhe 21% pajtohen pjesërisht. Kjo është e përafërt, me një përqindje jo të dallueshme, me pajtueshmërinë e mostrës, por dallon shumë nga pohimet e nxënësve lidhur me të njëjtën përgjigje. Shih për këtë te rezultatet e nxënësve.

Rreth 13 ose 27% e mësimdhënësve të qytetit pajtohen ose pjesërisht pajtohen se *“Shpesh më qesin prej takti dhe më humbë durimi me ta”* çka do të thotë se në këto raste edhe vjen deri të shfryrja ose edhe përdorimi i dhunës ndaj nxënësve, derisa për të njëjtën grupi është pajtuar rreth 16%. Nga kjo shihet se mësimdhënësit e shkollave të qytetit kanë shprehur ose sinqeritetin ose se kanë shumë telashe me nxënësit të cilët bëjnë që ata ta humbin durimin gjatë punës me ta. Në pohimin se *“Disa nxënës vetëm “dajaku” i qetëson”* nga gjithsej 21 mësimdhënës nga mostra sa janë pajtuar me këtë 14 ose 15% e mostrës janë mësimdhënës të shkollave të qytetit, ose rreth 27% e mësimdhënësve të qytetit shprehin pajtueshmëri me përdorimin e dajakut si mjet për t’i qetësuar nxënësit.

3.2.1. Shkalla e pajtimit të nxënësve me klimën në shkollë

Janë të njohura lidhjet ndërmjet raportit mësimdhënës – nxënës dhe ndikimit të tyre në afërsinë mësimdhënës –nxënës dhe anasjelltas, përkatësisht në krijimin e klimës në shkollë, në shprehjen e ndjenjës së kënaqësisë apo pakënaqësisë së nxënësve për mësimdhënësit dhe shkollën, për suksesin apo mosp suksesin e nxënësve në mësim, etj. Lidhur me këto aspekte janë bërë studime të ndryshme dhe janë nxjerrë shume konstatime të ndikimit të raportit mësimdhënës – nxënës në këto aspekte. Në me pyetësorin tonë të studimit nuk kemi synuar të hulumtojmë këto aspekte, por kemi synuar të konstatojmë qëndrimet e nxënësve për raportin mësimdhënës – nxënës, dhe pastaj të konstatojmë ndikimin e raporteve mësimdhënës – nxënës në shprehjen e dhunës verbale ndaj nxënësve.

Qëndrimet e nxënësve për raportin mësimdhënës – nxënës në shkollë, i kemi hulumtuar nëpërmjet disa konstatimeve të integruara në një tabelë me mundësi të përgjigjeve për shkallen e pajtimit/mospajtimit për secilin konstatim të dhënë për qëndrimet e nxënësve në raportin mësimdhënës – nxënës në shkollë. Konstatimet për raportin mësimdhënës-nxënës që i kemi hulumtuar dhe alternativat e shprehjes së qëndrimeve të nxënësve, pasqyrohen në tabelën në vijim.

Analiza dhe përpunimi i të dhënave për raportin mësimdhënës – nxënës, ofron të dhëna mjaft interesante për qëndrimet e nxënësve ndaj disa aspekteve të raportit mësimdhënës – nxënës dhe ndërlidhjen e tyre me dhunën verbale ndaj nxënësve. Përgjigjet e nxënësve në secilin konstatim të dhënë për raportin mësimdhënës-nxënës në shkollë, shprehin shkallë të ndryshme të pajtimit/mospajtimit me raportin mësimdhënës – nxënës në shkollë. Analiza dhe përpunimi i të dhënave për raportin mësimdhënës – nxënës, sjellë dy nivele të përgjigjeve (i) përgjigjet pozitive të nxënësve, ku ekziston një shkallë e lartë të pajtimit të nxënësve për disa konstatime lidhur me raportin mësimdhënës - nxënës, si dhe (ii) përgjigjet jo pozitive të nxënësve, me shkallë të lartë të pajtimit për disa konstatime lidhur me raportin mësimdhënës nxënës. Disa nga përgjigjet pozitive me shkallë të lartë të pajtueshmërisë së nxënësve tregojnë se: *Ekziston atmosferë e mirë për punë dhe për mësim në shkolla; Bashkëpunimi/raporti mësimdhënës – nxënës është në nivel të duhur; Në shkolla shpesh bisedohet për raportet mësimdhënës-nxënës.* Kurse, disa nga përgjigjet jo pozitive me shkallë të lartë të pajtueshmërisë së nxënësve tregojnë se: *Nxënësit nuk i pëlqejnë mësimdhënësit që përdorin fjalë fyese ndaj nxënësve; Nxënësit hidhërohen kur mësimdhënësit nuk i kuptojnë problemet e tyre; Nxënësit nervozohen shumë kur mësimdhënësit nuk i dëgjon arsyetimet e tyre;* etj. Tabela në

vijim sjellë përqindjet (%) e përgjigjeve të nxënësve për të gjitha aspektet e hulumtuara lidhur me raportin mësimdhënës – nxënës në shkollë.

Raporti mësimdhënës-nxënës në shkollë	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Fare nuk pajtohem	Pa përgjigje	Totali
1. Në shkollën tonë ekziston atmosferë e mirë për punë dhe për mësim	44.69	32.70	15.80	5.18	0.54	1.09	367
2. Bashkëpunimi/raporti mësimdhënës – nxënës është i shkëlqyeshëm	32.97	33.79	22.07	8.17	1.91	1.09	367
3. Nganjëherë mësimdhënësit nuk i kuptojnë problemet e mia	27.79	37.87	16.89	12.81	3.00	1.63	367
4. Ka raste kur unë nuk i kuptoj hallet/problemet e mësimdhënësve	22.89	38.42	15.53	13.35	6.81	3.00	367
5. Hidhërohem kur mësimdhënësi nuk e kupton problemin tim	31.06	25.07	13.90	17.98	9.81	2.18	367
6. Nervozohem shumë kur mësimdhënësi nuk i dëgjon arsyetimet e mia	38.15	23.16	10.63	15.80	8.45	3.81	367
7. Më ka ndodhur të qajë kur mësimdhënësi ka përdor fjalë të rënda ndaj meje	22.89	12.26	6.54	26.43	28.61	3.27	367
8. Nuk më pëlqejnë mësimdhënësit që përdorin fjalë fyese ndaj nxënësve	60.22	12.26	4.63	9.26	11.17	2.45	367
9. Për mësimdhënësit që fyejnë, ankoem te prindërit e mi	31.88	21.53	8.45	19.35	14.99	3.81	367
10. Nga inati iki në shtëpi ose kam dal nga mësimi	10.08	3.27	7.08	32.43	42.78	4.36	367
11. I shtrëngoj dhëmbët, fjalën e rëndë ose fyerjen ia them pas shpine	14.71	11.72	11.72	25.07	31.61	5.18	367
12. Në shkollë shpesh bisedojmë për raportet mësimdhënës-nxënës	38.69	30.52	13.62	7.08	6.27	3.81	367


Tabela nr. 11: Përgjigjet e nxënësve në përqindje (%) sipas shkallës së pajtimit për aspektet e hulumtuara për raportin mësimdhënës – nxënës në shkollë.

Siç shihet nga rezultatet e dhëna në tabelë, ka dallime të dukshme në mes të përgjigjeve për secilin prej konstatimeve që pasqyrojnë raportin mësimdhënës nxënës në shkollë. Disa prej tyre do të përshkruajmë, interpretojmë dhe do të pasqyrojmë me paraqitje grafike.

Rezultatet e hulumtimit për qëndrimet e nxënësve për alternativën “*Në shkollën tonë ekziston atmosferë e mirë për punë dhe për mësim*”, tregojnë se rreth 77% e nxënësve pajtohen plotësisht, dhe pajtohen se ekziston një atmosferë e mirë për punë dhe mësim në shkolla, ndërsa rreth 16% pjesërisht pajtohen me këtë qëndrim, kurse rreth 6% nuk pajtohen, përkatësisht fare nuk pajtohen me këtë qëndrim. Për këtë konstatim nuk kanë dhënë përgjigje rreth 1% e nxënësve të përfshirë në hulumtim.

Atmosfera e mirë për punë dhe për mësim, vjen si rezultat edhe i bashkëpunimit/raportit mësimdhënës – nxënës, aspekt ky të cilin e kemi hulumtuar në këtë studim. Rezultatet e qëndrimeve të nxënësve të shprehura për alternativën “*Bashkëpunimi/raporti mësimdhënës – nxënës është i shkëlqyeshëm*” tregojnë se rreth 67% e nxënësve (i) pajtohen plotësisht dhe (ii) pajtohen se bashkëpunimi mësimdhënës–nxënës është i shkëlqyeshëm, rreth 22% pjesërisht pajtohen me këtë qëndrim, kurse mbi 10% (i) nuk pajtohen dhe (ii) fare nuk pajtohen me këtë qëndrim. Nuk kanë dhënë përgjigje rreth 1 % e nxënësve të përfshirë në hulumtim.

Në raport me qëndrimet e nxënësve për atmosferën që ekziston për punë dhe mësim, si dhe nivelin e bashkëpunimit mësimdhënës – nxënës, dallimet më të mëdha, ekzistojnë të shkalla më e lartë e pajtueshmërisë, dallime ka edhe në shkallët tjera të pajtueshmërisë apo pajtueshmërisë. Grafiku në vijim paraqet këto dallime.




Grafiku nr.1: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për qëndrimet e tyre lidhur me atmosferën për punë dhe mësim dhe raportin mësimsdhënës - nxënës

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i hulumtuar për raportin mësimsdhënës – nxënës, është të kuptuarit e problemeve të nxënësve nga mësimsdhënësit dhe anasjelltas, të kuptuarit e problemeve të mësimsdhënësve nga nxënësit. Rezultatet e hulumtimit për qëndrimet e nxënësve për këto dy aspekte të raportit mësimsdhënës – nxënës, nuk janë në përputhje me qëndrimet e nxënësve për atmosferën e punës në shkollë dhe bashkëpunimin mësimsdhënës – nxënës, sepse qëndrimet e nxënësve të shprehura në përgjigjet e tyre tregojnë se megjithatë nganjëherë mësimsdhënësit nuk i kuptojnë problemet e nxënësve, gjithashtu ka edhe raste kur edhe nxënësit nuk i kuptojnë problemet e mësimsdhënësve.

Rezultatet e qëndrimeve të nxënësve të shprehura për alternativën “Nganjëherë mësimsdhënësit nuk i kuptojnë problemet e mia” tregojnë se mbi 65% e nxënësve pajtohen plotësisht dhe pajtohen se nganjëherë mësimsdhënësit nuk i kuptojnë problemet e tyre, rreth 17% pjesërisht pajtohen me këtë qëndrim, kurse mbi 16% nuk pajtohen, përkatësisht fare nuk pajtohen me këtë qëndrim, që nënkupton se përqindja e fundit e nxënësve shprehin qëndrim pozitiv sa i përket të kuptuarit e problemeve të nxënësve nga mësimsdhënësit. Nuk kanë shprehur qëndrim, përkatësisht nuk kanë dhënë përgjigje 1.63% e nxënësve të përfshirë në studim.

Rezultate të përafërta kemi edhe në raport me të kuptuarit e problemeve të mësimsdhënësve nga nxënësit. Dallimet qëndrojnë për shkallët *nuk pajtohem*, përkatësisht *fare nuk pajtohem*, sepse mbi 20% e nxënësve

shprehin këto qëndrime, që nënkupton se kjo përqindje e nxënësve arrijnë të kuptojnë hallet apo problemet e mësimdhënësve dhe pastaj të sillen sipas natyrës së problemit me qëllim të ruajtjes së raporteve me mësimdhënës. Kurse dallimi i dytë qëndron në mos dhënien e përgjigjeve, ku në këtë alternativë nuk janë përgjigjur 3% e nxënësve të përfshirë në studim. Grafiku në vijim paraqet të gjitha dallimet që ekzistojnë në përgjigjet e nxënësve sa i përket të kuptuarit të problemeve të tyre nga mësimdhënësit dhe të kuptuarit e problemeve të mësimdhënësve nga vetë nxënësit.




Grafiku nr.2: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për qëndrimet e tyre lidhur me të kuptuarit e problemeve të nxënësve nga mësimdhënësit dhe anasjelltas

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i hulumtuar për raportin mësimdhënës – nxënës, është mënyra e reagimit të nxënësve kur nuk kuptohen problemet e tyre dhe kur nuk dëgjojnë arsyetimet e tyre. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shpeshherë raportet mësimdhënës – nxënës nuk janë në nivelin e duhur pikërisht për shkak të mos adresimit të drejtë të këtyre dy aspekteve nga mësimdhënësit. Rezultatet tregojnë se shumica e nxënësve, mbi 55% e nxënësve të përfshirë në hulumtim, hidhërohen kur mësimdhënësit nuk i kuptojnë problemet e tyre, kurse mbi 61% e nxënësve të përfshirë në hulumtim, nervozohen shumë kur mësimdhënësit nuk i dëgjojnë arsyetimet e tyre për probleme të caktuara.

Gjithashtu një përqindje e caktuar e nxënësve nuk pajtohen ose fare nuk pajtohen me konstatimin se hidhërohen kur mësimdhënësit nuk i kuptojnë

problemet e tyre (rreth 28% e nxënësve) dhe nuk nervozohen shumë kur mësimitdhënësit nuk i dëgjojnë arsyetimet e tyre për probleme të caktuara (rreth 24% e nxënësve).

Grafiku në vijim paraqet të gjitha dallimet që ekzistojnë në përgjigjet e nxënësve sa i përket shkallës së pajtueshmërisë lidhur me reagimet e nxënësve kur mësimitdhënësit nuk i kuptojnë problemet e tyre dhe kur nuk i dëgjojnë arsyetimet e tyre për probleme të caktuara.




Grafiku nr.3: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për qëndrimet e tyre lidhur me të reagimet e tyre kur nuk kuptohen problemet dhe nuk dëgjojnë gjatë arsyeimeve për probleme të ndryshme

Lidhur me raportin mësimitdhënësi – nxënës, janë nxjerrë tregues edhe përmes përgjigjeve të nxënësve për shkallën e pajtimit/mospajtimit me mënyrën e reagimeve ndaj mësimitdhënësit që përdorin fjalë fyese për nxënës. Mbi 35% e nxënësve pajtohen plotësisht ose pajtohen se: *Më ka ndodhur të qajë kur mësimitdhënësi ka përdorur fjalë të rënda ndaj meje.* Mbi 53% e nxënësve pajtohen plotësisht ose pajtohen se: *Për mësimitdhënësit që fyejnë, ankoem tek prindërit e mi.* Mbi 13% e nxënësve pajtohen plotësisht ose pajtohen se: *Nga inati iki në shtëpi ose kam dalë nga mësimi.* Kurse mbi 26% e nxënësve pajtohen plotësisht ose pajtohen se *i shtrëngoje dhëmbët, dhe se fjalën e rëndë ose fyerjen ia them*

pas shpine. Përqindjet tjera për të tri reagimet e nxënësve janë shprehur me pajtim të pjesshëm ose me mospajtim.

Pavarësisht ndarjes së përqindjeve për shkallën e pajtimit/mospajtimit lidhur me reagimet e cituara, treguesit janë të mjaftueshëm të përfundojmë se reagimet e nxënësve janë një tregues i raporteve mësimdhënës – nxënës në shkollë, të cilat në të shumtën e rasteve janë të brishta pikërisht si pasojë e përdorimit të fyerjeve të ndryshme nga mësimdhënësit ndaj nxënësve.

Komunikimi konsiderohet si një nga mjetet më të rëndësishme për vendosjen e raporteve pozitive mësimdhënës – nxënës në shkollë. Me pyetësorin tonë të studimit kemi hulumtuar shkallën e pajtimit, mospajtimit të nxënësve për shpeshësinë e komunikimit në shkollë për raportet mësimdhënës-nxënës. Rezultatet janë inkurajuese, për faktin se mbi 69% e nxënësve pajtohen plotësisht dhe pajtohen se në shkollë shpesh bisedojnë për raportet mësimdhënës – nxënës, mbi 13% pjesërisht pajtohen me këtë, kurse mbi 13% nuk pajtohen apo fare nuk pajtohen. Grafiku në vijim paraqet të gjitha dallimet që ekzistojnë në përgjigjet e nxënësve sa i përket komunikimit në shkollë për raportet mësimdhënës – nxënës.



Grafiku nr.4: Paraqitja grafike e dallimeve në përgjigjeve të nxënësve për shkallën e pajtimit/mospajtimit për konstatimin se shpesh në shkollë bisedohet për raportet mësimdhënës-nxënës

Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit për raportin mësimitdhënës – nxënës, mund të përfundojmë se institucionet shkollore duhet ti kushtojnë kujdes të veçantë disa aspekteve të raportit mësimitdhënës – nxënës, si:

- ⇒ të ruajnë dhe kultivojnë vlerat e bashkëpunimit me nxënës,
- ⇒ të komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme me nxënës për t'i kuptuar hallet dhe shqetësimet e tyre,
- ⇒ të krijojnë klimë pozitive në raportet nxënës-mësimitdhënës,
- ⇒ të dëgjojnë në mënyrë aktive nxënësit kur i shprehin problemet dhe mendimet e tyre,
- ⇒ të ndalojnë çdo formë të dhunës verbale ndaj nxënësve, të drejtpërdrejt ose të tërthortë,
- ⇒ vazhdimisht të konsultohen me prindërit, kolegët dhe ekspertët e fushës për çështjet që preokupojnë ose që e pengojnë zhvillimin normal të komunikimit dhe të bashkëpunimit me nxënës.

3.4. Shpeshtësia e përdorimit të fjalëve fyese ndaj nxënësve

Shumica e studimeve vijnë në përfundim se ka mësimdhënës që përdorin në praktikën e mësimdhënies fjalë e shprehje fyese/nënçmuese ndaj nxënësve. Në me pyetësonin tonë të studimit përdorimin e fjalëve e shprehjeve fyese ndaj nxënësve e kemi hulumtuar përmes shpeshtësisë së përdorimit të tyre ndaj nxënësve.

Qëndrimet e nxënësve për shpeshtësinë e përdorimit të fjalëve e shprehjeve fyese ndaj tyre nga ana e mësimdhënësve i kemi hulumtuar nëpërmjet disa **konstatimeve** të integruara në një tabelë me mundësi të përgjigjeve për shkallen e shpeshtësisë për secilin konstatim të dhënë në tabelë. Tabela në vijim i pasqyron disa nga fjalët e shprehjet që mësimdhënësit iu drejtohen nxënësve në situata të caktuara, shprehje këto të cilat ne i kemi hulumtuar përmes alternativave për përgjigje lidhur me shpeshtësinë e përdorimit të tyre nga mësimdhënësit.

Analiza dhe përpunimi i të dhënave për *fjalët dhe shprehjet që mësimdhënësit iu kanë drejtuar nxënësve*, vërteton faktin se ka një numër të caktuar të mësimdhënësve që përdorin fjalë e shprehje të ndryshme kur iu drejtohen nxënësve në situata të caktuara. Të dhënat tregojnë se në masë të caktuar ekziston dhuna verbale ndaj nxënësve në shkollë. Gjithashtu të dhënat ofrojnë një pasqyrë të qartë për shpeshtësinë e përdorimit të këtyre shprehjeve nga ana e mësimdhënësve.

Analiza dhe përpunimi i të dhënave për *fjalët dhe shprehjet që mësimdhënësit iu kanë drejtuar nxënësve*, sjellë dy konstatime.

Konstatimi i parë, bazuar në një përqindje relativisht të lartë të përgjigjeve të nxënësve, të gjitha shprehjet e dhëna në tabelën e hulumtimit, janë shprehje që mësimdhënësit ua drejtojnë nxënësve në shkollë.

Konstatimi i dytë, rreth 13% e nxënësve që janë përgjigjur se i kanë dëgjuar këto shprehje, që do të thotë se as nuk mund të pohojnë se janë shprehje që përdoren nga mësimdhënësit ndaj nxënësve, apo që asnjëherë nuk përdoren.

Tabela në vijim sjellë përqindjet (%) e përgjigjeve për të gjitha aspektet e hulumtuara lidhur me *Shprehjet që mësimdhënësit iu kanë drejtuar nxënësve*:


Shprehjet që mësimdhënësit i kanë drejtuar nxënësve	Çdo ditë	Shpesh	Ndonjëherë	Asnjëherë	I kam dëgjuar	Pa përgjigje
1. A e di se ku je, në klasë apo në rrugë?	28.14	21.58	25.14	11.75	12.57	0.82
2. Ti nuk je normal, ti se ke vendin në shkollë	9.84	13.39	16.12	43.17	15.57	1.91
3. A e dini pse vini në shkollë?	34.15	31.97	15.30	10.38	6.28	1.91
4. Ti nuk je për shkollë.	10.66	13.39	22.13	39.89	11.75	2.19
5. Shkolla nuk është për majmunë.	16.44	13.42	15.62	42.74	10.14	1.64
6. Mjerë familja që të ka.	9.02	13.93	14.75	45.36	13.66	3.28
7. Ti se meriton notën më të madhe.	19.13	28.42	27.32	16.67	7.92	0.55
8. Nuk jeni në mulli po në klasë	15.57	14.21	22.13	32.51	13.66	1.91
9. A ke hëngër bukë sot, fol me zë më të lartë	19.67	21.04	21.86	23.77	10.38	3.28
10. Pa sëpatë nuk shkohet në pyll.	9.84	11.75	17.76	46.17	11.48	3.01
11. Prindërit të kanë mësuar të sillesh kështu	16.39	17.21	15.85	34.97	13.11	2.46
12. Jeni bërë si nuse	8.20	10.66	16.12	50.27	13.11	1.64
13. Sakatë, kurrgjë nuk po kuptoni	9.84	12.30	16.39	49.73	7.92	3.83
14. (Kur kërkoni leje për të dalë) Kush po të pret jashtë?	10.11	15.85	20.22	39.34	12.30	2.19
15. Nuk je në dasmë/kanaxheç	9.84	17.21	20.77	39.34	11.48	1.37
Totali	15.12	17.09	19.17	35.07	11.42	2.13

Tabela nr. 12: Përgjigjet e nxënësve në përqindje (%) sipas shkallës së shpeshësisë për aspektet e hulumtuara për shprehjet që mësimdhënësit i kanë drejtuar nxënësve.

Siç shihet nga rezultatet e dhëna në tabelë, ka dallime të dukshme në mes të përgjigjeve për secilën prej shprehjeve të cilat, sipas nxënësve, mësimdhënësit i kanë drejtuar nxënësve, dallimet vërehen edhe në shpeshësinë e përdorimit të shprehjeve.

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë, shohim se një përqindje relativisht e lartë e nxënësve kanë veçuar disa nga shprehjet që përdoren çdo ditë dhe shpesh prej disa mësimdhënësve, sidomos shprehjet: *A e di se ku je, në*

klasë apo në rrugë? A e dini pse vini në shkollë? Ti se meriton notën më të madhe. A ke hëngër bukë sot, fol me zë më të lartë. Në shikimi të parë këto nuk duket se shprehin ndonjë fyerje apo nënçmim të nxënësve, por në aspektin psikologjik, të thëna në prezencën e të tjerëve këto shprehje ndikojnë keq te nxënësit. Grafiku në vijim i paraqet përgjigjet e nxënësve sa i përket shpeshësisë së përdorimit të këtyre shprehjeve nga mësimdhënësit:



Grafiku nr.6: Paraqitja grafike e dallimeve në përgjigjeve të nxënësve për shpeshësinë e përdorimit më të madh të disa shprehjeve përmes të cilave mësimdhënësit i drejtohen nxënësve.


Kurse shprehjet të cilat sipas nxënësve nuk përdoren asnjëherë nga mësimdhënësit janë: *Jeni bërë si nuse. Pa sëpatë nuk shkohet në pyll. Sakatë, kurrgjë nuk po kuptoni. Mjerë familja që të ka. Ti nuk je normal, ti se ke vendin në shkollë,* etj. Kjo e fundit është shprehja që ka përqindjen më të lartë të cilën nxënësit vetëm e kanë dëgjuar (që nënkupton se as nuk mund të pohojnë se janë shprehje që përdoren nga mësimdhënësit ndaj nxënësve, apo që asnjëherë nuk përdoren).

Tabela në vijim i paraqet e nxënësve në përqindje për këto tri shprehje:

Nr.	Shprehjet që mësimitdhënësit i kanë drejtuar nxënësve	Çdo ditë	Shpesh	Ndonjëherë	Asnjëherë	I kam dëgjuar	Pa përgjigje
1	Jeni bërë si nuse	8.2	10.66	16.12	50.27	13.11	1.64
2	Sakatë, kurrëgjë nuk po kuptoni	9.84	12.3	16.39	49.73	7.92	3.83
3	Pa sëpatë nuk shkohet në pyll.	9.84	11.75	17.76	46.17	11.48	3.01
4	Mjerë familja që të ka.	9.02	13.93	14.75	45.36	13.66	3.28
5	Ti nuk je normal, ti se ke vendin në shkollë	9.84	13.39	16.12	43.17	15.57	1.91

Tabela nr. 13: Përgjigjet e nxënësve në përqindje (%) për shprehjet që nxënësit i kanë konsideruar se më pak përdoren nga ana e mësimitdhënësve kur iu drejtohen atyre.

Siç shihet nga rezultatet e prezantuara më lartë, të gjitha shprehjet e hulumtuara mësimitdhënësit, në situata të caktuara, ua drejtojnë nxënësve në shkollës, pavarësisht se shumica prej tyre paraqesin një formë të dhunës verbale ndaj nxënësve. Shqetëson fakti se disa prej këtyre shprehjeve përdoren çdo ditë nga një numër jo i vogël i mësimitdhënësve. Grafiku në vijim pasqyron përmbledhjen e shpeshtësisë së përdorimit të fjalëve fyese ndaj nxënësve për të gjitha fjalët e shprehjet e hulumtuara në këtë pjesë të diskutimit, me të cilat disa mësimitdhënës iu drejtohen nxënësve në shkollë.



Grafiku nr.7: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për shpeshtësinë e përdorimit të shprehjeve fyese përmes të cilave mësimdhënësit iu drejtohen nxënësve.

Nga grafiku shihet përqindje relativisht e lartë (15.12%) e nxënësve që kanë deklaruar se mësimdhënësit *çdo ditë* përdorin shprehje fyese në situata të caktuara kur iu drejtohen nxënësve. Gjithashtu edhe përqindja e nxënësve që kanë deklaruar se mësimdhënësit *shpesh* përdorin shprehje fyese në situata të caktuara kur iu drejtohen nxënësve është relativisht e lartë (17.09%), kurse 19.17% janë deklaruar *ndonjëherë*. Por nëse analizojmë të gjitha përgjigjet për përdorimi të këtyre fjalëve e shprehjeve ndaj nxënësve, atëherë vërtetë na del përqindje brengosëse. Mbetët përqindja më e madhe (35.07%) e nxënësve që kanë deklaruar se *asnjëherë* mësimdhënësit nuk përdorin shprehje fyese në situata të caktuara kur iu drejtohen nxënësve, por deklarimet për tri alternativat paraprake ofrojnë argumente të mjaftueshme për të arritur në përfundim se mësimdhënësit përdorin fjalë e shprehje fyese në situata të caktuara kur iu drejtohen nxënësve. Sigurisht që kjo nuk mund të përgjithësohet për të gjithë mësimdhënësit. Por, nëse kësaj i shtohet përqindja e atyre që kanë deklaruar çdo ditë 15%, shpesh 17% dhe ndonjëherë 19%, atëherë na del se megjithatë shpeshtësia e përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve fyese ndaj tyre është shumë e lartë, ose afro 51%. Por janë edhe 11% që kanë deklaruar se i kanë dëgjuar këto fjalë e shprehje nga mësimdhënësit e tyre.

3.4.1. Shpeshtësia e përdorimit të disa fjalëve e shprehjeve fyese dhe ofenduese që klasifikohen si më të rënda në dhunën verbale ndaj nxënësve

Në studim kemi synuar të konstatojmë edhe shpeshtësinë e përdorimit të disa fjalëve e shprehjeve fyese dhe ofenduese që klasifikohen si më të rënda në dhunën verbale ndaj nxënësve dhe që në raste të caktuara praktikohen nga disa mësimitdhënës. Lista e shprehjeve fyese më të rënda është përgatitur në bazë të një komunikimi elektronik me drejtorë të shkollave, mësimitdhënës dhe prindër për shprehjet fyese më të rënda që i kanë dëgjuar në shkollë respektivisht prej nxënësve se i përdorin mësimitdhënësit në situata të caktuara kur iu drejtohen nxënësve. Ato fjalë e shprehje të rënda (14 sish) që janë cituar nga shumica dërmuese e personave me të cilët kemi komunikuar janë vendosur në instrumentin e hulumtimit me nxënës. Analiza dhe përpunimi i të dhënave për fjalët e shprehjet fyese më të rënda na ka bërë të shqetësohemi në masë të madhe, sepse një përqindje relativisht e madhe e nxënësve kanë shprehur mendimin e tyre se shpesh na ndodhë që ndonjë mësimitdhënës të përdorë edhe kësi lloj shprehjesh dhe fjalë të rënda. Tabela në vijim i pasqyron deklaratimet e nxënësve sipas përqindjes (%) për të gjitha shprehjet dhe fjalët e rënda që janë hulumtuar për shpeshtësinë e përdorimit.

Shpeshtësia e përdorimit nga ndonjë mësimitdhënës e shprehjeve dhe fjalëve të rënda ndaj nxënësve	Shpesh na ndodhë	Nuk na ndodh shpesh	Pa përgjigje
1. Asgjë nuk po kupton për kundër shpjegimit/mundimit tim	18.03	77.05	4.92
2. Je shumë i prapambetur në krahasim me shokët tu.	17.49	77.05	5.46
3. Po përtyפש si kafshë, hidhe çamçakëzin	18.31	77.32	4.37
4. Mos ke harruar të hash bukë (kur harron detyrat, librin, lapsin...)	16.67	80.05	3.28
5. Je debil, si po sillesh ashtu	16.12	77.60	6.28
6. Idiot, nuk je në kinema/rrugë	15.30	79.51	5.19
7. Rrugaç, a e di ku gjendesh	12.84	81.97	5.19
8. O viç, a e di çfarë prindi ke	9.56	84.43	6.01
9. Gomar, nuk je në fushë, po në klasë	16.12	78.14	5.74
10. Kryemadh, me ty po flas	12.57	81.69	5.74
11. Jeni bërë si pula	14.21	78.42	7.38
12. Ti s'je normal	13.93	82.24	3.83
13. Trupeshk	11.48	79.51	9.02
14. Hajde bukurosh/bukuroshe- hajde, mos ishe në pazar	13.11	81.15	5.74
Totali	14.70	79.72	5.58

Tabela nr. 14: Lista me shprehje dhe fjalë të rënda dhe deklaratimet e nxënësve

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë, shihet një përqindje relativisht e lartë, mesatarisht 14.70% e nxënësve kanë deklaruar se shpesh na ndodhë që ndonjë mësimdhënës të përdorë shprehje dhe fjalë të rënda kur iu drejtohen atyre në situata të ndryshme. Përkundrajt faktit se shumica e nxënësve (rreth 80%) kanë deklaruar se nuk na ka ndodhë shpesh të përdoren shprehje të tilla, përsëri rezultatet na kanë bërë të shqetësohemi jashtë mase, për faktin se secila prej këtyre shprehjeve dhe fjalëve edhe vetëm një herë nëse përdoret nga mësimdhënësit është një dhunë verbale e nivelit të lartë ndaj nxënësve, e lëre më të ndodhë shpesh siç shihet në deklaratimet e përqindjes së nxënësve !! Shprehjet që sipas nxënësve përdoren më shpesh prej disa mësimdhënësve janë: *Po përtyresh si kafshë, hidhe sakëzën; Asgjë nuk po kupton për kundër shpjegimit/mundimit tim; Je shumë i prapambetur në krahasim me shokët tu.* Në studim kemi synuar të konstatojmë se a janë të gjithë mësimdhënësit apo vetëm disa mësimdhënës që përdorin shprehje dhe fjalë të rënda kur iu drejtohen nxënësve në situata të ndryshme. Tabela në vijim i pasqyron deklaratimet e nxënësve sipas përqindjes (%) për kategorizimin e mësimdhënësve që përdorin shprehje dhe fjalë të rënda kur iu drejtohen nxënësve në situata të ndryshme.

A ka raste kur ndonjëri arsimtar i përdor edhe kësi lloj shprehjesh dhe fjalë të rënda?	Të gjithë mësimdhënësit	Disa mësimdhënës	Pa përgjigje
1. Asgjë nuk po kupton për kundër shpjegimit/mundimit tim	14.93	76.12	8.96
2. Je shumë i prapambetur në krahasim me shokët tu.	10.24	74.02	15.75
3. Po përtyresh si kafshë, hidhe çamçakëzin	29.17	62.50	8.33
4. Mos ke harruar të hash bukë (kur harron detyrat, librin, lapsin...)	37.14	57.14	5.71
5. Je debil, si po sillesh ashtu	16.92	65.38	17.69
6. Idiot, nuk je në kinema/rrugë	17.36	69.44	13.19
7. Rrugaç, a e di ku gjendesh	21.74	64.49	13.77
8. O viç, a e di çfarë prindi ke	21.10	58.72	20.18
9. Gomar, nuk je në fushë, po në klasë	17.16	67.16	15.67
10. Kryemadh, me ty po flas	18.30	67.97	13.73
11. Jeni bërë si pula	19.83	56.90	23.28
12. Ti s'je normal	37.97	53.16	8.86
13. Trupeshk	24.56	46.49	28.95
14. Hajde bukurosh/bukuroshe- hajde, mos ishe në pazar (kur vonohesh)	26.51	60.84	12.65
Totali	23.09	63.24	13.67

Tabela nr. 15: Përgjigjet e nxënësve për shkallën e përfshirjes së mësimdhënësve në fyerjet

Nga të dhënat në tabelë, shihet një përqindje relativisht e lartë, mesatarisht 23% e nxënësve që kanë deklaruar se të gjithë mësimdhënësit përdorin shprehje dhe fjalë të rënda kur iu drejtohen atyre në situata të ndryshme. Në mënyrë të veçantë na shqetëson fakti se ekziston një përqindje e lartë e nxënësve që kanë deklaruar se të gjithë mësimdhënësit i përdorin shprehjet në vijim: *Ti s'je normal (38%)*; *Po përtyפש si kafshë, hidhe sakëzën (29%)*; *Trupeshk (24.56%)*; *Rrugaç, a e di ku gjendesh (22%)*; *O viç, a e di çfarë prindi ke (21%)*; *Idiot, nuk je në kinema/rrugë (17%)*; *Je debil, si po sillesh ashtu (17%)*; *Gomar, nuk je në fushë, po në klasë (17%)*; *Etj.*

Vërtet analiza e këtyre rezultateve na ka shqetësuar jashtë mase, sepse këto fyerje dhe ofendime që u bëhen nxënësve janë të pa tolerueshme edhe nëse bëhen vetëm nga një mësimdhënës, e lëre më nëse praktikohen nga një numër i madh i mësimdhënësve siç kanë deklaruar nxënësit. Vazhdimi i përdorimit nga mësimdhënësit të këtyre shprehjeve fyese dhe ofenduese është përbuzje e rëndë e fëmijëve tanë, prandaj të gjitha institucionet tona shkollore duhet mendojnë mirë si ti largojnë nga komunikimi i tyre këto shprehje që pasqyrojnë dhunën verbale më ekstreme dhe që thyejnë rëndë të drejtat e fëmijëve për tu trajtuar me dinjitet .

3.5. Shkalla e pajtueshmërisë së nxënësve lidhur me përdorimin e fjalëve/shprehjeve fyese

Këtë aspekt e kemi hulumtuar nëpërmjet dy formave, nëpërmjet (i) listës së 14 shprehjeve fyese dhe alternativave për përgjigje nga nxënësit (pengojnë shumë /nuk pengojnë), si dhe (ii) shkallës së pajtueshmërisë apo jo pajtueshmërisë për një listë të konstatimeve që reflektojnë qëndrimet e nxënësve për përdorimin e fjalëve e shprehjeve fyese dhe reagimet e nxënësve ndaj tyre.

Në studim, lidhur me aspektin e parë të hulumtimit për shkallën e pajtueshmërisë së nxënësve lidhur me përdorimin e fjalëve/shprehjeve fyese, kemi dëshiruar të konstatojmë faktin se sa i pengojnë nxënësit shprehjet fyese dhe ofenduese që përdoren nga një numër i caktuar i

mësimdhënësve. Tabela në vijim i pasqyron deklaratimet e nxënësve sipas përqindjes (%) për atë se a i pengon nxënësit përdorimi i shprehjeve fyese dhe ofenduese nga mësimdhënësit.

Përdorimi nga mësimdhënësit i shprehjeve fyese dhe ofenduese ndaj nxënësve	Kjo më pengon shumë	Nuk më pengon	Pa përgjigje
1. Asgjë nuk po kupton për kundër shpjegimit/mundimit tim	42.74	41.88	15.38
2. Je shumë i prapambetur në krahasim me shokët tu.	65.64	24.10	10.26
3. Po përtyresh si kafshë, hidhe çamçakëzin	56.91	30.08	13.01
4. Mos ke harruar të hash bukë (kur harron detyrat, librin, lapsin...)	51.40	37.38	11.21
5. Je debil, si po silllesh ashtu	57.50	31.00	11.50
6. Idiot, nuk je në kinema/rrugë	60.00	29.73	10.27
7. Rrugaç, a e di ku gjendesh	68.50	22.00	9.50
8. O viç, a e di çfarë prindi ke	68.85	22.13	9.02
9. Gomar, nuk je në fushë, po në klasë	67.01	22.16	10.82
10. Kryemadh, me ty po flas	67.02	21.81	11.17
11. Jeni bërë si pula	54.22	33.78	12.00
12. Ti s'je normal	66.08	25.73	8.19
13. Trupeshk	55.56	30.86	13.58
14. Hajde bukurosh/bukuroshe- hajde, mos ishe në pazar (kur vonohesh)	50.87	36.99	12.14
Totali	60.35	28.50	11.15

Tabela nr. 16: Përgjigjet e nxënësve (sipas %) që tregojnë se sa pengojnë shprehjet dhe fjalët fyese e ofenduese që i përdorin mësimdhënësit ndaj tyre.

Nga të dhënat e tabelës, shihet se shumicën e nxënësve (mbi 60%) i pengon shumë përdorimi ndaj tyre i shprehjeve dhe fjalëve fyese e ofenduese nga ana e mësimdhënësve. Por, na shqetësojnë shumë të dhënat që tregojnë se një përqindje relativisht e lartë, mesatarisht 28.50% e nxënësve, sipas deklaratimeve të tyre nuk i pengojnë këto shprehje, ndërkaq nuk janë përgjigjur fare mbi 11% e nxënësve të përfshirë në hulumtim.

Për ne, përgjigjet e nxënësve janë një tregues mjaft shqetësues: *Ka filluar në masë relativisht të madhe pranimit prej nxënësve i këtyre shprehjeve fyese dhe ofenduese që i praktikojnë disa mësimdhënës.* Kjo siç tregojnë rezultatet e studimit është duke u zgjeruar në mesin e nxënësve si rezultat


i përdorimit të shpeshtë të tyre nga ana e mësimit dhe si rezultat përdorimit të këtyre shprehjeve nga një numër relativisht i madh i mësimit.

Përdorimi i shpeshtë nga mësimit i shprehjeve fyese dhe ofenduese vërtet është rrezik që nxënësit të sjellë në një situatë ku këto fyerjet dhe ofendimet të bëhen “normale” të mos i pengojë ata, të mos reagojnë ndaj tyre dhe t’i përdorin ata në procesin e shoqërorizimit të tyre me bashkëmoshatarë. Mbetet detyrë e institucioneve shkollore, dhe të tjera, që të ndërmarrin masa se si ta përmirësojnë komunikimin me nxënësit, si të parandalojnë sjelljet e mësimit por edhe të nxënësit që nxisin përdorimin e shprehjeve dhe fjalëve fyese e ofenduese për nxënësit.

Ndërsa sa i përket shkallës së pajtueshmërisë apo jo pajtueshmërisë për një listë të konstatimeve që reflektojnë qëndrimet e nxënësit për përdorimin e shprehjeve fyese dhe reagimet e nxënësit ndaj tyre, në instrumentin e hulumtimit me nxënësit, kemi vendosur nëntë konstatime që lidhen me përdorimin e shprehjeve e fjalëve/fyese (*lidhen me 14 fjalët/shprehjet e rënda fyese që ishin hulumtuar paraprakisht*) dhe për secilin konstatim kemi kërkuar nga nxënësit të shprehin qëndrimet e tyre përmes njërës nga pesë alternativat e mundësisë për përgjigje. Konstatimet e hulumtuara pasqyrohen në tabelën në vijim.


Analiza dhe përpunimi i të dhënave për konstatimet e hulumtuara që reflektojnë qëndrimet e nxënësit lidhur me disa aspekte të përdorimit të fjalëve/shprehjeve fyese, tregon se përgjigjet e nxënësit në secilin konstatim të dhënë shprehin shkallë të ndryshme të pajtimit ose mospajtimit. Rezultatet nga analiza e përgjigjeve të nxënësit për konstatimin e parë: *Kjo është normale, sepse, arsimtarët, nervozohen nganjëherë*; janë shqetësuese kur mbi 36% e nxënësit plotësisht pajtohen dhe mbi 35% e nxënësit pajtohen me këtë konstatim, mbi 10% pajtohen pjesërisht, kurse vetëm rreth 17% nuk pajtohen ose fare nuk pajtohen me këtë konstatim. Kjo sipas përgjigjeve të nxënësit lë të kuptohet se për nxënësit kanë filluar të bëhen normale fjalët e shprehjet e mësimit kur mësimit ndonjëherë janë të nervozuar. Kjo është për t’u brengosur për faktin se sjelljet e këtyra të mësimit mund të promovojnë sjelljet e ngjashme të nxënësit, por edhe mund të bëhen model të imitimit në forma të ndryshme.

Grafiku në vijim i pasqyron përgjigjet e të gjithë nxënësit të përfshirë në hulumtim për konstatimin e diskutuar.



Grafiku nr.8: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për shkallën e pajtueshmërisë së tyre - qëndrimin e tyre për përdorimin e fjalëve/shprehjeve fyese nga mësimdhënësit.

Rezultatet e përgjigjeve të nxënësve për konstatimin “*Sikur të isha në vendin e tyre edhe unë do të veproja njësoj si ata*” janë për tu brengosur. Pavarësisht se nuk është e vogël përqindja e nxënësve (mbi 42%) që nuk pajtohen apo fare nuk pajtohen me konstatimin, ekziston një përqindje relativisht e madhe e nxënësve (mbi 40%) që plotësisht pajtohen apo pajtohen me këtë konstatim. Kjo nënkupton se kjo përqindje relativisht e madhe e nxënësve i përkrahin mësimdhënësit që përdorin fjalë/shprehje fyese ndaj nxënësve, sepse ata ndonjëherë janë të nervozuar dhe mundësia është relativisht e madhe për ti pranuar sjelljet e tilla si normale, por edhe për ti praktikuar ato. Grafiku në vijim i pasqyron përgjigjet sipas të gjitha alternativave.




Grafiku nr.9: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për shkallën e pajtueshmërisë së tyre - qëndrimin e tyre për përdorimin e fjalëve/shprehjeve fyese nga mësimmhënësit.

Kur shohim përqindjet e përgjigjeve të nxënësve për dy alternativat e para (pajtohem plotësisht dhe pajtohem) dhe reflektojmë pak për përqindjen e mësimmhënësve që aktualisht japin mësim dhe gjatë studimeve nuk kanë pasur lëndë nga fusha e psikologjisë dhe e pedagogjisë, mund të supozojmë se disa prej mësimmhënësve që përdorin fjalë e shprehje fyese mund t'i imitojnë ish mësimmhënësit e tyre të cilët kanë përdorur fjalë e shprehje fyese ndaj nxënësve. **Kjo nënkupton që edhe brezi i mësimmhënësve që aktualisht janë në proces mësimor ndikojnë me sjelljet e tyre në brezin aktual të nxënësve, rrjedhimisht edhe në brezat ardhshëm të mësimmhënësve, sepse një numër nxënësish do të orientohen për mësues.**

Rezultate mjaft interesante kanë dalë edhe nga analiza dhe përpunimi i rezultateve të dy konstatimeve përmes të cilave kemi synuar të hulumtojmë (i) *qëndrimet e nxënësve se sa i konsiderojnë shprehjet fyese problem për ta* dhe (ii) *cili është qëndrimi i nxënësve se a i meritojnë apo nuk i meritojnë nxënësit fjalët/shprehje të tilla nga mësimmhënësit e tyre.*

Për aspektin e parë, përsëri është vërtetuar konstatimi ynë se ekziston një përqindje relativisht e madhe e nxënësve që janë pajtuar me përdorimin e shprehjeve të tilla nga mësimmhënësit dhe tani më ata nxënës nuk i konsiderojnë këto shprehje si shprehje fyese dhe se nuk e shohin ndonjë problem me përdorimin e tyre. Këtë e kanë shprehur mbi 31% e nxënësve, si dhe rreth 15% e nxënësve që pajtohen pjesërisht. Megjithatë, rezultatet


tregojnë se përqindje e madhe e nxënësve (mbi 48%) nuk pajtohen dhe fare nuk pajtohen me këtë konstatim, që do të thotë se ky grup i nxënësve shprehjet fyese të cilat mësimdhënësit i përdorin ndaj tyre i konsiderojnë mjaft problem, ose i përjetojnë rëndë. Grafiku në vijim i pasqyron rezultatet e hulumtimit për këtë aspekt të diskutuar.



Grafiku nr.10: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për shkallën e pajtueshmërisë së tyre - qëndrimin e tyre lidhur me atë se a i shohin problem shprehjet fyese që i përdorin mësimdhënësit ndaj tyre.

Nga të dhënat e pasqyruara në grafik, vërtetohet ajo që u diskutua më lartë ku shihet qartë se përqindja më e madhe e nxënësve (rreth 48%) kanë shprehur qëndrimin e tyre se fjalët/shprehjet e diskutuara janë fyese për nxënës dhe se paraqesin problem për ta. Megjithatë, grafiku tregon për një përqindje relativisht të lartë e nxënësve, të cilët janë mësuar me këtë dhe nuk i konsiderojnë si shprehje si fyese dhe se nuk paraqesin ndonjë problem për ta. Kjo gjendje mund të paraqet rrezikun për zhvillimin e kulturës dhe të qëndrimit pasiv, tolerant, të nxënësve për të mos reaguuar edhe kur fyhen ose iu shkelen të drejtat elementare, qoftë në shkollë apo në rrethin shoqëror. Gjithashtu kjo mund të ndikojë në krijimin servilëve në shoqëri, pa marrë parasysh të drejtat e tyre.

Një aspekti tjetër i hulumtuar është gjykimi i nxënësve për disa nga nxënësve se a i meritojnë apo jo kësi lloj fjalësh/shprehjesh fyese nga mësimdhënësit e tyre. Analiza dhe përpunimi i të dhënave tregon se shumica e nxënësve e hedhin poshtë këtë konstatim me qëndrimet e tyre të shprehura në pyetësorin e hulumtimit. Grafiku në vijim i pasqyron rezultatet sipas shkallëve të pajtueshmërisë.



Grafiku nr.11: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për shkallën e pajtueshmërisë së tyre - qëndrimin e tyre lidhur me atë se a i meritojnë disa nxënës shprehjet fyese prej mësimitdhënësve të tyre.


Nga të dhënat e pasqyruara në këtë grafik, shohim se rreth 55% e nxënësve kanë shprehur qëndrimin e tyre se *nuk pajtohen* dhe *fare nuk pajtohen* se ka nxënës të cilët meritojnë që ndaj tyre të përdoren fjalë fyese. Këto të dhëna e rrëzojnë gjykimet e gabuara, që shpesh dëgjohej në diskutimet për nxënës, nga disa mësimitdhënës, drejtorë shkollash, prindër, se disa nxënës i meritojnë fjalët/shprehjet fyese nga mësimitdhënësit për sjellje të caktuara. Shpeshherë në diskutime të tilla janë ngatërruar gjykimet për sjelljen e nxënësve në raport me për mënyrën dhe formën se si mësimitdhënësit i drejtohen nxënësve në situata të caktuara kur sjelljet e tyre nuk janë në harmoni me rregullat e sjelljes në klasë apo me rregullat e komunikimit. Megjithatë, hulumtimi tregon për një përqindje relativisht e lartë e nxënësve që pajtohen plotësisht (rreth 11%) dhe pajtohen (mbi 17%), si dhe pjesërisht pajtohen (rreth 13%) se disa nxënës meritojnë që ndaj tyre të përdoren fjalë/ shprehje fyese. Kjo mund të jetë edhe shprehje e një servilizmi të tyre ndaj mësimitdhënësve, apo edhe ndonjë formë e zhgënjimit të tyre ndaj nxënësve të cilët sillen jo në pajtim me rregullat e klasës dhe të shkollës.

Diskutimi i dy aspekteve të fundit i përforcon pohimet e diskutimit paraprak se shumica e nxënësve nuk pajtohen me fjalët/shprehjet fyese që në raste të caktuar mësimitdhënësit i përdorin qoftë kur i drejtohen nxënësve apo edhe kur i kritikojnë sjelljet e nxënësve, si dhe shumica e nxënësve shprehin qëndrim të qartë se nuk i meritojnë fjalët/shprehjet fyese që i përdorin mësimitdhënësit e tyre.

Një aspekt tjetër që kemi synuar ta hulumtojmë në këtë studim, ishte qëndrimi i nxënësve për fjalët/shprehjet fyese të cilat mësimitdhënësit i përdorin edhe në

shkollat tjera. Këtë e kemi bërë me qëllim që të marrim përgjigje jo të drejtpërdrejta për shkollën e tyre. Dy ishin konstatimet kryesore të hulumtimit të këtij aspekti, përmes të cilave kërkua nga nxënësit të shprehin shkallën e pajtimit/mospajtimit lidhur me këto konstatime: (i) *Fjalët/shprehjet fyese i përdorin mësimdhënësit në të gjitha shkollat*; (ii) *Mirë është në shkollën tonë çfarë fyerjesh bëhen në shkollat tjera*.


Nga analiza e përgjigjeve të nxënësve lidhur me këto dy konstatime që ndërlidhen me përdorimin e fjalëve/shprehjeve fyese nga mësimdhënësit ndaj tyre, nxjerrim të dhëna të cilat konfirmojnë qëndrimet e nxënësve se fjalët/shprehjet fyese përdoren nga mësimdhënësit e të gjitha shkollave, këtë e shprehin mbi 41% e nxënësve që pajtohen plotësisht apo pajtohen me këtë konstatim apo mbi 22% e nxënësve që pjesërisht pajtohen me këtë konstatim. Rezultatet tregojnë se mbi 31% e nxënësve nuk pajtohen ose fare nuk pajtohen me këtë konstatim, që nënkupton se fjalët dhe shprehjet fyese sipas tyre nuk përdoren nga mësimdhënësit e të gjitha shkollave. Grafiku në vijim i sjellë të dhënat e plota për shkallën e pajtimit/mospajtimit të nxënësve me këtë konstatim.



Grafiku nr.12: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për shkallën e pajtueshmërisë së tyre - qëndrimi i nxënësve për fjalët/shprehjet fyese që i përdorin mësimdhënësit në shkollat tjera.

Gjithashtu, nga analiza dhe përpunimi i të dhënave mësojmë se mendimet e nxënësve nuk dallojnë shumë sa i përket pohimit se: *Mirë është në shkollën tonë çfarë fyerjesh bëhen në shkollat tjera*. Përqindja e nxënësve (mbi 36%) që pajtohen plotësisht dhe pajtohen me këtë konstatim është e përafërt me përqindjen e nxënësve (mbi 37%) të cilët nuk pajtohen ose fare

nuk pajtohen me këtë konstatim. Këta të fundit japin sinjal që në shkollën e tyre është më keq se në shkollat tjera sa i përket përdorimit të fjalëve fyese nga mësimdhënësit ndaj tyre, kurse të parët e shprehin të kundërtën – në shkollat tjera është me keq. Grafiku në vijim pasqyron të dhënat e plota për shkallën e pajtimit/mospajtimit të nxënësve lidhur me këtë.



Grafiku nr.13: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për shkallën e pajtueshmërisë së tyre - qëndrimi i nxënësve për fjalët/shprehjet fyese në shkollën e tyre në raport me shkollat tjera.

3.5.1. Qëndrimi i nxënësve për ndikimin e fjalëve dhe shprehjeve fyese ndaj tyre

Shpeshherë komunikimi në mes të njerëzve bahet instrument i atakimi me pasoja të rënda që kanë ndikime të ndryshme në personalitetin e individit. Për të parë ndikimin e fjalëve e shprehjeve fyese ndaj nxënësve, në instrumentin tonë të studimit kemi shtruar një pyetje përmes së kemi kërkuar nga nxënësit të tregojnë se a ndikon përdorimi i fjalëve e shprehjeve fyese në prishjen e raporteve të mira me mësimdhënësit e tyre.

Analiza dhe përpunimi i të dhënave të hulumtimit për këtë aspekt tregojnë se në përgjithësi nxënësit tregohen ma tolerantë në ruajtjen e raporteve të mira me mësimdhënësit e tyre. Mirëpo, nxënësit tregohen më konsekuentë sa i përket qëndrimit të tyre lidhur me pranimin e fjalëve dhe shprehjeve fyese që u bëhen nga të tjerët. Tabela në vijim pasqyron përgjigjet e nxënësve sipas përqindjes (%) për katër aspektet e hulumtuara lidhur me ndikimin e përdorimit të fjalëve e shprehjeve fyese në raportet e mira me mësimdhënësit.

Përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve fyese ndaj teje, a ndikon në prishjen e raportit të mirë me ata mësimdhënës që i përdorin?	PO	JO	Pa përgjigje
a) Është mirë, kjo ma tërheq vëmendjen për mësim dhe ndikon mirë tek unë	21.86	68.03	10.11
b) Kjo ma vështirëson përqendrimin dhe punën mësimore në klasë	39.89	50	10.11
c) Fjalët dhe shprehjet fyese nuk i duroj fare, nga askush	45.08	45.08	9.84
d) Veç nuk guxoj, se nuk di çka u kisha bërë atyre që përdorin fjalë të tilla ndaj meje	25.14	64.75	10.11

Tabela nr.17: Përgjigjet e nxënësve për ndikimin e fjalëve e shprehjeve fyese në prishjen e raporteve të mira me mësimdhënës

Siç shihet nga rezultatet e dhëna në tabelë, ka dallime të dukshme në mes të përgjigjeve për secilin prej konstatimeve që pasqyrojnë ndikimin e fjalëve fyese tek nxënësit. Në konstatimin e parë “*Është mirë (kur përdoren fjalë e shprehje fyese), kjo ma tërheq vëmendjen për mësim dhe ndikon mirë tek unë*”, shohim se nxënësit në përqindje më të madhe (mbi 68%) e kanë thënë JO, përkatësisht kanë than se përdorimi i fjalëve e shprehjeve fyese ndaj tyre ndikon negativisht në mësim. Por në këtë alternativë është një përqindje e konsiderueshme e nxënësve (rreth 22%) që kanë thënë PO, që e shohin pozitivisht ndikimin e përdorimit të fjalëve e shprehjeve fyese në tërheqjen e vëmendjes së tyre për mësim. Përgjigjet e nxënësve me PO, janë edhe një dëshmi e vërtetimit tonë në diskutimet paraprake se një përqindje relativisht e madhe e nxënësve kanë filluar ti pranojnë si “normale” fjalët fyese që përdoren ndaj tyre nga ana e disa mësimdhënësve. Dhe, ne pikërisht këtë e shohim një rrezik të madh që fjalori i tillë të behët edhe pjesë e fjalorit, zhargonit të të rinjve dhe të vazhdojë edhe në gjeneratat tjera.

Në konstatimin e dytë “*Kjo ma vështirëson përqendrimin dhe punën mësimore në klasë*”, kemi rezultate që bien ndesh me konstatimin e parë, sepse përqindja e nxënësve që janë shprehur se përdorimi i fjalëve e shprehjeve fyese ndaj tyre vështirëson përqendrimin e tyre në mësim është më e vogël për 20% se për rastin e parë kur nxënësit janë shprehur se përdorimi i fjalëve e shprehjeve fyese ndaj tyre ndikon negativisht në mësim. Supozojmë se konstatimi i dytë “*Kjo ma vështirëson përqendrimin dhe punën mësimore në klasë*”, mund të mos jetë kuptuar në esencë, megjithatë e rëndësishme është se rreth 40% e nxënësve kanë thënë se përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve fyese vërtet ndikon në përqendrimin e tyre në punën mësimore në klasë. Pra lind pyetja: *Çka do të*

thotë që një mësimitdhënës të ndikojë negativisht tek 40% e nxënësve në klasë përmes përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve fyese? Përgjigjja, no coment!

Janë shumë interesant përgjigjet e nxënësve për konstatimin e tretë "Fjalët dhe shprehjet fyese nuk i duroj fare", përqindja e nxënësve që janë shprehur me *PO* dhe e atyre që janë shprehur me *Jo*, është e njëjtë. Përgjigjet e nxënësve me *JO*, janë edhe një dëshmi e vërtetimit tonë në diskutimet paraprake se një përqindje relativisht e madhe e nxënësve kanë filluar ti pranojnë si "normale" fjalët fyese që përdoren ndaj tyre nga ana e disa mësimitdhënësve.


Këto të dhëna tregojnë që pavarësisht përqindjes së reflektuar në përgjigjet e nxënësve, ndjeshmëria e nxënësve ndaj përdorimit të fjalëve e shprehjeve fyese është e evidente. Prandaj, të gjitha institucionet shkollore duhet të reflektojnë për këtë temë në shkollat e tyre, duke diskutuar, analizuar dhe duke përgatitur një platformë se bashku me të gjithë akterët e saj për eliminimin, parandalimin e kësaj të keqeje që i atakon drejtpërdrejtë fëmijët tanë dhe dinjitetin e tyre. Sa më shpejt që institucionet shkollore i adresojnë problemet e dhunës verbale në shkollë qa më shpejt do të zhvillohet demokracia në shkollë dhe do të respektohen rregullat e sjelljes në shkollë nga të gjithë nxënësit.

3.5.2. Qëndrimi i nxënësve ndaj mësimitdhënësve që përdorin fjalë e shprehje fyese ndaj tyre

Qëndrimet e nxënësve ndaj mësimitdhënësve që përdorin fjalë e shprehje fyese ndaj nxënësve, janë aspekt tjetër i përfshirë në studimin tonë. Ato janë hulumtuar përmes në mënyrë jo të drejtpërdrejtë ku nxënësve u është kërkuar të shprehin shkallën e pajtimit/mospajtimit me konstatimet në vijim (i) *Atyre mësimitdhënësve që përdorin fjalë/shprehje fyese ndaj nxënësve u mungon edukata elementare;* (ii) *Mësimitdhënësit që përdorin fjale/shprehje fyese nuk meritojnë të punojnë me nxënës;* dhe (iii) *Ne jemi nxënës dhe nuk kemi çka të bëjmë ndaj tyre,* si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ku nxënësve u është kërkuar të shprehin qëndrimin e tyre për mësimitdhënësit që përdorin fjalë fyese ndaj nxënësve.


Rezultatet për qëndrimet e nxënësve ndaj mësimitdhënësve që përdorin fjalë e shprehje fyese që janë arritur përmes mënyrës jo të drejtpërdrejtë, tregojnë se pavarësisht se nxënësit herë – herë e shohin si "normale" përdorimin e fjalëve e shprehjeve fyese nga mësimitdhënësit që ndonjëherë janë të nervozuar, ata megjithatë tregojnë se i gjykojnë sjelljet e tilla të mësimitdhënësve. Këtë e kanë shprehur një përqindje relativisht e madhe e nxënësve në kërkesën tonë për të shprehur shkallën e pajtimit/mospajtimit lidhur me konstatimin *Atyre*

mësimdhënësve që përdorin fjalë/shprehje fyese ndaj nxënësve u mungon edukata elementare, ku rreth 19% e nxënësve pajtohen plotësisht me këtë konstatim, mbi 19% pajtohen, rreth 18% pjesërisht pajtohen, kurse mbi 40% nuk pajtohen apo fare nuk pajtohen. Në grafikun në vijim pasqyrohen përgjigjet sipas shkallës së pajtimit/mospajtimit.




Grafiku nr.14: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për shkallën e pajtueshmërisë së tyre - qëndrimin e tyre lidhur me mësimdhënësi që përdorimin e fjalëve/shprehjeve fyese ndaj nxënësve.

Qëndrimi negativ i nxënësve ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë e shprehje fyese ndaj tyre më së miri shprehet me shkallën e pajtimit të tyre për konstatimin: *Mësimdhënësit që përdorin fjale/shprehje fyese nuk meritojnë të punojnë me nxënë.* Mbi 59% e nxënësve pajtohen plotësisht ose pajtohen se mësimdhënësit që përdorin fjalë e shprehje fyese ndaj nxënësve nuk meritojnë të punojnë me nxënë, rreth 17% pajtohen plotësisht, mbi 20% nuk pajtohen apo fare nuk pajtohen me këtë konstatim. Grafiku në vijim pasqyron përgjigjet e nxënësve sipas përqindjes (%) për shkallën e pajtimit/mospajtimit të nxënësve me konstatimin e diskutuar.



Grafiku nr.15: Përgjigjet e nxënësve për shkallën e pajtueshmërisë së tyre - qëndrimin e tyre lidhur me mësimdhënësi që përdorimin e fjalëve/shprehjeve fyese ndaj nxënësve.


Se nxënësit vërtet nuk pajtohen me mësimdhënësit që ndaj tyre përdorin fjalë/shprehje fyese dhe ofenduese, tregojnë rezultatet lidhur me konstatimin e hulumtuar: *Ne jemi nxënës dhe nuk kemi çka të bëjmë ndaj tyre.* Mbi 38% e nxënësve pajtohen plotësisht me këtë konstatim, mbi 24% pajtohen, rreth 12% pjesërisht pajtohen, kurse mbi 22% nuk pajtohen apo fare nuk pajtohen me këtë konstatim. Grafiku në vijim pasqyron përgjigjet e nxënësve sipas përqindjes (%) për shkallën e pajtimit/mospajtimit të nxënësve me konstatimin e diskutuar.



Grafiku nr.16: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për shkallën e pajtueshmërisë së tyre - qëndrimin e tyre lidhur me mësimdhënësi që përdorimin e fjalëve/shprehjeve fyese ndaj nxënësve.

Në komunikime të ndryshme me nxënës për mësimdhënës dhe punën e tyre, shpesh ndodh që të dëgjohen reagime jo të mira ndaj mësimdhënësve prej nxënësve me rezultate jo të mira në mësim. Lidhur me diskutimet paraprake, ne i kemi krahasuar rezultatet e hulumtimit me nxënës edhe në raport me suksesin e tyre në mësim. Për konstatimin *Mësimdhënësit që përdorin fjalë/shprehje fyese nuk meritojnë të punojnë me nxënës*, rreth 70% e nxënësve që kanë shprehur qëndrimin e tyre se plotësisht pajtohen ose pajtohen me këtë konstatim, janë nxënës që kanë sukses në mësim të shkëlqyeshëm, kurse 20% prej tyre kanë sukses shumë mirë në mësim. Kjo përqindje është përafërsisht e njëjtë edhe për dy konstatimet e diskutuara paraprakisht: *Atyre mësimdhënësve që përdorin fjalë/shprehje fyese ndaj nxënësve u mungon edukata elementare; Ne jemi nxënës dhe nuk kemi çka të bëjmë ndaj tyre*. Nga krahasimi i këtyre të dhënave, vijmë në përfundim se nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm dhe të shumë mirë në mësim, megjithatë janë me stabile në shprehjen e qëndrimeve të tyre lidhur me mësimdhënësit që përdorin fjalë/shprehje fyese ndaj nxënësve.

Qëndrimi i nxënësve ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë e shprehje fyese ndaj tyre është hulumtuar edhe nëpërmjet pyetjes së drejtpërdrejtë drejtuar nxënësve: *Nëse ndonjë mësimdhënës përdor fjalë a shprehje fyese ndaj teje, çfarë është qëndrimi yt ndaj tij?* Lidhur me këtë pyetje, nxënësve u janë dhënë pesë alternativa për mundësi të përgjigjeve prej një e më shumë përgjigjeje. Grafiku në vijim i paraqet përgjigjet e nxënësve lidhur me pyetjen drejtuar nxënësve për qëndrimin e tyre ndaj mësimdhënësit që përdor fjalë a shprehje fyese ndaj nxënësve.



Grafiku nr.17: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve për qëndrimin e tyre ndaj mësimdhënësit që përdor fjalë a shprehje fyese ndaj nxënësve

Nga të dhënat e pasqyruara në grafik, shihet një shpërndarje e përafërt e nxënësve që kanë qëndrim negativ (rreth 49%) dhe atyre që nuk kanë qëndrim negativ (mbi 46%) ndaj mësimdhënësit që përdor fjalë a shprehje fyese ndaj nxënësve.

Në përgjigjet për alternativën që pasqyron reagimin e nxënësve ndaj mësimdhënësit që përdorin fjalë a shprehje fyese, shohim se shumica e nxënësve të përfshirë në hulumtim, rreth 69% kanë dhënë përgjigje JO, që nënkupton se janë shprehur se reagojnë ndaj mësimdhënësit që përdorin ndaj tyre fjalë a shprehje fyese. Megjithatë, rezultatet tregojnë se një përqindje relativisht e lartë e nxënësve (mbi 26%) në bazë të përgjigjeve të tyre për këtë alternativë kanë treguar se nuk reagojnë ndaj mësimdhënësit që përdor fjalë a shprehje fyese. Përgjigjet në këtë alternativë përputhen me konkludimet tona në diskutimet paraprake të interpretimit të rezultateve të hulumtimit me nxënës, si dhe me alternativën e katërt të kësaj pyetjeje ku rreth 24% e nxënësve janë shprehur se tani më jemi mësuar me fjalët a shprehjet fyese që i përdorin mësimdhënësit. Gjithashtu rezultatet përafërsisht përputhen edhe me përqindjen e nxënësve (mbi 71%) që përputhen që nuk janë mësuar me shprehje të tilla nga mësimdhënësit dhe me përqindjen e nxënësve (rreth 69%) që janë shprehur se reagojnë ndaj mësimdhënësit që përdor fjalë a shprehje fyese ndaj tyre.

Në përgjigjet për alternativën që pasqyron qëndrimin e nxënësve “armiqësor dhe hakmarrës” ndaj mësimdhënësit që përdor fjalë a shprehje fyese ndaj tyre, kemi rezultate mjaft interesante dhe të sqarta nga nxënësit. Shumica e nxënësve të përfshirë në hulumtim, rreth 80% e tyre janë shprehur se nuk janë armiqësor dhe hakmarrës ndaj mësimdhënësit të tillë. Megjithatë, është një përqindje (mbi 15%) që nuk duhet injoruar që janë shprehur se janë armiqësor dhe hakmarrës ndaj mësimdhënësit që përdor fjalë a shprehje fyese ndaj tyre. Përqindja tjetër e nxënësve nuk janë përgjigjur për këtë aspekt.

Qëndrimi tjetër i nxënësve i hulumtuar, reagimi i tyre ndaj mësimdhënësit që përdor fjalë a shprehje fyese ishte përjetimi emocional i nxënësve në situatat kur ndaj tyre përdoren fjalë a shprehje fyese. Siç u pa grafikun e fundit ky aspekt u hulumtua përmes fjalisë: Nuk mund ta merrni me mend se si ndihem, pëlças nga inati (kur ndaj meje mësimdhënësi përdor fjalë a shprehje fyese). Rezultatet nga grafiku shihen se një përqindje e madhe e nxënësve mbi 41% fjalët a shprehjet fyese që i marrin nga mësimdhënësi i përjetojnë rëndë, mirëpo një përqindje më e madhe e tyre, rreth 54% janë

shprehur se nuk i përjetojnë rëndë situatat e tilla. Mbi 5% e nxënësve nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Kur kemi parasysh moshën e nxënësve që janë përfshirë në studimin tonë, si dhe kur kemi parasysh se mbi 41% e nxënësve i përjetojnë rëndë fjalët e shprehjet fyese nga mësimdhënësit e tyre, vetvetiu del kërkesë urgjente për të gjitha institucionet shkollore që të marrin iniciativa, vetiniciativa për adresimin e drejtë të dhunës verbale në shkollë, sepse çdo rritje e nivelit të saj apo qoftë edhe ruajtje e nivelit aktual do të shkaktojë shqetësime tek nxënësit, prindërit e tyre dhe mbarë shoqëria.

3.6. Qëndrimet e nxënësve sipas gjinisë

Duke pasur parasysh aspektet e hulumtuara në studimin tonë për dhunën verbale, ne kemi dëshiruar që të bëjmë një krahasim të qëndrimeve të nxënësve edhe në raport me gjininë, në mënyrë që rezultatet nga krahasimi sipas gjinisë të ndihmojnë në nxjerrjen e përfundimeve të qarta dhe rekomandimeve për adresimin e drejtë të dhunës verbale në shkollë.


Analiza dhe përpunimi i të dhënave për qëndrimet e nxënësve sipas gjinisë për aspekte të ndryshme të dhunës verbale në shkollë, ofron të dhëna mjaft interesante. Ne jemi përpjekur që në pjesën në vijim ti ofrojmë dhe diskutojmë disa të dhëna që ofrojnë nuanca të ndryshme të dallimeve sipas gjinisë, që kalojnë raportin e dallimeve mbi 5% . Krahasimet sipas gjinisë i kemi nxjerrë sipas mesatares së nxënësve sipas gjinisë, sepse në studim janë përfshirë 2.30% më shumë djem se vajza.

Krahasimi i qëndrimeve të nxënësve sipas gjinisë për raportin mësimdhënës – nxënës në shkollë, shpeshhtësinë e shprehjeve fyese që mësimdhënësit i përdorin kur iu drejtohen nxënësve, pajtimin/mospajtimin e nxënësve me shprehjet fyese që i përdorin mësimdhënësit ndaj tyre, si dhe qëndrimin e nxënësve ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre, mbështetet në analizën dhe përpunimin e të dhënave të përgjithshme të prezantuara në kapitullin ku diskutohen rezultatet e hulumtimit me nxënës. Analiza dhe krahasimi i rezultateve për qëndrimet e nxënësve sipas gjinisë, ofron të dhënat në vijim:

- vajzat për 6% më shumë se djemtë shprehen se: *hidhërohen kur mësimdhënësi nuk e kupton problemin e tyre, si dhe nervozohen shumë kur mësimdhënësi i tyre nuk i dëgjon arsyetimet e tyre.*

- vajzat për 12% më shumë se djemtë shprehen se: *iu ka ndodhur të qajnë kur mësimdhënësi ka përdorur fjalë të rënda ndaj tyre.*
- vajzat për 15% më shumë se djemtë shprehen se: *për mësimdhënësit që i fyejnë ankohen tek prindërit e tyre;*
- djemtë për 10% më shumë se vajzat shprehen se: *sikur të ishin në vendin e mësimdhënësve edhe ata do të përdornin fjalë a shprehje fyese kur iu drejtohen nxënësve në situata të caktuara;*
- vajzat për 8% më shumë se djemtë shprehen se : *fjalët a shprehjet fyese që i përdorin mësimdhënësit e tyre i shohin si problem të madh.*
- djemtë për 18% më shumë se vajzat, shprehen se: *nuk i durojnë fjalët fyese nga askush;*
- djemtë për 13% më shumë se vajzat, shprehen se: *veç nuk guxoj, se nuk di çka u kisha bërë atyre që përdorin fjalë fyese ndaj meje;*

Analiza dhe përpunimi i të dhënave për qëndrimet e nxënësve sipas gjinisë për aspekte të ndryshme të dhunës verbale në shkollë, ofron të dhëna mjaft interesante sa i përket qëndrimeve të nxënësve ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre. Dallimet më të mëdha janë shënuar në qëndrimin e nxënësve “armiqësor dhe hakmarrës”, këtë e tregojnë të dhënat ku 77% e djemve kanë shprehur se kanë qëndrim armiqësor dhe hakmarrës ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj nxënësve. Dallime janë shënuar edhe sa i përket qëndrimit se sa janë mësuar nxënësit me fjalët a shprehjet fyese që i përdorin mësimdhënësit, këtë e tregojnë të dhënat ku 55% e djemve shprehen se janë mësuar më fjalët dhe shprehjet fyese që i përdorin mësimdhënësit e tyre, kurse të njëjtën gjë e kanë shprehur 45% e vajzave të përfshira në hulumtim. Grafiku në vijim dallimet qëndrimeve të nxënësve sipas gjinisë për mësimdhënësit që ndaj tyre përdorin fjalë a shprehje fyese.



Grafiku nr.18: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve sipas gjinisë për qëndrimet e tyre ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre

Nga të dhënat e pasqyruara në grafik, shihet se një shpërndarje e përafërt e dallimeve gjinore sa i përket qëndrimeve të nxënësve ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese është në alternativat *Shumë negativ* dhe *Nuk reagoj fare*. Për këto dy alternativa, dallimi është për 6% më i lartë tek gjinia mashkullore, që nënkupton se djemtë më shuam kanë qëndrim negativ dhe nuk reagojnë fare ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese. Dy alternativat tjera më dallime më të mëdha *Armiqësor dhe hakmarrës*; *Tani jam mësuar me këto shprehje*, u diskutuan më lartë. Kurse qëndrimi i nxënësve se si ndihen kur mësimdhënësit përdorin fjalë a shprehje fyese ka shënuar dallimet më të vogla (vetëm 2%), që nënkupton nxënësit e të dy gjinive i përjetojnë afërsisht njëjtë fjalët a shprehjet fyese që i përdorin mësimdhënësit ndaj tyre.

Nga analiza dhe përpunimi i rezultateve të hulumtimit të të dhënave të përgjithshme dhe diskutimit të të dhënave për qëndrimet e nxënësve sipas gjinisë, shohim se dallimet janë evidente në disa qëndrime të nxënësve. Disa qëndrime të vajzave janë shprehur në përqindje më të lartë se sa të djemve dhe anasjelltas. Shumica e dallimeve nuk kalojnë kufirin mbi 18%

në raport me njëjërën apo tjetrën gjini. Dallimi më i lartë që është evidentuar në këtë analizë është qëndrimi i djemve armiqësor dhe hakmarrës ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre, është për 54% më i lartë se tek gjinia femërore.

3.6.1. Qëndrimet e nxënësve sipas gjeografisë fshat – qytet

Ashtu sikur krahasimin e qëndrimeve të nxënësve sipas gjinisë, edhe krahasimin e qëndrimeve të nxënësve sipas gjeografisë fshat-qytet e kemi bërë me qëllim që të ndihmojnë në nxjerrjen e përfundimeve të qarta dhe rekomandimeve për adresimin e drejtë të dhunës verbale në shkolla.

Analizën dhe përpunimin e të dhënave për qëndrimet e nxënësve sipas gjeografisë fshat-qytet për aspekte të ndryshme të dhunës verbale në shkollë e kemi nxjerrë sipas mesatares së nxënësve në bazë të gjeografisë fshat-qytet. Në studim janë përfshirë 155 nxënës nga shkollat e fshatit ose 42%, dhe 212 nxënës nga shkollat e qytetit ose 58%, ku numri i nxënësve të përfshirë nga qyteti është për 16% më i madh.

Krahasimi i qëndrimeve të nxënësve sipas gjeografisë fshat-qytet për raportin mësimdhënës – nxënës në shkollë, shpeshësinë e shprehjeve fyese që arsimtarët i përdorin kur iu drejtohen nxënësve, pajtimin/mospajtimin e nxënësve me shprehjet fyese që i përdorin mësimdhënësit ndaj tyre, si dhe qëndrimin e nxënësve ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre, mbështetet në analizën dhe përpunimin e të dhënave të përgjithshme të prezantuara në kapitullin ku diskutohen rezultatet e hulumtimit me nxënës. Analiza dhe krahasimi i rezultateve për qëndrimet e nxënësve sipas gjeografisë fshat-qytet, ofron të dhënat në vijim:


- prej 21 nxënësve (6% e totalit të nxënësve të përfshirë në hulumtim) që janë shprehur se në shkollën tonë nuk ekziston atmosferë e mirë për punë dhe për mësim, 13 prej tyre janë nga shkollat e fshatit ose mbi 62% e tyre;
- prej 140 nxënësve që kanë thënë se nervozohen shumë kur mësimdhënësit i tyre nuk i dëgjojnë arsyetimet e tyre, 93 prej tyre janë nga shkollat e qytetit ose mbi 66% e tyre;
- prej 123 nxënësve që kanë thënë se mësimdhënësit shpesh e përdorin shprehjen “*Prindërit të kanë mësuar të sillesh kështu*”, 78 prej tyre janë nga shkollat e qytetit ose mbi 63% e tyre.

- prej 64 nxënësve që kanë thënë se mësimdhënësit shpesh e përdorin shprehjen “*Je shumë i prapambetur në krahasim me shokët tu*”, 37 prej tyre janë nga shkollat e qytetit ose 58% e tyre.
- shprehja “*Je shumë i prapambetur në krahasim me shokët tu*”, më shumë i pengon nxënësit nga shkollat e qytetit se sa nxënësit nga shkollat e fshatit, këtë e kanë shprehur 128 nxënës, ku 84 nxënës janë nga shkollat e qytetit ose rreth 65%.
- shprehja “*Je debil, si po sillesh ashtu*”, më shumë ndodh të përdorët në shkollat e qytetit se në shkollat e fshatit, këtë e kanë shprehur 59 nxënës, ku 36 prej tyre janë nga shkollat e qytetit ose rreth 61%. Gjithashtu, shprehja “*Je debil, si po sillesh ashtu*”, më shumë i pengon nxënësit nga shkollat e qytetit se sa nxënësit nga shkollat e fshatit. Këtë e kanë shprehur 115 nxënës, ku 69 nxënës janë nga shkollat e qytetit ose rreth 60% e tyre.
- shprehja “*Ti s’je normal*”, më shumë përdoret nga disa mësimdhënësit të shkollave në qytete se nga mësimdhënësit e shkollave në fshatra, këtë e kanë shprehur 144 nxënës, ku 98 prej tyre janë nga shkollat e qytetit ose rreth 68%.
- prej 146 nxënësve që janë pajtuar plotësisht dhe janë pajtuar me shprehjen se “*Sikur të isha në vendin e mësimdhënësve edhe unë do të veproja njësoj si ata*”, 91 prej tyre janë nga shkollat e qytetit ose 62% e tyre.
- prej 132 nxënësve që janë pajtuar plotësisht dhe janë pajtuar me shprehjen se “*Mirë është në shkollën tonë çfarë fyerjesh bëhen në shkollat tjera*”, 90 prej tyre janë nga shkollat e qytetit ose 68% e tyre
- prej 140 nxënësve që janë pajtuar plotësisht dhe janë pajtuar me shprehjen se “*Mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese iu mungon edukata elementare*”, 82 prej tyre janë nga shkollat e qytetit ose rreth 59% e tyre
- prej 217 nxënësve që janë pajtuar plotësisht dhe janë pajtuar me shprehjen se “*Mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese nuk meritojnë të punojnë me nxënës*”, 130 prej tyre janë nga shkollat e qytetit ose rreth 60% e tyre

Për të ilustruar shembuj të dallimeve më të detajuara sipas pyetjeve dhe alternativave me përgjigje sipas nxënësve të shkollave të qytetit dhe

nxënësve të shkollave të fshatit, në pjesën në vijim do të sjellim dy shembuj të ilustruar edhe me paraqitje grafike.


Analiza dhe përpunimi i të dhënave për disa nga shprehjet që përdoren çdo ditë dhe shpesh prej disa mësimdhënësve tregon se ka dallime relativisht të rëndësishme ndërmjet deklarimeve të nxënësve që vijnë në mësimet në fshat dhe atyre që i vijnë në mësimet në qytet. Dallimet më të mëdha vërehen në shprehjet: *A e dini pse vini në shkollë?* *Ti se meriton notën më të madhe.* Grafiku në vijim i sjellë këto dallime.



Grafiku nr. 19: Dallimet fshat – qytet të përgjigjeve të nxënësve në përqindje (%) për shpeshësinë e përdorimit më të madh të disa shprehjeve përmes të cilave mësimdhënësit iu drejtohen nxënësve.

Siç shihet nga rezultatet e prezantuara në grafik, dallimet më të mëdha janë në shprehjen *A e dini pse vini në shkollë?*, sidomos në alternativën që tregon se mësimdhënësit shpesh e përdorin këtë shprehje. Rezultatet tregojnë se mësimdhënësit e qytetit për 8% më shpesh e përdorin këtë shprehje se sa mësimdhënësit që punojnë në fshat. Dallime janë shënuar edhe në alternativat tjera për përgjigje, por janë në shkallë më të ulët.

Analiza dhe përpunimi i të dhënave për qëndrimet e nxënësve sipas gjeografisë fshat-qytet për qëndrimeve të nxënësve ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre ofron të dhëna me dallime të rëndësishme, ku po thuajse për të gjitha alternativat e hulumtuara dallimet janë për rreth 20% më shumë në shkollat e qytetit. Grafiku në vijim dallimet qëndrimeve të nxënësve sipas gjeografisë fshat - qytet për mësimdhënësit që ndaj tyre përdorin fjalë a shprehje fyese.



Grafiku nr.20: Paraqitja grafike e përgjigjeve të nxënësve sipas gjeografisë fshat - qytet për qëndrimet e tyre ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre

Nga të dhënat e pasqyruara në grafik, shihet se dallimi i nxënësve të qytetit prej nxënësve të fshatit që kanë qëndrim shumë negativ ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre është 25%. Afërsisht përqindja e njëjtë është edhe për qëndrimin e nxënësve se si ndihen kur mësimdhënësit përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre. Shpërndarje më e përafërt e dallimeve sipas gjeografisë fshat – qytet është shënuar të qëndrimi Nuk reagoj fare, ku këtë e kanë shprehur rreth 43% e nxënësve nga shkollat e fshatit dhe mbi 57% e nxënësve nga shkollat e qytetit. Dy alternativat tjera më dallime rreth 20% më shumë për nxënësit e shkollave të qytetit janë: *Armiqësor dhe hakmarrës*; *Tani jam mësuar me këto shprehje*, ku qëndrimin pro e kanë shprehur rreth 40% e nxënësve nga shkollat e fshatit dhe rreth 60% nga nxënësit e shkollave të qytetit.

Analiza dhe krahasimi i qëndrimeve të nxënësve sipas gjeografisë, fshat-qytet, për raportin mësimdhënës – nxënës në shkollë, shpeshtësinë e përdorimit të fjalëve a shprehjeve fyese që arsimtarët i përdorin kur i drejtohen nxënësve, pajtimin/mospajtimin e nxënësve me shprehjet fyese që i përdorin mësimdhënësit ndaj tyre, si dhe qëndrimin e nxënësve ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre, shohim se

dallimet janë evidente në mes të qëndrimeve të nxënësve nga qyteti dhe atyre nga fshati:

- shpeshtësia e përdorimit fjalëve a shprehjeve fyese është më e shprehur në shkollat e qytetit;
- fjalët dhe shprehjet fyese më të rënda që shpesh i përdorin mësimdhënësit kur iu drejtohen nxënësve janë evidente më shumë në shkollat e qytetit;
- nxënësit nga shkollat e qytetit shprehin mospajtim më të madh ndaj fjalëve a shprehjeve që i përdorin mësimdhënësit ndaj tyre;
- nxënësit nga shkollat e qytetit shprehin qëndrim më kritik ndaj mësimdhënësve që përdorin fjalë a shprehje fyese ndaj tyre;
- nxënësit nga shkollat e fshatit janë për nga numri më i madh që nuk kanë dhënë përgjigje në disa alternativa te pyetjeve që kanë shprehur shkallën e pajtimit/mospajtimit apo shpeshtësinë e përdorimit të fjalëve a shprehjeve fyese;
- nxënësit nga shkollat e fshatit janë për nga numri më i madh që janë shprehur se nuk pajtohen se në shkollë ekziston atmosferë e mirë për punë dhe mësim.

3.7. Mendimet e/qëndrimet e nxënësve në pyetjet e hapura

Që të marrim mendime përafërsisht të afërt midis nxënësve dhe mësimdhënësve , pyetjen e hapur nën 6 e kemi bërë përafërsisht të ngjashme. Për nxënësit pyetja ishte: “Çka do ti thoshe arsimtarit/es, i/e cili/a ndonjëherë përdorë kësi shprehjesh ndaj teje?, ndërsa për mësimdhënës “Çka do ti thoshe ti arsimtarit tënd, i cili përdorte këso shprehjesh kur Ti ishe nxënës”? Përgjigjet e tyre i kemi përmbledhur në tabelën në vijim duke krahasuar mes veti. Siç shihet nga përgjigjet e të dyja palëve, nxënës-mësimdhënës, kemi përgjigje të natyrës së njëjtë. Përgjigjet e mësimdhënësve janë më të sofistikuara dhe nuk shprehin nivel të mllëfit sikurse përgjigjet e nxënësve.

Tabela 18. Krahasimi i mendimeve të nxënësve dhe mësimdhënësve

Mendimet/qëndrimet e nxënësve	Mendimet/qëndrimet e mësimdhënësve
<p>1. Arsimtar, a ju thua fëmijëve të tu fjalë fyese?</p> <p>2. A ke fëmijë arsimtar? Si do të dukej nëse ndonjë mësimdhënës përdor shprehje të tilla me fëmijët tuaj,</p> <p>2. Nuk keni të drejtë të përdorni fjalor të tilla në shkollë,</p> <p>3. Arsimtar, unë jam nxënës dhe kam nevoj për këshilla, jo për fyerje,</p> <p>4. A ke qenë edhe ti nxënës,</p> <p>5. Nuk e meriton të punosh me nxënës të mrekullueshëm siç jemi ne,</p> <p>7. Do ti thosha: Arsimtar, njeriu mëson nga gabimet,</p> <p>8. Unë nuk do të përdorja kësi shprehje po të isha në vendin tuaj,</p> <p>9. Unë nuk mendoj si ju arsimtar, por pasi që jeni më i vjetër,</p> <p>10. Faleminderit!, Arsimtar, po të ishe ti në vendin tim, të siguroj se nuk do të silleshe kaq mirë si unë,</p> <p>11. Ne jemi nxënës, nuk e meritojmë të na fyeni. 12. Unë kam ardhur të mësoj në shkollë dhe jo të fyhem nga ju arsimtar,</p> <p>13. Arsimtar, nuk e meritoj këtë fyerje edhe pse gabova, sepse ju e dini që të gjithë gabojnë, nese je nervoz, shko dhe shprehe diku tjetër,</p> <p>14. Mos më thuaj ashtu se nuk jam kafshë,</p> <p>15. Mos bërtit se je në klasë.</p>	<p>1. Arsimtar, a mund të më trajtosh si fëmijën tuaj, Edhe unë jam fëmija juaj,</p> <p>2. Këto shprehje nuk duhet të përdoren nga një arsimtar,</p> <p>3. Të kujtonte fëmijët e tij para se të thoshte diçka të tillë,</p> <p>4. Jam prekur shumë, por asnjëherë nuk kam guxuar ti them diçka,</p> <p>5. Me inate të shtëpisë mos dil në pazar,</p> <p>6. Nuk është e drejtë,</p> <p>7. Arsimtar, nuk duhet të më fyesh kështu,</p> <p>8. Nuk është kjo mënyra e duhur për të zgjidhur probleme,</p> <p>9. Nuk je përgatitur për orë mësimore,</p> <p>10. Ne jemi të ndryshëm, disa më të qetë dhe disa më të vështirë, kështu që duhet të na përshtatesh të gjithëve,</p> <p>11. Atij i mungojnë metodat e duhura edukative, 12. Arsimtar, kjo nuk është në cilësinë e pedagogut,</p> <p>13. Nuk jeni pedagog i mirë,</p> <p>14. Me dialog gjithçka arrihet,</p> <p>15. Ka shprehje më të mira, mos përdor fjalë që e përdhosin dinjitetin e fëmijës,</p> <p>16. Këto nuk janë fjalë që duhet të shprehen në institucione.</p>

Në pyetjen se *Çka do ti thoshe arsimtarit/es, i/e cili/a ndonjëherë përdorë kësi shprehjesh ndaj teje*, përgjigjet e nxënësve janë të ndryshme. Ato shpeshherë tingëllojnë me shprehje të ndryshme, por që kuptimi i tyre është i njëjtë. Përgjigjet e nxënësve, pa marr parasysh gjininë apo vendin në të cilin shkojnë në shkollë, përcjellin pothuajse mesazhe të njëjta për mësimdhënësit e tyre. I vetmi dallim që theksohet në mes të vajzave dhe djemve, jo në shumicën e rasteve, është se nganjëherë vajzat nuk preferojnë të flasin në rastet kur fyhen nga mësimdhënësit e tyre. Ato preferojnë të heshtin, edhe pse nuk pajtohen me qëndrimet e mësimdhënësve.

Disa nga përgjigjet e nxënësve shprehin keqardhje për gabimet që kanë bërë dhe që mësimdhënësit e tyre kanë qenë të detyruar të përdorin shprehje të tilla, disa shprehin mllef, disa nxënës nuk reagojnë fare, disa i kundërshtojnë dhe kritikojnë mësimdhënësit për fjalët fyese që u thonë, disa i “falënderojnë mësimdhënësit”, disa të tjerë u kërcënohen mësimdhënësve, kurse disa të tjerë japin alternative të tjera të përgjigjeve, duke u treguar mësimdhënësve se si duhet të përgjigjen ata. Ajo që duhet potencuar këtu është se pjesa dërmuese e nxënësve, pa marr parasysh gjininë apo vendin ku shkollohen, janë shprehur se do ti thoshin arsimtarit që *nuk ka të drejtë të përdorë fjalë e shprehje fyese, sepse ata kanë ardhur në shkollë të edukohen dhe jo të fyhen nga arsimtari*.

Përgjigjet e nxënësve të cilat duhen analizuar me kujdes në këtë pjesë janë* : *Arsimtar, a ju thua fëmijëve të tu fjalë fyese? A ke fëmijë arsimtar? Si do të dukej nëse ndonjë mësimdhënës përdor shprehje të tilla me fëmijët tuaj, Nuk keni të drejtë të përdorni fjalor të tilla në shkollë, Arsimtar, unë jam nxënës dhe kam nevoj për këshilla, jo për fyerje, A ke qenë edhe ti nxënës, Nuk e meriton të punosh me nxënës të mrekullueshëm siç jemi ne, Do ti thosha: Arsimtar, njeriu mëson nga gabimet, Unë nuk do të përdorja kësi shprehje po të isha në vendin tuaj, Unë nuk mendoj si ju arsimtar, por pasi që jeni më i vjetër, Faleminderit!, Arsimtar, po të ishe ti në vendin tim, të siguroj se nuk do të silleshe kaq mirë si unë, Ne jemi nxënës, nuk e meritojmë të na fyeni. Unë kam ardhur të mësoj në shkollë dhe jo të fyhem nga ju arsimtar, Arsimtar, nuk e meritoj këtë fyerje edhe pse gabova, sepse ju e dini që të gjithë gabojnë, Nese je nervoz, shko dhe shprehe diku tjetër, Mos më thuaj ashtu se nuk jam kafshë, Mos bërtit se je në klasë. Një numër i nxënësve i të dyja gjinive preferojnë që rastet e tilla ti diskutojnë me kujdestarët e klasave apo në drejtori. Këto janë përgjigjet e tyre: Do të shkoj te drejtoresha, Nuk do ti thoja asgjë atij, por ti tregoja*

* Sqarim: Shprehjet e nxënësve i kemi paraqitur në origjinal, ashtu si ata janë shprehur, me gabime drejtshkrimore.

drejtoreshës, Do ti thosha që do ti tregoj kujdestares së klasës dhe se do të ankohej për të, Do ta lajmëroja te kujdestari e ai le të merret me këtë punë, Do të ankohesha te drejtor.

Një numër i vogël i nxënësve të gjinisë mashkullore përgjigjen me kërcënime ndaj arsimtarëve të tyre, kurse një numër po ashtu i vogël i gjinisë mashkullore, duke përfshirë edhe pjesën urbane edhe atë rurale në të cilën vijojnë mësimet, përgjigjen me fjalë fyese ndaj arsimtarëve të tyre, si shenjë e pakënaqësisë së sjelljeve dhe fjalëve që ata paraprakisht i përdorin me nxënës.

Të njëjtën dukuri e kemi trajtuar edhe më mësimdhënësit, për të parë nëse idetë e tyre përputhen apo jo me ato të nxënësve dhe nëse do ta trajtonin në të njëjtën mënyrë apo jo çështjen në fjalë.

Në pyetjen ***Çka do ti thoshe ti arsimtarit tënd, i cili përdorte këso shprehjesh kur Ti ishe nxënës***, përgjigjet e mësimdhënësve dallojnë pak a shumë nga ato të nxënësve, por ka raste në të cilat ato përputhen plotësisht. Qasja e trajtimit të pyetje dhe mënyra e përgjigjeve nga ana e mësimdhënësve trajtohet kështu: disa nuk do të reagonin fare, disa nuk do të ishin pajtuar asnjëherë, disa do ta pranonin fajin dhe do të kërkonin falje, disa do ta sugjeronin arsimtarin që të mos fyente, disa të tjerë thonë se në kohën kur ata ishin nxënës, mësimdhënësit e tyre nuk përdornin fjalë të tilla, kurse disa do ta shikonin me ironi.

Sikurse nxënësit, po ashtu edhe *mësimdhënësit* do të reagonin për fyerjet që do t'u bëheshin nga mësimdhënësit e tyre. Reagimet dhe përgjigjet e mësimdhënësve janë të ndryshme si: *Arsimtar, a mund të më trajtosh si fëmijën tuaj, Edhe unë jam fëmija juaj, Këto shprehje nuk duhet të përdoren nga një arsimtar, Të kujtonte fëmijët e tij para se të thoshte diçka të tillë, Jam prekur shumë, por asnjëherë nuk kam guxuar ti them diçka, Me inat të shtëpisë mos dil në pazar, Nuk është e drejtë, Arsimtar, nuk duhet të më fyesh kështu, Nuk është kjo mënyra e duhur për të zgjidhur probleme, Nuk je përgatitur për orë mësimore, Ne jemi të ndryshëm, disa më të qetë dhe disa më të vështirë, kështu që duhet të na përshtatesh të gjithëve, Atij i mungojnë metodat e duhura edukative, Arsimtar, kjo nuk është në cilësinë e pedagogut, Nuk jeni pedagog i mirë, Me dialog gjithçka arrihet, Ka shprehje më të mira, mos përdor fjalë që e përdhosin dinjitetin e fëmijës, Këto nuk janë fjalë që duhet të shprehen në institucione.*

Disa mësimdhënës, duke përfshirë të dyja gjinitë mendojnë se do ta lajmëronin te drejtori, disa do të kërkonin falje dhe nuk do të përsëritnin më

gabimet, kurse një pjesë tjetër nuk do të reagonin fare, por do ta injoronin mësuesin duke heshtur. Përgjigjet e këtyre mësimeve janë: *Do ta shikoj me ironi, Nuk më ka ndodhur asnjëherë, por do të ankohesha në drejtori, Do të ankohesha në drejtori, Nuk do të reagoja fare, Nuk mendoj se do të reagoja, Nuk do ti përgjigjesha.*

Ajo që e vlen të thuhet këtu është se një numër i mësimeve krahasojnë kohën e tanishme dhe kohën kur ata ishin nxënës dhe vijnë në përfundim se në kohën kur këta mësime ishin nxënës nuk janë përdorur fjalë dhe shprehje të tilla fyese nga mësuesit.

Pakënaqësitë e mësimeve lidhur me fjalët fyese që mund t'u vinin nga ish mësuesit janë pothuajse të njëjta me pakënaqësitë e nxënësve, të cilat mund ti krahasojmë përmes përgjigjeve të tyre të dhëna. Nëse krahasojmë përgjigjet e të dyja palëve, arrijmë në përfundim se mënyra e trajtimit të problemit do të ishte pothuajse e njëjtë. E vetmja gjë që duhet përmendur si dallim është se mësuesit janë më të matur në mënyrën e përgjigjeve dhe reagimeve. Mësuesit nuk përdorin fjalë fyese dhe nuk do ti kishin kërcënuar mësuesit e tyre, siç janë përgjigjur një numri i vogël i nxënësve, si : *Ti nuk ke edukatë s'ke për çka të na mësosh neve, Ti ke ardhur të më mësosh për edukatë e nuk ke për vete, Mos më prit te dera, Psikopat, I kisha mshu karrigë, A je normal?*

Në disa raste, vërehen dallime të pakta në mënyrën e përgjigjeve të mësimeve dhe mësimeve, pra vërehen dallime të mënyra se si janë përgjigjur disa mësime, të cilat nuk i kemi hasur edhe te mësuesit. Këto përgjigje janë: *Jo, nuk do ti thoja asgjë, por do të kisha bërë përpjekje të bëhem e sjellshme dhe e dëgjueshme në të ardhmen, Po të më kishte ndodhur, do ta pranoja fajin dhe do ti kërkoja falje në qoftë se kisha bërë ndonjë gabim, Nëse do të ndodhte, do ta pranoja me kokëulje shprehjen e tij dhe do ti kërkoja falje që kam bërë sjellje të keqe dhe e kam revoltuar (hidhëruar) arsimtarin.*

Nga të gjitha përgjigjet që analizuam, mund të konstatojmë se nuk ka dallime të theksuara në mes të përgjigjeve të mësimeve të të dyja gjinive dhe në mes të hapësirave gjeografike në të cilat punojnë ata. Qëndrimet e mësimeve janë pothuajse të njëjta dhe shprehin qëndrim kritik ndaj dukurisë në fjalë.

3.8. Mendimet e nxënësve për reagimet e kolegëve kur janë fyer nga mësuesit

Në pyetjen se *Si është ndier, ose si ka reaguuar shoku yt nëse arsimtari/ja ka përdorur ndonjë shprehje të këtyllë ndaj tij?*

Përgjigjet e nxënësve janë shumë domethënëse dhe shqetësuese. Ato reflektojnë të gjitha ato që i kanë përjetuar vetë nxënësit apo që i kanë dëgjuar duke u thënë shokëve të tyre. Reagimet e nxënësve në këto raste kanë qenë të ndryshme, duke filluar nga ato të cilat kanë përfunduar me keqardhje, skuqje dhe heshtje deri te ato të cilat kanë pasqyruar revoltën e tyre, duke sharë apo ofenduar mësimdhënësit, në shenjë revolte dhe pakënaqësie. Reagimet janë të ndryshme, siç janë të ndryshëm edhe vetë nxënësit. Kështu janë përgjigjur ata:

Normalisht që është ndier keq, por nuk ka reaguuar fare, Pse arsimtar po më fyer?, Është ndier shumë keq, sepse edhe arsimtarët tregohen të pakulturë, E pikëlluar me kokë ulur dhe nervoze, Ka reaguuar shumë keq, Është turpëruar shumë, Është mësuar me këso shprehje, por mendoj se këto shprehje janë shumë negative, Është ndier shumë keq, sepse arsimtari i ka thënë gomar, Ka filluar të qajë, sepse nuk i ka merituar ato fjalë, Kanë thënë se do të ankohen te drejtori, Është bërë nervoz, por e ndalova, Jam ndjerë i qetë, por e kam kuptuar se çfarë arsimtari është, Shoku im është ndier shumë i mërzhitur, Ka ulur kokën poshtë, E ka nervozuar shumë dhe ka folur fjalë fyese, Në mënyrë negative disa prej tyre, Është ndie shumë keq, sepse i tha para të gjithëve, I mërzhitur, Është ndie tmerrueshëm, Ai është ndjerë shumë keq, sepse fjalë të tilla as rrugaqët si përdorin, Ne tashmë jemi mësuar me këso shprehje dhe se kemi problem, Ka marr guxim dhe i ka treguar drejtoreshës, Do të thërras babin, Nga inati është skuqur, është demoralizuar, nuk ka mësuar gjatë në atë lëndë dhe ka qajtur, Ka qeshur, Është nervozuar shumë, por nuk e ka shprehur te arsimtari, Është ndier shumë keq dhe e ka konsultuar prindin dhe kujdestarin, Nuk kam dëgjuar asnjëherë fjalë e shprehje të tilla që arsimtarët tanë kanë përdorur për të na fyer, Shoku im i ka thënë: Të lajmëroj te drejtori. Shko ku të duash se unë jam vet drejtori i thotë arsimtari.

Disa nga shprehjet e përdorura këtu, kërkojnë vëmendje të veçantë dhe duhet shqyrtuar e analizuar me kujdes si: *Ka ikur prej klase ose e ka lajmëruar prindin, Do të largohem nga kjo shkollë se mjaft më kështu, Shoku ose shoqja ime ka dalur nga ora dhe ka fyer arsimtarët, Do të ndihej si një i huaj i cili nuk i përket atij vendi, Ka qarë kur e ka fyer arsimtari duke i mëshuar bankës me grushta, Nuk ka guxuar të flasë, S'ka pas çka me ba se ia fut shuplakë dhe e rrëzon për tokë, Nuk ka folur se s'ka guxuar, Shpeshherë shokët tanë nga inati e shfryejnë mllefën duke i sharë pas shpinës: Mbylle gojën kush po te pyet ty, Ti je pa edukatë dhe nuk më kupton mua.*

3.8.1. Mendimi i mësimit lidhur me ndjeshmërinë e nxënësve kur ata fyhen

Për të njëjtin qëllim, përgjigjet e mësimit lidhur me pyetjen *A mendoni se nxënësit në këto situata ndihen të fyer, apo si i përjetojnë ato fjalë të rënda?*

Janë po ashtu të ndryshme, por në këtë rast mësimit lidhur me shprehjet e tyre për përjetimet e nxënësve, përderisa nxënësit më lartë shprehnin ndjenjat, qëndrimet dhe reagimet e shokëve të tyre, të cilët janë fyer nga mësimit lidhur me.

Nga përgjigjet e mësimit lidhur me shohim se pjesa dërmuese e mësimit lidhur me, pa marr parasysh gjininë dhe pozitën gjeografike në të cilën japin mësimit, pohojnë se nxënësit ndihen të fyer, të pamotivuar, të irluar dhe të dëshpëruar nga fyret që mund t'u bëhen nga mësimit lidhur me e tyre. Përgjigjet e tyre për çështjen në fjalë janë:

Natyrisht, çdo njeri ndihet i fyer në situata të tilla, sidomos fëmijët që janë të ndieshëm, Ata do të ndihen më keq dhe të pamotivuar, Përderisa ofendohet lëndohet gjithësesi dhe s'ka të drejtë askush ta fyej askend, mund ta dënojë, por jo ta fyej dhe ta rrah, Sigurisht që janë të injektuar dhe të revoltuar, S'ka koment, Normal që ndihen të fyer dhe duhet të bëni kujdes ndaj shprehjeve me nxënës, Mendoj se ndihen të fyer dhe të demoralizuar në procesin mësimit, Ndihen të fyer, të thyer emocionalisht, demoralizohen, humbin vetbesimin, Ndihen të nënçmuar, Po, shumë traumë, Ka nxënës të mirë, prandaj ndihen të fyer, Po, ndihet i fyer dhe më tepër do ta shkatërron, Ata ndihen të fyer, por edhe e shprehin kundërshtimin e tyre, Po, ndihen shumë të fyer se ne po bëjmë dhunë psikologjike, Arsimtari duhet të jetë i qetë, pavarësisht se si sillen nxënësit, Përdorimi i fjalëve fyese tek nxënësit ndikon negativisht.

Për krahasim dhe për t'i parë më mirë mendimet dhe qëndrimet midis nxënësve dhe mësimit lidhur me qëndrimet për reagimet e nxënësve të fyer po i paraqesim në tabelë.

Tabela 19. Mendimet e nxënësve dhe të mësimit lidhur me ndjeshmërinë e nxënësve ndaj fyerjes

<i>Nxënësit</i>	<i>Mësimdhënësit</i>
<p><i>Normalisht që është ndier keq, por nuk ka reaguar fare, Pse arsimtar po më fyen?, Është ndier shumë keq, sepse edhe arsimtarët tregohen të pakulturë, E pikëlluar me kokë ulur dhe nervoze, Ka reaguar shumë keq, Është turpëruar shumë, Është mësuar me këso shprehje, por mendoj se këto shprehje janë shumë negative, Është ndier shumë keq, sepse arsimtari i ka thënë gomar, Ka filluar të qajë, sepse nuk i ka merituar ato fjalë, Kanë thënë se do të ankohen te drejtori, Është bërë nervoz, por e ndalova, Jam ndjerë i qetë, por e kam kuptuar se çfarë arsimtari është, Shoku im është ndier shumë i mërziur, Ka ulur kokën poshtë, E ka nervozuar shumë dhe ka folur fjalë fyese, Në mënyrë negative disa prej tyre, Është ndie shumë keq, sepse i tha para të gjithëve, I mërziur, Është ndie tmerrueshëm, Ai është ndjerë shumë keq, sepse fjalë të tilla as rrugaqët si përdorin, Ne tashmë jemi mësuar me këso shprehje dhe se kemi problem, Ka marr guxim dhe i ka treguar drejtoreshës, Do të thërras babin, Nga inati është skuqur, është demoralizuar, nuk ka mësuar gjatë në atë lëndë dhe ka qajtur, Ka qeshur, Është nervozuar shumë, por nuk e ka shprehur te arsimtari, Është ndier shumë keq dhe e ka konsultuar prindin dhe kujdestarin,</i></p>	<p><i>Natyrisht, çdo njeri ndihet i fyer në situata të tilla, sidomos fëmijët që janë të ndieshëm, Ata do të ndihen më keq dhe të pamotivuar, Përderisa ofendohet lëndohet gjithësesi dhe s'ka të drejtë askush ta fyej askend, mund ta dënojë, por jo ta fyej dhe ta rrah, Sigurisht që janë të indinjuar dhe të revoltuar, S'ka koment, Normal që ndihen të fyer dhe duhet të bëni kujdes ndaj shprehjeve me nxënës, Mendoj se ndihen të fyer dhe të demoralizuar në procesin mësimor, Ndihen të fyer, të thyer emocionalisht, demoralizohen, humbin vetbesimin, Ndihen të nënçmuar, Po, shumë traumë, Ka nxënës të mirë, prandaj ndihen të fyer, Po, ndihet i fyer dhe më tepër do ta shkatërron, Ata ndihen të fyer, por edhe e shprehin kundërshtimin e tyre, Po, ndihen shumë të fyer se ne po bëjmë dhunë psikologjike, Arsimtari duhet të jetë i qetë, pavarësisht se si sillen nxënësit, Përdorimi i fjalëve fyese tek nxënësit ndikon negativisht.</i></p>

<p><i>Nuk kam dëgjuar asnjëherë fjalë e shprehje të tilla që arsimtarët tanë kanë përdorur për të na fyer, Shoku im i ka thënë: Të lajmëroj te drejtori. Shko ku të duash se unë jam vet drejtori i thotë arsimtari.</i></p>	
--	--

Një numër i konsideruar i mësimdhënësve femra, në raport me numrin e mësimdhënësve që janë anketuar mendojnë ndryshe, krahasuar me përgjigjet e mësimdhënësve të tjerë më lart. Ato mendojnë se: *Ka nxënës që ndihen keq, por ka edhe të atillë që nuk e kanë gajle, Ndihen të fyer, por edhe nuk e marrin shumë tragjike, Disa i përjetojnë rëndë, kurse disa të tjerë ndoshta janë mësuar me raste të tilla, Po sikur ti kishin përjetuar nuk do të kishin vepruar.*

Një numër shumë i vogël i mësimdhënësve përgjigjen kështu: *Mendoj se do të ndihen keq, s' do ta duan shkollën - mendon vetëm një mësimdhënëse femër, nga 93 mësimdhënës të anketuar, Për fjalët që përdori unë ndonjëherë, nuk më ka ndodhur që nxënësit të ankohen, megjithatë, natyrisht që nuk ndihen mirë – mendon një mësimdhënëse tjetër, Në këso situata, nxënësit e kuptojnë arsimtarin-rrespekt, mendon një mësimdhënës tjetër i gjinisë mashkullore.*

Një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve femra dhe meshkuj, duke përfshirë edhe pozitën gjeografike fshat dhe qytet, nuk janë përgjigjur fare në pyetje. Pra, nga 93 mësimdhënës të anketuar, janë përgjigjur vetëm 77 prej tyre.

Nëse krahasojmë përgjigjet e mësimdhënësve dhe të nxënësve konstatojmë se të dyja palët shprehin qëndrim kritik ndaj dukurisë në fjalë. Pjesa dërmuese e të anketuarve, gjykojnë rastet e ofendimeve dhe fyerjeve, sepse ato ndikojnë jo vetëm në disponimin, motivimin dhe në edukimin e nxënësve, por ato ndikojnë edhe në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe në rezultatet mësimore.

Kapitulli IV

4.1. Diskutimi i rezultateve

Se sa i rëndësishëm është komunikimi i drejtë me nxënës, mënyra dhe takti i komunikimit po shkëpusim një sekuencë nga filmi shqiptar “Shoku ynë Tili” (Tiranë 1985). Tili, nxënës në klasën e VIII, kishte probleme me përshatjen rrethit të klasës, sidomos me mësuesit. Por ai kishte aftësi të larta praktike. Bënte punime artistike nga druri. Kujdestarja e klasës, mësuese Besa, përdorte metoda dhe mjete të ndryshme edukative për ta trimëruar atë të mësonte dhe që të përshatej me klasën. Por një ditë derisa Tili me shokët punonin për rregullimin e këndit të klasës hyri njëri nga mësuesit, i cili i drejtohet atij me “ja ky trapi”. Nga inati, pse iu drejtua kështu, i ra fortë gozhdës e cila u shtrëmbërua duke prishur krahun e kornizës. Ky ishte reagimi me ankth ndaj mësuesit i cili në prezencën e shokëve i tha trap.

Duke krahasuar përgjigjet e nxënësve në pyetëtorin tonë, rastësisht edhe këta ishin nxënës të klasës së VIII-të, shohim se çfarë janë reagimet e tyre ndaj mësuesve që përdorin fjalë edhe më të rënda se sa kjo me të cilën ky mësues iu drejtua Tilit.

I rrituri përdor dhunën fizike apo psikologjike ndaj fëmijës për ta disiplinuar atë ose për t’ia mësuar e kultivuar dituritë, shkathtësitë apo shprehjet për të cilat mendon se i duhen atij. Por “...dallimi mes disiplinës dhe ndëshkimit fizik dhe psikologjik gjithashtu është dallim mes përdorimit të autoritetit dhe abuzimit të pushtetit. Ndryshimi në mes tyre është përdorimi i dhunës. Ky është një nga shkaqet kryesore të dëmit që i shkaktohet zhvillimit të fëmijës”.¹¹ Se a është përdor duna verbale nga mësimdhëniet ndaj nxënësve e kemi paraqitur atë në analizën e rezultateve.

Gjatë analizës së të dhënave të fituara me anën e dy pyetësorëve, apo të shtresave kryesore të mostrës së hulumtuar-mësimdhënës nxënës, kemi vërejtur se nuk ka ndonjë dallim të theksuar midis mësimdhënësve si tërësi. Edhe gjatë analizës së veçuar të mostrës në nën kategori, siç janë sipas shtrirjes së shkollave, fshat-qytet, apo sipas gjinisë, femra-meshkuj, nuk vërehen dallime të theksuara në qëndrimet e tyre ose në shpeshhtësinë e përdorimit/mospërdorimit të fjalëve e shprehjeve fyese, nënçmuese ndaj nxënësve.

¹¹ Një udhëzues mbi disiplinën pozitive, Save the Children, Programi për Shqipërinë, Tiranë 2007, fq. 26.

Sipas mendimit tonë, pjesa më e sinqertë dhe relevante në hulumtim janë pyetjet e hapura në të cilat nxënësit janë shprehur ashtu si e ndihen, ose si e kanë përjetuar një fyerje, ose se si ka reaguar shoku i tij/saj kur ka qenë objekt i fyerjes nga mësimdhënësi. Këto flasin shumë edhe për faktin se paraqesin një realitet ekzistues në shkollën tonë, qoftë në qytet apo në fshat.

Gjatë shfletimit të literaturës, nuk kemi hasur në raste të fyerjes së nxënësve nga ana e mësimdhënësve sikurse që ndodhin te ne. Aspektet e dhunës verbale, fyerjeve e të ngjashme janë trajtuar kryesisht në segmentin/rrafshin nxënës-nxënës. Kemi hasur në disa shembuj të “fyerjes” të tërthorta, por jo të drejtpërdrejta. Edhe këtyre ju kushtohet vëmendje dhe merren masa ndaj atyre mësuesve që veprojnë, “fyejnë” edhe në mënyrë të tërthortë, apo përdorin epitete ndaj nxënësve.

Në literaturën pedagogjike është trajtuar shumë çështja e komunikimit dhe rëndësia e tij në krijimin e raporteve të shëndosha nxënës mësues dhe anasjelltas. Si pasojë e mungesës së komunikimit, ose komunikimit jo të drejtë, lindin edhe konfliktet e ndryshme mësues-nxënës. Në shumë raste, të rriturit, në këtë rast mësimdhënësit, nuk janë të ndërgjegjshëm se një shprehje me të cilën iu drejtohen nxënësve/it, përjetohet tepër rëndë nga nxënësi. Nganjëherë shumë fjalë e shprehje janë bërë përditshmëri dhe të cilat përdoren pa menduar fare se mund të lëndojnë dikë, fëmijët sidomos. Për këtë edhe nuk është befasues fakti se përqindje mjaftë e lartë e nxënësve deklarojnë se tani më jemi mësuar me to (fyerje) dhe se nuk ju bëjnë shumë përshtypje. Ose kjo mund të lexohet edhe ndryshe, “asgjë nuk janë këto në krahasim me atë çfarë iu thonë mësuesit atyre”. Këtë në disa shkolla edhe na e kanë thënë (në besim) nxënësit gjatë anketimit. Një pjesë e këtyre fjalëve dhe shprehjeve, edhe pse në shikim të parë nuk duken të rënda, te nxënësi përçojnë porosi të caktuar, të cilën nxënësi edhe mund ta interpretojë, ose ta pranojë varësisht nga ajo se si i thuhet, me çfarë toni, në prezencë të kujt, në çfarë momenti, në çfarë atmosfere etj.

Sipas Tomas Gordon (2006) ekzistojnë pesë porosi, të tërthorta, të cilat mësimdhënësit ua drejtojnë nxënësve nga të cilat nxënësit marrin mesazhin edhe fyes dhe nënçmues.

1. Urdhërimi, komandimi, orientimi (“hidhe çamçakëzin”, “ulu menjëherë”).
2. Tërheqja e vërejtjes, kërcënimi (“qëndro në rresht ose do të rrish gjithë ditën në këmbë”).

3. Moralizimi, predikimi (“Nxënësi i klasës së katërt këtë duhet ta di çka është e drejtë”).
4. Mësimi, përdorimi i logjikës, dhënia e fakteve (“detyrat nuk kryhen vet, derisa ti humb kohën”).
5. Këshillimi, ofrimi i zgjidhjes (“Po të isha në vendin tënd do ti kthehesha punës”).¹²

Porositë e tërthorta për nxënësit nga ana e mësimdhënësve në shkollat tona janë ato të tipit: “Pa sëpatë nuk shkohet në mal”, “Mos ke harruar të hash bukë”, “Nuk je në dasmë”, “Hajde bukurosh/ bukuroshe, mos ishe në pazar” e të ngjashme. Sipas tabelës në të cilën janë përfshirë përgjigjet e nxënësve shihet se shumica e mësimdhënësve, goftë të qytetit apo të fshatit, femra apo meshkuj, i përdorin këto “porosi” për nxënësit. Për shembull vetëm shprehjen “Ti s’je normal”, mbi 16% e nxënësve deklarojnë se të gjithë mësimdhënësit ua drejtojnë këtë “porosi”, por rreth 23% thonë se disa mësimdhënës u thonë kështu, dhe se rreth 31% e nxënësve deklarojnë se kjo i pengon shumë.

Kur kihet parasysh fakti se një shprehje e këtillë është shumë prezent, dhe reagimi i nxënësve është një shkallë të lartë atëherë kjo është për t’u brengosur. Çfarë ndodhë atëherë me nxënësit kur fyerjet janë edhe më të rënda se sa kjo “Ti s’je normal”? Me rëndësi është se çfarë porosie marrin, ose si e pranojnë, nxënësit një shprehje të këtillë: *Nuk jam normal, jam i marrë, jam i paaftë, nuk jam si të tjerët*. Interpretimet e këtilla nga ana e nxënësit varen shumë nga vet tipi i nxënësit.

Nga psikologjia e personalitetit dihet se individët introvert nuk reagojnë shumë edhe pse fyerjet nuk iu pëlqejnë, edhe pse ndihen të fyer, të nënçmuar etj. Rreziku në këto raste qëndron te shpërthimet e mundshme nga individët e tillë (*Nga inati është skuqur, është demoralizuar, nuk ka mësuar gjatë në atë lëndë dhe ka qajtur*) ose (*I kisha mshu karrigë*), *A je normal?* Ndërsa një mësimdhënës për mësuesin e vet i cili ka, përdor kësi shprehje ndaj tij thotë: *“Jam prekur shumë, por asnjëherë nuk kam guxuar ti them diçka”*. Kjo tregon se dukuria e tillë përcillet nga brezi në brez. Si rrjedhojë, nëse mësuesit sot fyejnë nxënësit e bëjnë këtë sepse edhe ata i ka fye mësuesi kur ishin nxënës. Por mund të supozojmë se edhe këta nxënës, sot, njësoj do të shprehen ndaj nxënësve nëse bëhen mësues. Janë dy fjali me rëndësi në deklarimin e këtij mësuesi: *Jam prekur shumë* dhe *“nuk kam guxuar ti them diçka”*. Ose sikurse përgjigjet përqindje e lartë e nxënësve

¹² Tomas Gordon, *Kako biti uspešan nastavnik*, (përkthim) KC, Bg. 2006, fq. 98.

të mostrës se “*jemi mësuar me shprehje të tilla*”. Këto janë disa nga reagimet anonime të nxënësve të përfshirë në mostër.

Sa i përket nxënësve ekstravert kemi reagime të hapura ndaj atyre mësimdhënësve të cilët përdorin fjalë e shprehje të tilla. Reagimet e tyre janë: *çka të kam bërë, pse po më quan ashtu, unë nuk i meritoj ato fjalë, është ankuar te drejtori, te prindi etj.* ose kemi raste kur “*nga inati qanë, ikë nga ora, e fyen (arsimtarin) pas shpine, e të ngjashme.*”

Një shprehje tjetër, e cila shumë përdoret në shkollat tona nga ana e mësuesve, pothuaj shumicës, është “*a ke harruar të hash bukë*”. Me këtë shprehje/porosi zakonisht mësuesit ju drejtohen nxënësve kur ata harrojnë detyrat, lapsin, librin ose ndonjë porosi tjetër. Porosia e tërthortë e kësaj për nxënësit të cilët i drejtohet do të ishte: je joserioz, harrestar, ju jep rëndësi vetëm nevojave biologjike (ushqimit), je i papërgjegjshëm, nuk je i rregullt e të ngjashme. Se një shprehje e këtillë i pengon shumë janë deklaruar mbi 15% e nxënësve të përfshirë në mostër. Por mbi 21% kanë deklaruar se këtë shprehje e përdorin të gjithë arsimtarët dhe rreth 32% thonë se disa arsimtarë ju drejtohen me këtë shprehje.

Përdorimi i kësaj shprehjeje, “*a ke harruar të hash bukë*”, ndërlihet shumë me mungesën e shprehisë së mësuesve për dëgjim aktiv të nxënësit. Harresa, mungesa, vonesa..., kanë ndonjë arsytim për të cilin mësuesi duhet ta diskutojë me nxënësin. Dëgjimi aktiv i halleve të nxënësit ka disa përparësi për të mësuar nëse nxënësi vërtetë kishte ndonjë arsye për veprimin e bërë, e ka përsëritur të njëjtin arsytim edhe hera të tjera, apo ndonjë arsye tjetër për të cilën duhet mësuar.

Është mësimdhënësi ai që duhet t’i kuptojë hallet/problemet e nxënësit për të ndërmarrë veprime jo e kundërta. Të kuptuarit, nga ana e mësuesit, e problemeve që i mundon nxënësit nuk është qëllim më vete, ‘*për ti kuptuar*’, por për të ndihmuar ata për tejkalimin ose zgjidhjen më të lehtë të tyre, qoftë mësimore, sjelljes, konfliktet, përshtatjes etj.

Dihet se edhe mësimdhënësit janë njerëz dhe sa edhe ata mund të kenë telashe e halle, por ata janë në shkollë për nxënësit e jo nxënësit për mësimdhënësit. Lidhur me këtë tregojnë edhe përgjigjet e nxënësve dhe të mësimdhënësve lidhur me ndjeshmërinë e tyre ndaj halleve të njëri tjetrit. Në kërkesën në pyetësor, lidhur me raportin mësimdhënës-nxënësi në shkollë, mbi 80% e nxënësve shprehin shkallë pajtueshmëria se “*Nganjëherë mësimdhënësit nuk i kuptojnë problemet e mia*”, që është një tregues i cilësisë së ulët të raportit të mësuesve me nxënësit. Nëse i shtojmë kësaj edhe pajtueshmërinë tjetër shumë të lartë, mbi 70% e nxënësve “*Hidhërohen kur mësimdhënësi nuk e kupton problemin tim*” ose

gjithashtu një tregues tjetër shumë i lartë, mbi 72% e nxënësve deklarojnë se *“Nervozohen shumë kur mësimdhënësi nuk i dëgjon arsyetimet e mia”*. Mendojmë se kjo shkallë e lartë e pajtueshmërisë së nxënësve tregon shkallën e sinqeritetit të tyre në dhënien e përgjigjeve. Kjo shkallë e sinqeritetit demanton deklarin në përgjigjet paraprake lidhur me cilësinë e bashkëpunimit nxënës-mësimdhënës, ku mbi 90% e nxënësve shprehin shkallë të pajtueshmërisë se *“Bashkëpunimi/raporti mësimdhënës-nxënës është i shkëlqyeshëm”*. Si mund të jetë cilësia e bashkëpunimit kaq e lartë në rastet kur njëra palë, mësuesit, nuk i kuptojnë hallet e palës tjetër, nxënësit, ose kur njëra palë, mësuesi, nuk i dëgjon arsyetimet e palës tjetër-nxënësit?

Gjetja e lidhjeve midis përgjigjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve mund të vazhdojë edhe me ndërlidhjet më të ngushta midis shtresave të tjera të mostrës së hulumtuar, por mendojmë se për natyrën e këtij hulumtimi nuk do të ishte shumë relevante. Të gjitha të dhënat, edhe gjetjen e ndërlidhjeve midis tyre, lexuesi dhe hulumtuesi i interesuar mund të gjej duke krahasuar të dhënat e paraqitura qoftë në tabela ose edhe në formë grafike.

5. Përfundime

Nga analiza dhe interpretimi i rezultateve të hulumtimit shihet se sa i rëndësishëm ishte një hulumtim i këtillë. Te ne janë bërë hulumtime dhe interpretime të ndryshme sa i përket gjendjes së të drejtave të fëmijëve (dhe nxënësve), për dhunën fizike në shkollë, qoftë në relacionin nxënës- nxënës ose mësimdhënës nxënës, por fare pak është trajtuar dhe hulumtuar çështja e dhunës verbale në shkollë, sidomos ndaj nxënësve.

Përfshirja e dy shtresave në mostrën e hulumtimit ishte e rëndësishme për faktin se i ballafaquam dy subjektet kryesor në shkollë: nxënës dhe mësimdhënës.

Supozimi ynë se ka dhunë verbale, fyerje ndaj nxënësve në shkollë katërçipërisht u vërtetua. Nuk ka dilemë se ndjeshmëria e nxënësve ndaj fjalëve dhe shprehjeve fyese, nënçmuese e përçmuese është shumë e lartë.

Gjithashtu ndikimi i fjalëve dhe shprehjeve fyese, të përfshira në pyetësonin për hulumtim dhe të tjera jo të përfshira në pyetësor, është shumë i dukshëm në cilësinë e raportit nxënës-mësimdhënës.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se te nxënësit ekziston një frikë latente për të reaguar ndaj mësimdhënësve, ose për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre të garantuar me ligj. Këtë më së miri mund ta shohim nëse analizojmë deklaratat e tyre në pyetjet e hapura.

Bazuar në përgjigjet e nxënësve, në një shkallë të lartë, jo vetëm që vërtetohet përdorimi i fjalëve e shprehjeve të tilla ndaj nxënësve në shkolla, por se edhe numër i konsiderueshëm i nxënësve tani më janë pajtuar/mësuar me fyerje të tilla dhe sikur nuk iu bënë përshtypje përdorimi i tyre. Ose edhe më keq, deklarimi i nxënësve “Aii, kurrgjë nuk janë këto çfarë na thonë...”.

Treguesit e hulumtimit dëshmojnë se afërsisht gjendje e njëjtë, sa i përket fyerjes, është si në shkollat në qytet ashtu edhe në ato në fshat. Bile, nuk ka dallime të mëdha as sa i përket shtrirjes gjeografike të ekzistimit të të njëjtës shkallë dhe lloj të fyerjeve, sikur në pjesën qendrore, veriore, Dukagjin apo në Ana Moravë. Në rajone të ndryshme kishte raste ku përdoreshin disa shprehje specifike të cilat nuk i kemi përfshirë në pyetësor.

Nga ky hulumtim mund të nxjerrim disa mësimet për të ndihmuar/ndikuar në përmirësimin e gjendjes së raportit mësimdhënës-nxënës dhe të klimës mësimore në shkollë, si:

- duke i kushtuar më shumë vëmendje/rëndësi shkathtësive komunikuese të mësimdhënësve;
- duke bërë ndryshime në Programet e studimeve për mësimdhënës, në të cilat kurse të veçanta të jenë Psikologjia pedagogjike/edukimit, dhe pedagogjisë së komunikimit në mësimdhënie;
- në kurset/seminaret pa shkëputje nga puna vend meritot t’i kushtohet çështjes së komunikimit me nxënës e adoleshentë, taktit pedagogjik etj.;
- të fuqizohen shërbimet e konsulencës në shkolla duke vënë në fokus të tyre punën e vazhdueshme me nxënës, fuqizimin e faktorit nxënës për marrjen e përgjegjësive për punën dhe jetën në shkollë dhe jashtë saj;
- komuniteti i prindërve, OJQ dhe palët e interesuara të jenë më shumë prezent në shkollë me aktivitetet dhe ndihmën e tyre për krijimin klimës cilësore në shkollë;
-

Burimet

- Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Vers. Elektronik, QEP
- Gordon, Tomas, (2006), *Kako biti uspešan nastavnik*, (përkthim) KC, Bg.
- Grillo, prof. Dr. Kozma, (2002), *Fjalor edukimi (Psikologji-Sociologji-Pedagogji)*, ISP, Tiranë.
- Hyseni, Halim, (2004) *Të drejtat e fëmijëve në sytë e nxënësve kosovarë, Refleksione nga një studim*, KEC.
- Hyseni, Halim, (2011) *Parandalimi i dhunës në shkolla, doracak për krijimin e mjediseve të sigurta jo të dhunshme e humane në shoqëri dhe në shkolla*, UNICEF, botim i dytë, Prishtinë.
- Miller, Bonnie, (2004), *Komunikimi me fëmijë, Doracak për prindër dhe 12, fëmijë*, QPEA, Ferizaj.
- Nushi, Dr. Pajazit, (1987), *Fjalori i psikologjisë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë,
- *** *Një udhëzues mbi disiplinën pozitive*, (2007) Save the Children, Programi për Shqipërinë, Tiranë.
- Rigby, Ken, (2003) *Bullying among young children: A guide for teachers and carers*, National Crime Prevention, Australi.
- UNICEF-Kosovë, (2005), *Hulumtim mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës*, (Raport Maj-shtator 205)
- Walsh, Burke, Kate et al, *Krijimi i mjedisit për të nxënësit për shekullin XXI*, USAID&AED, përkthim, Shkup.
- Zuna, Deva, *Afërdita, Dhuna në familje...*
- Dokumente zyrtare:
- KK, *Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës*, Prishtinë 2011.
- MASHT, *Udhëzim i Administrativ (6/2010)*, Kodi I mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta.
- MASHT, *Udhëzim i Administrativ [I] (40/2005)*, Ndalimi, ndërprerja e punës dhe inicimi i procedurës disiplinore ndaj mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjerë në institucionet edukativo-arsimore, aftësuese dhe shkencore.
- Burime nga interneti:
- Mazzola, W., Joseph, (2011), *Bullying in Schools: A Strategic Solution*, www.charakter.org, Washington, (Maj 2012).
- Evans, Patricia, *Toward The Prevention of Verbal Abuse in Schools* [www.verbalabuse.com/page 3](http://www.verbalabuse.com/page_3), 23.10.2012 Akiba, Motoko, *What Predicts Fear of School Violence Among U.S. Adolescents?*, *Teachers College*

Record, Volume 112 Number 1, 2010, p. 68-102, <http://www.tcrecord.org>
ID Number: 15769, Date Accessed: 9/19/2011.

Këtu, 21.1.013